



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

**KONFERENCË SHKENCORE
KOMBËTARE KUSHTUAR JETËS DHE
VEPRËS SË SOTIR PAPAHRISTOS
(1887-1979)**



(përmbledhje materialesh)

Korçë, 29 mars 2019

KOMITETI SHKENCOR I KONFERENCËS

Prof.dr. EMIL LAJE - Tiranë

Prof.dr. ALI JASHARI - Universiteti i Korçës

Prof.as.dr. IRENA NIKAJ - Universiteti i Korçës

Prof.as.dr. JONELA SPAHO - Universiteti i Korçës

Prof.as.dr. DION TUSHI - Universiteti i Korçës

Dr. ERINDA PAPA - Universiteti i Korçës

Dr. PANDI BELLO - Universiteti i Korçës

**KONFERENCË SHKENCORE KOMBËTARE KUSHTUAR
JETËS DHE VEPRËS SË SOTIR PAPAHRISTOS
(1887-1979)**

Përgatitja për botim:

OLGER BRAME

© Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

Botim elektronik

ISBN: 978-9928-4568-0-9

Shtator, 2019

Tabela e përmbajtjes

KRONIKË	6
EMIL LAFE PROFESOR SOTIR PAPAHRISTO PËR PASTËRTINË E GJUHËS SHQIPE	7
IRENA NIKAJ RRUGËTIMI I NJË MISIONARI: SOTIR PAPAHRISTO-MËSUES DHE STUDIUES MODEL	18
EMINE SHABANI ESKILI FOLI SHQIP NËPËRMJET (PËRKTHIMEVE TË) SOTIR PAPAHRISTOS	22
VALBONA SINANAJ SOTIR PAPAHRISTO SI NJË ORGANIZATOR I ARSIMIT KOMBËTAR DHE KONTRIBUTI I TIJ PEDAGOJIK.....	37
PANDI BELLO SOTIR PAPAHRISTO DHE PORTRETI I TIJ KULTUROR.....	48
ILIR SHYTA UTILITET PËRMES PËRKTHIMIT “FOSH NJA”, SJELLË NË SHQIP NGA SOTIR PAPAHRISTO.....	53
LAURANT BICA DIJETARI SOTIR PAPAHRISTO	59
DORENTINA XHAFA “GRAMATIKA E GREQISHTES SË VJETËR” - PIKËTAKIM NDËRMJET ARSIMIT DHE PËRKTHIMIT NË VEPRËN E SOTIR PAPAHRISTOS	78
MELIHATE ZEQRIRI SOTIR PAPAHRISTO NJË MODEL KULTUROR.....	84

DION TUSHI

SOTIR PAPAHRISTO-HARTUES I METODODËS SË PARË TË MËSIMËDHËNIES SË GREQISHTES SË VJETËR NË GJUHËN SHQIPE91

ELVIS BRAMO

SINTAKSA E VARGJEVE NË PËRKTHIMET E TRAGJEDIVE GREKE NGA S. PAPAHRISTO99

JONELA SPAHO

DION TUSHI

SOTIR PAPAHRISTO- FIGURË E SHQUAR E ARSIMIT, PEDAGOGJISË DHE PËRKTHIMIT 109

MAJLINDA BUSHAJ

VEÇORI SINTAKSORE NË SHKRIMET ORIGJINALE TË SOTIR PAPAHRISTOS 122

ERIS RUSI

PËRKTHIMI DHE ONTOLOGJIA NË KOMPETENCAT KULTURORE TË SOTIR PAPAHRISTOS..... 142

OLGER BRAME

SOTIR PAPAHRISTO MBI DISA ÇËSHTJE TË PEDAGOGJISË DHE DIDAKTIKËS..... 149

ARIANA KTONA

PUNËTORI I MERITUAR I ARSIMIT- SOTIR PAPAHRISTO..... 156

ASPEKTE NGA ZHVILLIMI I KONFERENCËS..... 163

KRONIKË

Në datën 29 mars 2019, Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës zhvilloi Konferencën Shkencore Kombëtare kushtuar jetës dhe veprës së Sotir Papahristos (1887-1979).

Në fjalën përshëndetëse, rektori i këtij universiteti, prof. dr. Ali Jashari, u shpreh se Sotir Papahristo mbetet një figurë e madhe e Korçës dhe e kombit shqiptar, si mësues dhe drejtues i arsimit, si një nga ato personalitete që vuri themelet e arsimit modern në Shqipëri, si një përkthyes i pashoq i veprave të letërsisë klasike, si njeri enciklopedik etj. Ai theksoi se kjo konferencë përmbush dhe një nga misionet më të mëdha dhe të vyera që ka Universiteti “Fan S. Noli”, për ndriçimin e figurave të shquara të Korçës dhe më gjerë.

Më pas e mori fjalën kryetari i Këshillit të Bashkisë Korçë, z. Ilir Bajloz, i cili në emër të këtij institucioni nderoi Sotir Papahriston me titullin “Qytetar Nderi” (pas vdekjes). Titulli iu dorëzua mbesës së tij, znj. Donika Çili, me këtë motivacion: *“Personalitet i shquar, që me kontributin e tij të rëndësishëm i ka dhënë arsimit korçar dhe atij mbarëshqiptar një vlerë të pazëvendësueshme ndër breza”*.

Punimet e konferencës vijuan me kumtesat e përgatitura nga pjesëmarrësit.

Në fund, të pranishmit diskutuan rreth temave të referuara, ndërsa në fjalën e tij përmbyllëse, profesor Emil Lafe përgëzoi Universitetin e Korçës për organizimin e kësaj konference, e cila arriti të shpalosë në një dimension shumëplanësh personalitetin, atdhetarinë dhe vlerat shkencore të Sotir Papahristos, si dhe theksoi nevojën e botimit të një përmbledhjeje bibliografike për këtë personalitet.

EMIL LAFE
Tiranë

**PROFESOR SOTIR PAPAHRISTO PËR PASTËRTINË E
GJUHËS SHQIPE**

I nderuar rektor i Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës!

Të nderuar pjesëmarrës të konferencës shkencore kushtuar prof. Sotir Papahristos, njërit prej punëtorëve më të fortë e më të vullnetshëm të arsimit në Shqipëri, sidomos në vitet e vështira kur shkolla kombëtare hidhte hapat e parë si nga ana e organizimit, ashtu edhe nga ana e përmbajtjes dhe e cilësisë së programit mësimor.

Dëshiroj t’ju përgëzoj për nismën tuaj të vyer për t’i kushtuar prof. Sotir Papahristos një konferencë shkencore pikërisht këtu në qytetin e tij të dashur dhe njëkohësisht t’ju falënderoj për ftesën që më keni dërguar.

Sotir Papahristoja ka një vend nderi në plejadën e veprimtarëve të shquar të arsimit kombëtar në Shqipëri, që mbetet një nga arritjet më të mëdha të shtetit të ri shqiptar në periudhën e pavarësisë. Megjithëse e kufizuar në pak qytete për shkak të prapambetjes së trashëguar ekonomike të vendit¹, shkolla e mesme e asaj kohe ishte mjaft cilësore nga niveli shkencor dhe u jepte nxënësve një edukatë të shëndoshë qytetare e atdhetare. Prandaj ajo u bë vatra e inteligjencies shqiptare dhe e qëndresës antifashiste.

Kur mora ftesën tuaj për këtë konferencë, menjëherë e ndjeva veten të detyruar që të paraqitesha sot këtu, sepse sot jam nga të paktët që kanë pasur rastin ta njohin nga afër profesorin e nderuar dhe njeriun e ëmbël Sotir Papahristo. Emri i tij më ishte ngulitur që kur pasurova bibliotekën time si nxënës me librin “Prometheu i lidhur”, ku shënohej: Përkthyer nga greqishtja e vjetër S. Papahristo (Tiranë, 1950). Atëherë librat ishin të paktë dhe kështu e kam lexuar disa herë.

¹ Në vitet ’30 kishte shkolla të mesme vetëm në Shkodër, Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Berat, Vlorë dhe Gjirokastrë

Profesorin pata rastin ta njihja nga afër më 1959 e më pas, kur vinte në Institutin e Gjuhësisë (atëherë në katin e parë të ndërtesës së Fakultetit të Historisë e të Filologjisë në Tiranë) për të takuar miqtë e tij të vjetër Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej dhe Mahir Domi. Ka qenë një fat i veçantë për mua që hyra në atë zyrë që në vitin e parë të punës në Institut. Profesor Papahristoja përshëndeste gjithnjë me ndonjë thënie të shkrimtarëve a filozofëve grekë të lashtësisë, që unë natyrisht nuk e kuptoja, por më bënte përshtypje se prof. E. Çabej ia kthente me diçka të ngjashme po prej atyre autorëve.

Dihet se prof. S. Papahristoja veprimtarinë e ka zhvilluar në fushën e arsimit, duke përfshirë edhe mësimin e gjuhëve klasike, si dhe në fushën e përkthimeve nga greqishtja e vjetër. Megjithatë më shkoi mendja se do të kishte shkruar edhe diçka për gjuhën shqipe. Dhe me të vërtetë, duke kërkuar nëpër treguesit e bibliografisë retrospektive të gjuhësisë shqiptare, një vepër e pazëvendësueshme për vlerat praktike, e punuar me dashuri e kujdes shembullor nga kolegu im i ndjerë Palok Daka (1925–1987)², gjeta një shkrim të prof. S. Papahristos me titull “Nji bisedim mbi çështje gjuhe”, të botuar këtu në Korçë te revista “Rilindja”, më 1935³. Titulli është tepër i përgjithshëm dhe nuk të çon te përmbajtja. Por kur e lexova, pashë se prof. Papahristoja kishte kapur një temë të mprehtë a djegëse, që mbetet e tillë edhe në ditët tona. Ajo “*çështje gjuhe*” që përmendet në titull, është çështja e qëndrimit ndaj fjalëve të huaja të panevojshme, e rrahur fort edhe nga të tjerë në vitet e asaj që quhet periudhë e pavarësisë. Por duhet thënë se pastërtia e gjuhës, shqetësimi për hyrjen e dhjetëra e qindra fjalëve të huaja të panevojshme, përshkon si fill i kuq gjithë historinë e shkrimit shqip që nga autorët tanë të vjetër, që e kanë shprehur hapur brengën e tyre se gjuha jonë *po bdarej e po*

² Daka, Palok: *Bibliografi retrospektive e gjuhësisë dhe onomastikës shqiptare 1879-1944. I (1879-1921). II (1922-1940). III (1941-1944). Bibliografi me anotacione hartuar sipas të dhënave të shtypit periodik shqiptar e mbi Shqipërinë të viteve 1848-1944*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1984, 926 f.

³ “Rilindja” (revistë kulturele, Korçë, 28 nëntor 1935, Viti II, Nr. 24-25, f. 10-20).

bastardhohej dhe ata me veprat e tyre po përpiqeshin ta ndihmonin që ajo të ruhej e të zhvillohej. Por meqë jemi këtu në Korçë, do të përmend se Naum Veqilharxhi, ky nismëtar zemërfortë i veprave të mëdha, rrëfëhet kështu për punën e tij kur u ul të shkruante Ëvetarët e mirënjohur: “e para e punësë ish që si të munt të nxjer fjal’ e kuviset e huaj, e mbë vënt të tyre të dërthtonj (dërthtonj, a derthtonj do të thotë sqimatizo, formaro) të tjera nga vetime gjuhësë, edhe me gjithë që hë për hë munt edhe të mos tringëllojnë ëmblë mbë të ndëgjuarit e veshëve, po kam shpëresë se koha do t’i ëmblësonjë.”⁴

Duke kaluar në kohën kur u shkrua artikulli i prof. Papahristos, duhet përmendur se që nga shtatori i vitit 1913, kur me vendim të Qeverisë së Vlorës gjuha shqipe u shpall gjuhë zyrtare e shtetit⁵, janë bërë përpjekje të vijueshme e të frytshme për ta pasuruar me fjalë e terma të rinj e për ta pastruar nga “mishi i huaj”. Krahas punës së vijueshme të filologëve e lëvruesve dashamirë të gjuhës amtare, si Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Mati Logoreci e të tjerë, le të vëmë në dukje, bashkë me prof. E. Çabejn, ndihmesën e madhe “që ka dhënë e po jep në lëmin e zëvendësimit të fjalëve të huaja me fjalë vendi, në formë anonime, masa e njerëzve të thjeshtë, nëpunës, arsimtarë, ushtarakë, specialistë të degëve të ndryshme, në ditët tona.”⁶ Frymëzimi dhe vendosmëria për të punuar në këtë fushë burojnë nga bindja e gjuhëtarëve dhe intelektualëve shqiptarë për atë që gjuhëtari i shquar arbëresh Marko La Piana, në një recension për librin e mirënjohur të Aleksandër Xhuvanit “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”, e ka përmbledhur me këto fjalë: “Nëse për të gjitha gjuhët çështja e pastërtisë ka një rëndësi të madhe, për gjuhën shqipe ajo ka

⁴ Veqilharxhi, Naum P.: *Fare i i ri ëvetar shqip për djelm nismëtorë. Mot’ i dytë, 1845. Transkriptuar nga Lluka Nase. Akademia e Shkencave e RPSSH Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1984, f. 7. (rotaprint).*

⁵ Vendimi është botuar në gazetën “Përlindja e Shqipëniës”, zëdhënëse e shtetit të pavarur shqiptar, më 23 shtator 1913.

⁶ Eqrem Çabej. “Për pastërtinë e gjuhës”, - në rev. *Gjuha jonë* 1981, nr. 1, f. 7.

rëndësi jetike.⁷

Artikulli i prof. Papahristos është vërtet i shkurtër (merr shkas nga një ndodhi vetjake, nga bashkëbisedimi me një tregtar stofrash), por i shkruar “me nerv” dhe me argumente të shtjelluara në një vijë logjike bindëse dhe të krijon një përshtypje të këndshme gjatë leximit, saqë të duket sikur edhe ti je aty i pranishëm në dialogun ndërmjet profesorit e tregtarit.

Ajo që e ngacmoi prof. Papahriston për të shkruar këtë artikull, është ky pohim i tregtarit: *Nuk është shkatrrue fare gjuha! Për mue s’ka ndonjë rëndësi ajo, por parja. Zot’ i im është parja. Unë përpara të gjithave ve këte dhe të gjitha i bëmë fli përpara kësaj.* “Këto fjalët e fundit, – shkruan profesori në vijim, – m’u dukën mjaft të dâmshëme për interesën e përgjithëshme gjuhësore e kombëtare dhe ... besoj se nuk do të jetë një punë pa vlerë me shkruar disa rrjeshta mbi këte pikë.”

Lajtmotivi i shkrimit të prof. Papahristos është vlera kombëtare e shoqërore e gjuhës si mjet i zhvillimit mendor e i qytetërimit të një populli, të cilën ai e thekson me forcë me këto fjalë: *“Gjuha është kushti më i parë i kombëtaris dhe i të qenmes së njëj populli të lirë e të pavarun. Zhvillimi e grada e gjuhës së njëj populli tregojnë zhvillimin e gradën e qytetnimit të tij. Anmiqt e pamvarësis Shqiptare të mospasunit e njëj gjuhe shkrimi shqipe, e kanë përdorë si argument në shumë raste për të ndaluar formimin e këtij shteti. Gjuha është nëna e dijes, pa atë nuk mund të zhvillohet e nuk mund të përparojë asnjë dituni për të lavrue shpirtin njerëzuer. E një nga mënyrët me ia mbërri shkatërrimit të shpejtë të gjuhës, është të kallunit e barabarizmevet pa nevojë.”* Në këto fjalë krahas atdhetarisë spikat vetëdija për misionin e lartë të mësuesit si edukator dhe frymëzues i brezit të ri për lartësimin kulturor të shoqërisë shqiptare.

Në vijim autori shtron çështjen se kush e ka për detyrë të kujdeset

⁷ Marco La Piana, “Purezza di vocaboli e correttezza di stile”, - në rev. *Albania Nuova*, VI, 1, Roma 1958, f. 3 (në origjinalin italisht: Se per tutte le lingue la questione della purezza è di grande importanza, per la lingua albanese essa è di vitale interesse).

për gjuhën dhe me këtë rast ngre lart rolin e popullit të thjeshtë për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës amtare e sidomos të gjuhës shqipe, e cila, siç dihet, për rrethana historike nuk arriti të ketë një traditë letrare të qëndrueshme e të pasur si mjaft gjuhë të tjera. Prof. Papahristoja nuk pajtohet me mendimin “se çeshtja e të ruejtunit të gjuhës i përket vetëm shkrimtarëvet e mësuesvet dhe jo popullit përgjithënisht”. Ai pohon se “Gjuhë dhe popull janë dy fjalë pothuë se të pandame dhe që plotësojnë njena tjetrën.” Dhe më tej sqaron: “Asht e vërtetë se gjuhën e zbukurojnë dhe e lavrojnë ma tepër shkrimtarët, por këta nuk bajnë tjetër veçse mbëledhin e zgjedhin format ma të bukura të gjuhës popullore dhe shumë rrallë krijojnë e këte punë e bajnë gjithnji tue u mbështetë në fjalët e kuptimet e përdoruna prej popullit”, sepse populli i krijon fjalët “mâ të shumtën simbas njij harmonije të natyrshëme e të vetvetishme, d.m.th. jo me përdhunë e me zor.”

Duke u marrë më tej me pretendimin e tregtarit të stofrave se fjalët e huaja që përdorte ai (shih artikullin më poshtë) ishin *internacionale*, prof. Papahristoja fshikullon me sarkazëm prirjen e disa shtresave të mikroborgjezisë së re qytetare të kohës për të lustruar ligjërimin e tyre me fjalë të huaja të përdorura vend e pa vend, duke nënvlerësuar e përcëmuar fjalën shqipe. Edhe sot ka disa që kapen te pretendimi se kjo ose ajo fjalë është “internacionale”, prandaj nuk ka pse të mos e përdorim. Koncepti i fjalës internacionale ose i ndërkombëtarizmave, siç i quajmë shqip, është edhe mjaft i diskutueshëm në gjuhësi. Një përpjekje të parë serioze për trajtimin e ndërkombëtarizmave në gjuhën shqipe ka bërë kolegu ynë i ndjerë Josif Kole (1938–2015) me disa artikuj në vitet ‘80⁸. Por në veprimtarinë praktike për cilësimin e një fjale të huaj si

⁸ Shih: “Mbi fjalët ndërkombëtare në gjuhën shqipe” - *Studime filologjike* 1984, nr. 3, f. 105-121; “Vendi i ndërkombëtarizmave midis huazimeve të shqipes”. - *Gjuha jonë* 1987, nr. 1, f. 50-56; “Mbi fjalët ndërkombëtare në gjuhën shqipe”. - në: *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë. Materiale të Konferencës shkencore të mbajtur në Tiranë më 7-8 dhjetor 1984*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1988, f. 317-321.

ndërkombëtarizëm ose jo mendoj se vlen kriteri i përcaktuar nga komisioni i terminologjisë në Institutin e Historisë e të Gjuhësisë, sipas të cilit si ndërkombëtare do të quhen “jo vetëm ato fjalë që i kanë të përbashkëta dy ose më shumë gjuhë neolatine, siç është vepruar kryesisht në të kaluarën, por që i kanë edhe gjuhët e tjera”⁹. Kështu p.sh. nuk janë quajtur ndërkombëtare fjalë terma të tilla si *kurbë, nuklear-e, polen, solucion* etj. (gjermanishtja, rusishtja e disa gjuhë të tjera gjermanike e sllave për këto kanë fjalët e veta) dhe janë zëvendësuar përkatësisht me fjalë të përshtatshme shqipe: *lakore, bërthamor-e, pjalm, tretësirë*, që tashmë kanë zënë vend. Prandaj është jashtë arsyes shkencore që të vështrohen si ndërkombëtarizma fjalë të tilla si *sezon, mersi* (atëherë edhe shkruheshin sipas frëngjishtes *saison, merci*) e aq më pak *robe de soir, robe de matin, robe d’après-midi*, që përdorte tregtari.

Artikullin në fjalë prof. Papahristoja e mbyll me një vëzhgim që i ngjall keqardhje e dhembje: “*Fatkeqësisht ndër ne këto kohët e fundit asht ba si modë me përdorë fjalë të hueja dhe kjo mani po përhapet tepër Damin qi vjen nga kjo e dijmë të gjithë dhe nuk asht nevoja të zgjatem, vetëm mund të themi këtu se kush dashë e pa dashe, ndihmon shkatërrimin e gjuhës, ai ndihmon shkatërrimin e kombit e të vehtes së tij.*” Këto fjalë tingëllojnë edhe sot si një këmbanë shqetësimi të thellë për ecurinë e zhvillimit të gjuhës shqipe. Në mënyrë të çuditshme hyjnë e marrin shtrirje në ligjërimin e përditshëm fjalë të huaja krejt të panevojshme. Po sjell si shembull fjalët *karikoj, karikim, karikues*, që i dëgjon kudo përditë: *dua të karriktoj telefonin, e kam telefonin në karikim, kam harruar karikuesin* etj.¹⁰ Në lëndën e fizikës nxënësit mësojnë ç’është *ngarkesa* elektrike, mësojnë gjithashtu se retë janë *të ngarkuara* me elektricitet, se rrufeja

⁹ *Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore. 1. Terminologjia e botanikës (shqip-rusisht-frëngjisht)*. Universiteti Shtetëror i Tiranës. Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë, 1963, f. 7.

¹⁰ Në Kosovë për këtë thuhet *mbush telefonin, mbushësi i telefonit*, ndërsa te ne *mbush telefonin* do të thotë marr impulse nga kompania përkatëse duke paguar një shumë të caktuar.

shkarkon në një sasi të madhe elektriciteti, se akumulatori *ngarkohet* e *shkarkohet* etj.–atëherë pse na duhen fjalët *karikoj*, *karikim*, *karikues*? A nuk na mjaftojnë *ngarkoj/shkarkoj*, *ngarkim*, *ngarkues*? Një fjalë tjetër e fjalë shëmtuar është *siguracion*, shtrembërim trashaman i italishtes *assicurazione*¹¹. Përdoret vetëm kur është fjala për sigurimin e automjeteve, por edhe ky është një sigurim si gjithë të tjerët, si sigurimi i shëndetit, i shtëpisë, i të mbjellave etj. Pra nuk ka nevojë që vetëm për sigurimin e automjeteve të kemi një fjalë të veçantë! Më tej do të shtoja fjalën *sezon*, që e përmend edhe prof. Papahristoja, duke shprehur habinë sesi gratë shqiptare të viteve '30 kuptuakëshin më mirë kur thuhej “stofnat e *saison*-it të dimnit” dhe jo *stofnat e stinës*! Fjala *sezon* sot po përdoret keq në mjediset tona universitare: thuhet rëndom *sezoni i provimeve* (d.m.th. stina e provimeve!). Po ta përkthesh në anglisht, frëngjisht, italisht, rumanisht, rusisht, në vend të *sezon* del fjala *session*. Pra kemi të bëjmë me një ngatërrim fjalësh (për shkak të një ngjashmërie fonetike), të palejueshëm në mjediset universitare, sepse dëshmon një padije filologjike. Tjetër është *sezoni* e tjetër *sesioni*, ose, siç thuhet, Hane Sham, hane Bagdad!¹²

Përkujtimi i veprimtarëve të shquar të arsimit e të kulturës kombëtare nuk është vetëm një detyrim moral brezave që vijojnë punën dhe rrugën e tyre, por njëkohësisht edhe një rast për të nxjerrë mësim e për të shtruar detyra për kohën e sotme. Në këtë vështrim mendoj se në fakultetet filologjike të universiteteve shqiptare duhet bërë më shumë për pastërtinë e gjuhës, për mënjanimin e fjalëve të huaja të panevojshme. Në lëndën e leksikologjisë për këtë duhet të ketë seminare e ushtrime të posaçme duke përdorur si material bazë

¹¹ Në italishte kjo fjalë ka kuptimin ‘sigurim’ në përgjithësi (i shëndetit, i banesës nga zjarri, i jetës, i makinës etj.).

¹² Dmth ku Damasku (në arabishte quhet Sham) e ku Bagdadi! Edhe këtë thënie jo rrallë e shtrembërojnë: *Hane Shan hane Bagdad*, ose edhe më keq: *Hane fshat hane Bagdat*.

librin “Për pastërtinë e gjuhës shqipe. Fjalor”¹³. Ky libër do të shërbente për të nxitur interesimin e studentëve rreth problemeve praktike të pastërtisë së gjuhës dhe për të gjykuar vetë edhe rreth një numri fjalësh të tjera të huaja, që janë shfaqur sidomos në gjuhën e shtypit gjatë këtyre dy dhjetëvjeçarëve pas botimit të librit. Në degët e gjuhëve të huaja studentët duhet të këshillohen e të detyrohen të përdorin fjalorët dhe të mos u vënë bishta shqip fjalëve të huaja kur përkthejnë nga ato gjuhë. Nuk duhet lejuar p.sh. që *basic foods* të përkthehet me *ushqime bazike*, sepse kjo do të thotë ‘ushqime që kanë vetitë kimike të bazave’, kurse në të vërtetë është fjala për ushqime bazë ose ushqime themelore (në fjalorët anglisht-shqip *basic* përkthehet me *themelor, bazë, jo me bazik*).

Le të kemi parasysh porosinë e prof. Sotir Papahristos: “Jo vetëm shkrimtarët pra, por edhe ai ma i vogli që ban pjesë në këte popull, duhet të kujdeset, me sa të jetë në dorë t’atij, për përmirësimin e gjuhës sa ma të thjeshtë kombëtare dhe të papërzieme me fjalë të hueja të panevojshëme.”

Në fund edhe dy fjalë për gjuhën e vetë prof. Sotir Papahristos. Artikullin e tij, që po e bashkëngjitim më poshtë, ai e ka shkruar në një gegërishte letrare jugore a elbërishte (me disa luhatje aty-këtu), ndoshta për respektuar “dialektin zyrtar” të kohës. Por veprat: *Qeverimi i fëmijvet në shkollë* (Tiranë, 1929), *Mësime shëmbëllore për disa nga lëndat kryesore që mësohen në shkollat fillore dhe të mesme* (Korçë, 1930) dhe *Ushtrimet gjuhore dhe hartimet në shkollat fillore dhe të mesme* (Tiranë, 1938), që ka shqyrtuar në kumtesën e saj për këtë konferencë Majlinda Bushaj, janë shkruar në toskërishten letrare të kohës me ngjyrimet të toskërishtes verilindore, që ishte edhe e folmja amtare e vetë autorit. Për këto vepra dhe për botimet e tjera të prof. Papahristos (duke përfshirë edhe përkthimet) mund të shkruhet një monografi e plotë më vete dhe do të ishte mirë që këtë ta

¹³ *Për pastërtinë e gjuhës shqipe. Fjalor*. Grupi i përpunimit dhe i redaktimit: prof. Androkli Kostallari (kryetar), prof. Emil Lafe, prof. Jani Thomai, dr. Engjëll Angoni. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1998, 188 f.

ndërmerite ndonjë studiuës nga Universiteti i Korçës. Është me interes për historinë e shqipes letrare që të dihet se ç'fjalë do të ketë krijuar ai vetë, ç'fjalë mund të ketë marrë nga ligjërimi i përditshëm për të pasuruar leksikon dituror etj. Me studime të tilla për autorë të veçantë do të marrim një pamje më të plotë të ecurisë së zhvillimit të shqipes letrare në periudha të caktuara

Nji bisedim mbi çeshtje gjuhe

Një ditë shkoj ke nji nga tregëtarët më të mëdhej, për me blemë nji stof grashë. Mbassi i dhashë mostrën, tregëtari më tha se t'atillë stofi nuk kishte, por llojna të tjera dhe filloi të përmendi nji seri fjalësh: stof për "robe de soir, robe de matin, robe d'après-midi" etj.etj. Me gjithë që këto fjalë i kuptoja, shtanga përpara tregëtarit tue mos dijtë me i dallue këtë lloj rrobesh, mbasi nuk i kam vû ré gravet t'ona se si vishen në mëngjes e si mbas dreke. Mbasi s'dinja pra se si t'i përgjigjesh, i thashë:

– Shum i përdorni këto fjalët e hueja ju tregëtarët.

– Jo, përgjigjet Zotnija, këto janë fjalë internacionale dhe ashtu përdoren në të gjithë botën.

– Mirë more Zotni, mbase munt të keni të drejtë, mbasi modat dalin në Paris dhe bashkë me to edhe fjalët që i përkasin atyneve, por janë shumë fjalë të tjera që Zotnija juej i përdorni frëngjisht (ose në nji gjuhë tjetër të huej) pa qenë nevoja. P.sh. shkrueni në gazetë se mbërritën stofnat e *saison*-it të dimnit dhe këte reklamë nuk besoj ta keni bâmë për francezet, por për shqiptarët.

– Jo përgjigjet tregëtari, ato i shkruejmë ashtu, pse n'ate mënyrë i kuptojnë gratë t'ona.

Se si mund ta kuptojnë gratë t'ona frëngjishten më mirë se shqipen këtë s'e marr vesht. Prandaj u mundova me ia mbushë mendjen tregëtarit se fjalën stinë mund ta kuptojshin më mirë gratë shqiptare, dhe, po të kishte frikë se s'e merrshin vesht, le ta vinte në kllapa fjalën *saison*, për ta këndue ose për ta nxânë gratë më elegante.

Mbas disa bisedimesh erdhi fjala ke *merci*-u i famshëm. – Po si është puna e këti *merci*-ut, i thashë, që në shumë vende përdoret rëndom?

– Po fjala *merci* është shumë e bukur dhe meriton të përdoret, kurse "faleminderës" është shumë e trashë dhe aspak elegante. – Kur dëgjova këto shtiva sytë dhe pashë se tregëtari që po fliste ishte me të vërtetë elegant dhe

i dënjë me përdorë fjalë elegante.

Mâ në fund, mbasi s'kishte nga t'ia mbante, më thot: – More Zotni, ne jemi tregëtarë dhe s'na duhet gja puna e gjuhës, ate ia lëmë mësuesvet e shkrimtarëvet.

– Po, i thashë, por n'at gjuhë që shkrimtarët me shum therori mundohen me e ndreqë, ju jeni tuj e shkatrrue.

– Nuk është shkatrrue fare gjuha! Për mue s'ka ndonjë rëndësi ajo, por parja. Zot' i im është parja. Unë përpara të gjithave ve këtë dhe të gjitha i bëmë fli përpara kësaj.

Këto fjalët e fundit m'u dukën mjaft të dâmshëme për interesën e përgjithëshme gjuhësore e kombëtare dhe, me qenë se (fatkeqësisht) ky mendim është shumë i përhapun ndër ne, besoj se nuk do të jetë një punë pa vlerë me shkruë disa rrjeshta mbi këtë pikë.

Gjuha është kushti mâ i parë i kombëtaris dhe i të qenmes së njëj populli të lirë e të pavarun. Zhvillimi e grada e gjuhës së njëj populli tregojnë zhvillimin e gradën e qytetnimit të tij. Anmiqt e pamvarësis Shqiptare të mospasunit e njëj gjuhe shkrimi shqipe, e kanë përdorë si argument në shumë raste për të ndalue formimin e këtij shteti. Gjuha është nâna e dijes, pa ate nuk mund të zhvillohet e nuk mund të përparojë asnjë dituni për të lavrue shpirtin njerëzuer. E një nga mënyrët me ia mbërri shkatërrimit të shpejtë të gjuhës, është të kallunit e barabarizimevet pa nevojë.

Ndokush mund të thot se çeshtja e të ruejtunit të gjuhës i përket vetëm shkrimtarëvet e mësuesvet dhe jo tregtarëvet e popullit përgjithënisht.

Gjuhë dhe popull janë dy fjalë pothuë se të pandame dhe që plotësojnë njëna tjetrën. Gjuha e pa përdorun në popull (asnjë herë) nuk ka ndonjë kuptim, sikurse nuk mund të marrim me mend një popull pa gjuhë. Asht e vërtetë se gjuhën e zbukurojnë dhe e lavrojnë ma tepër shkrimtarët, por këta nuk bajnë tjetër veçse mbëledhin e zgjedhin format ma të bukura të gjuhës popullore dhe shumë rrallë krijojnë e këte punë e bajnë gjithnji tue u mbështetë në fjalët e kuptimet e përdoruna prej popullit. Populli asht ai që ndër kushtet e ndryshëme të jetesës ndien nevojën e përdorimit të fjalëvevet e të lokusionevet të ndryshme dhe këto i krijojnë mâ të shumtën simbas njëj harmonije të natyrshëme e të vetvetishme, d.m.th. jo me përdhunë e me zor, por simbas nevojës e rastit. Shkrimtarët, sado zheni të jenë, nuk munden kurrë me i jetue të gjitha rastet e ndryshëme të njëj populli, ata ma të shumën e herës mbledhin, e zgjedhin dhe përdorin me vend ate që ndëgjojnë në popull.

Asht pra detyra e secilit prej nesh, që këte gjuhë, që deri sot e kemi

ruejtë (me gjithë që të gjymtë), mos ta shkatrojmë, por ta riejmë gjithnji dhe të mundohe mi ta përmirësojmë, se tuj riejtë gjuhën, riejmë e mprojmë vehten t'onë.

Sikurse populli e formon e e ndreq gjuhën, po populli mund ta prishi e ta shkatrojë fare shpejt këte. Sikur të përdori çdo mjeshtër ngas 10 fjalë të hueja (të pa nevojshëme), pse i duken ma elegante, atëherë gjuha zvetënohet me të shpejtë e bashkë me këte edhe kombi mbarë. Simbas mendimit të tregëtarit të sipërpërmendun duhan-shitësi mund t'i thot duhanit "tabac" pse kjo fjalë asht ma e bukur; nji tjetër mund të përdori fjalën "tailleur" për "rrobe qepës", pse e para asht ma elegante, në punësi mund të përdori fjalën "collaboration" për bashkëpunim, pse e para asht ma e hollë, tek që e dyta asht pak e trashë dhe mund t'i vراسi timbanën e veshit; ose "me intervenu" për "me ndërhye" etj.etj. E çfar mund të dilte nga kjo punë? Mendoni-e vetë.

Nji palë këto çeshtje i quajnë të vogëla e pa randësi, por e vërteta asht se këto kanë nji randësi të madhe, po të mendojmë pak fellë, mbasi kanë të bājnë me gjuhën, nga e cila varet zhvillimi i nji populli.

Fatqësisht ndër ne këto kohët e fundit asht ba si modë me përdorë fjalë të hueja dhe kjo mani po përhapet tepër si prej nji pjesë të popullit, si edhe prej studentëvet të jashtëm e prej të tjerësh që dijnë ndonji gjuhë të huej. Damin qi vjen nga kjo e dijmë të gjithë dhe nuk asht nevoja të zgjatëm, vetëm mund të themi këtu se kush dashë e pa dashe, ndihmon shkatërrimin e gjuhës, ai ndihmon shkatërrimin e kombit e të vehtes së tij.

Jo vetëm shkrimtarët pra, por edhe ai ma i vogli që ban pjesë në këte popull, duhet të kujdeset, me sa të jetë në dorë t'atij, për përmirësimin e gjuhës sa ma të thjeshtë kombëtare dhe të papërzieme me fjalë të hueja të panevojshëme.

Sotir Papahristo

"Rilindja" (revistë kulture, Korçë, 28 nëntor 1935, Viti II, Nr. 24-25, f. 10-20)

Janë ruajtur veçoritë gjuhësore të origjinalit.

IRENA NIKAJ
Universiteti i Korçës
inikaj@yahoo.com

RRUGËTIMI I NJË MISIONARI: SOTIR PAPAHRISTO- MËSUES DHE STUDIUES MODEL

*“Lufta-mësuese e dhunshme”-
Thukididi në Historia e Luftës së Peloponezit*

Në këtë punim do të përqipemi të japim karakteristikat e mësuesit dhe studiuesit të gjysmës së parë të shekullit XX, Sotir Papahristo, duke u mbështetur tek veprimtaria e tij e gjerë dhe e gjithanshme në fushën e arsimit dhe të shkencës shqiptare. Duam të ndalemi, para së gjithash, te krijimtaria, veprat, administrimi i arsimit dhe shkollave në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit, më pas, rivlerësimi i asaj që përfaqësonte shoqëria shqiptare, i sistemit të vlerave të saj pas Luftës II Botërore, për të kuptuar si ia mbërriti Papahristoja dhe të tjerë si ai, të vazhdonin të merreshin me studime, art dhe kulturë, pavarësisht kushteve, mundësive dhe vlerësimit që kishte shoqëria dhe administrata politike sunduese për punën dhe veprën e tyre.

Puna dhe vepra shfaqen madhështore në vetminë e tyre, të pafuqishme që të mund të ndikonin mjedisin kulturor, por vlerësoheshin në rrethet shkencore dhe kulturore, që nuk komuniknin me opinionin e përgjithshëm. Ky opinion, i cili formatohej nga politika sunduese e kohës, e pashkolluar në masë, e prirur drejt formave të thjeshta, vulgare dhe formaliste të organizimit të jetës shoqërore, kulturës dhe shijeve estetike izoi pjesën më të shkolluar mirë të shoqërisë deri sa e mpiu, e bëri të paqënë shkencën dhe kulturën me frymë perëndimore që mishërohej prej tyre.

Tregohet se mësuesit dhe helenistit të shkëlqyer, Sotir Papahristo (1887-1979), iu shtuan edhe disa ditë jetë, kur profesor Eqrem Çabej hyri aty ku ai jepte e merrte me vdekjen dhe i tha lajmin ende të rremë, se vepra e përkthyer prej tij, “Lufta e Peloponezit” e Thukidi-

dit, do të botohej në Prishtinë. Papahristoja u ngrit dhe i puthi dorën sjellësit të lajmit të shumëpritur. Për hir të së vërtetës, “Jetët paralele” të Plutarkut dhe “Lufta e Peloponezit” e Thukididit ishin dëshira e fundit e papërbushur e Papahristos; një ditë ato e panë dritën e botimit, por kur sjellësi i tyre në shqip kishte dhënë shpirt vite më parë si helenisti i fundit në viset tona,- sipas Çabejt.

56 vjet punë të vërtetë i dha Papahristo shkollës dhe letërsisë, pedagogjisë, didaktikës, metodikave shkollore, përkthimit, e përshtatjeve, me një qëllim: t’i shërbente me devocion, vetëdije të lartë shkollës dhe kulturës shqiptare, të përpiqej të ndërtonte sistemin shkollor, kulturën e studimit dhe përkthimit në vendin e tij, në Korçë dhe në viset shqiptare të viteve të turbullta 1920-1930.

2. Misionari

Sotir Papahristo lindi në Vëmbell(Moshohori), një fshat në rrethinat e Bilishtit, pjesë e Greqisë së sotme, dhe në 1897 nisi gjimnazin serb të Manastirit, por e ndërpreu, për të vazhduar që nga 1901, gjimnazin grek të Korçës me bursë nga Mitropolia e qytetit juglindor. Hyri në shkollë me dobësi në lëndë të ndryshme si matematikë apo frëngjisht, por me vullnet dhe punë shumë këmbëngulëse ia mbërriti të jetë në vitin e dytë me mesatare 10. Në verën e vitit 1902 ishte me fat që shpëtoi nga masakra ku humbën jetën e gjithë pjesa tjetër e familjes së tij. Në 1907-1912 vazhdoi studimet për filologji në Universitetin e Athinës dhe i përfundoi me diplomë *summa cum laude*. E nisi rrugën e gjatë të shërbimit si misionar i arsimit në Gjimnazin e Korçës dhe zhvillonte mësimet e lëndëve të greqishtes së vjetër, latinishtes dhe historisë së përgjithshme. Pas vitit 1922 ndërtoi jetën bashkëshortore dhe familjare “me harmoni dhe dashuri të pashembullt” si e përshkruan ai vetë, tek “Autobiografia”. Në Kongresin Arsimor të Tiranës, më 1922, tregoi se ishte profesionist dhe reformator në arsim. Vazhdoi misionin si kryeinspektor i shkollave të Prefekturës së Korçës, duke patur mbështetje në punën e vet të palodhur ministrin e Arsimit, z. Rexhep Mitrovica. Më 1925, për 5 muaj, ishte Drejtor i Drejtorisë së përgjithshme të arsimit shqiptar (Ministri e Arsimit e asaj kohe) dhe

në shtator dha dorëheqjen, duke e vlerësuar të përmbushur misionin e tij nëpërmjet punëve të mëdha që realizoi si më poshtë:

1. programin për shkollat e katundeve
2. programin për shkollat plotësuese me 6 klasa
3. programin për shkollat normale për vajza dhe djem
4. programin dhe rregulloren për kopshtet e fëmijëve
5. programin për gjimnazet e shtetit
6. modele oraresh për shkollat fillore

7. shqyrtoi tekstet mësimorë që ishin paraqitur dhe u dha përgjigje autorëve të tyre bashkë me kujdesin për të shmangur abuzimet me shpërndarjen dhe shitjen e tyre, kujdes që u shfaq në “Revista Pedagogjike” me qarkoren e botuar në të.

8. Çeli shkolla të mesme të reja, meremetoi ato që ekzistonin, çeli shkolla me konvikte

9. Organizoi kurse kualifikimi për mësuesit e shkollave fillore në qytetet kryesore të Shqipërisë

Në shtator 1925 fillon punë si Drejtor administrativ i Liceut francez, drejtuesi i parë shqiptar në një shkollë ku shumica e mësuesve ishin francezë dhe e përmbushi me sukses edhe këtë mision. Më pas, në 1947 u emërua nëpunës i Institutit të Studimeve Shqiptare; nëpunës i Shtëpisë Botuese, ndërsa nga 1964 u bë bashkëpuntor në Fakultetin e Histori-Filologjisë deri në 1968 kur doli në pension. Edhe pas daljes në pension vazhdoi me po të njëjtin përkushtim shqipërimin e veprave klasike greke deri në 1979.

Po bëjmë, më tej, një paraqitje të përmbledhur të përkthimeve të vyera të Papahristos:

Manuali i Epitektit; Këshilla për Domenikun Isokrat; 7 dramat e Sofokliut: Antigona; Elektra; Ajaksi; Edipi Mbret; Edipi në Kolonë; Trahiniet; Filokteti; 7 dramat e Eskilit: Prometheu i lidhur; Persët; Orestia (Agamemnoni, Koeforët, Eumenidet); Lutëset; gjashtë drama nga Euripidi: Medea; Ipoliti; Hekuba; Andromaka; Ifigjenia në Aulidë; Ifigjenia në Tauridë; katër komedi nga Aristofani: Pluti; Bretkosat; Retë; Akarneasit; “Poetika” e Aristotelit; hartoi antologjinë

e prozës greke (pjesët më të zgjedhura nga prozatorë më të mëdhenj të Greqisë së Vjetër); ka përkthyer veprën monumentale Historia e Luftës së Peloponezitet të Tuqididit, shoqëruar me një hyrje të gjatë; ka përkthyer “Jetët Paralele” të Plutarkut. Nga “Jetët paralele” të Plutarkut janë përkthyer 21 vepra: Aleksandri i Madh; Jul Çezari; Demostheni; Ciceroni; Aristidi; Katoni Plak; Perikliu; Fabius Maksimums; Themistokliu; Kamilli; Soloni; Poplikolas; Pirrua; G.Marius; Foqioni; Katoni i Ri; Mark Bruti; Tiberius Grakhos etj.

3. Studiuesi

Zakonisht, studiuesit e njimendte, vërtet tentojnë t’i shmangen politikës së ditës; kështu veproi dhe Papahristoja, por edhe kjo zgjedhje nuk e ndihmoi, nuk i dha shumë dorë atij dhe të tjerëve si ai, për të përmbushur detyrat profesionale dhe misionin ndriçues në shoqërinë shqiptare të kohës.

Siç thoshte Lasgushi, duhet të bëheshe “bori e partisë”, ndërsa për këtë gjeneratë dijetarësh një zgjedhje e tillë nuk funksionoi. Ata ishin të diplomuar në universitete perëndimore, kishin krijuar kornizën qytetare dhe modelin profesional prej eksperti që nuk vlente për sistemin që u vendos në Shqipëri mbas mbarimit të Luftës II Botërore. Ata punuan si titanë, por puna, veprat nuk u botoheshin, sepse nuk ishin të përshtatshme për politikën e ditës. Ishin të dënuar si Sizifi, të mbanin gurin e rëndë të dinjitarit, shkencëtarit, kërkuesit që nuk bënë dot kompromise në kurriz të dijes, shkencës, letrave, etj. Kjo bëri që vepra e Papahristos të mbetej e shpërndarë, e pabotuar dhe e pavlerësuar, më së shumti e injoruar, ashtu si edhe e shumë prej profesionistëve të formatit të tij. Sot kemi shumë arsye, midis të tjerave, që nuk kemi më helenist si ai, ta vlerësojmë gurin e rëndë tregues, që na ka lënë një njeri me kulturë të madhe, mësues i përjetshëm i vlerave dhe dijeve, me modestinë e përkorë e solemne dhe ta respektojmë në qetesi dhe përjetësi, veprën e tij të pakohë.

Literaturë

Gazeta Standard, prill 2009

Baku, P. 2011. Shkolla normale e Elbasanit. Bachus, Tiranë

EMINE SHABANI
Universiteti i Tetovës
emine.shabani@unite.edu.mk

ESKILI FOLI SHQIP NËPËRMJET (PËRKTHIMEVE TË) SOTIR PAPAHRISTOS

Sotir Papahristo është ndër përkthyesit e parë të tragjediave të Eskilit. Këto vepra të tragjedianit më të njohur të Antikitetit, ia solli lexuesit shqiptar të përkthyer nga origjinali Sotir Papahristoja.

Ky studim shqyrton ndikimet e lëvizjeve shoqërore, politike dhe kulturore në Antikitet, të menduarit kritik, nëpërmjet një hulumtimi shumështrësor, përgjatë periudhës klasike greke në Antikitet. Duke shqyrtuar këtë rast historikisht të rëndësishëm, kam sqaruar procesin me të cilin kjo letërsi ka pasur ndikim në transformimet kulturore, arsimore, morale, e politike.

Në këtë studim do të përdorim dy strategji kryesore të hulumtimit.

E para- analiza dhe mendimi kritik e filozofik të tragjeditë e Eskilit. Religjioni, drejtësia dhe rëndësia e moralit të tragjedia Orestia.

E dyta- sakralja dhe integrimi i saj të tragjeditë e Eskilit.

Të dhënat janë mbledhur nga bibliotekat, intervistat, gazetat, raportet dhe studimet e publikuara.

Ky studim argumenton se letërsia antike nuk është zvetënuar, por ajo ka ruajtur shkëlqimin e saj të dikurshëm dhe madje është burim i studimeve për mënyrën e jetesës, artit, raporteve ndërnjerëzore, traditave e kodit moral të tyre.

Sotir Papahristo lindi më 11 dhjetor 1887 në katundin Vembel të qytezës së Bilishtit. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, ndërsa të mesmen në gjimnazin e Korçës dhe studimet në Fakultetin Filologjik, të Universitetit të Athinës ku i përfundoi me sukses dhe mori diplomën e lavdisë më 1912.

Ka shkruar vepra origjinale, të adaptuara, dhe të përkthyer; pedagogjike, didaktike, metodike, letrare etj: *Bioskautizmi* (adaptim),

Mbi rritjen e foshnjës (përkthim); *Qeverimi i fëmijëve në shkollë* (origjinale), *Mësimet shembullore për shkollat fillore e të mesme* (origjinale), *Jeta e Pirros* (përkthim), *Jeta e Marit* (përkthim), *Hartimet dhe ushtrimet në shkollat fillore dhe të mesme* (origjinale), *Gramatika e greqishtes së vjetër* (origjinale) I; *Gramatika e greqishtes së vjetër* (origjinale) II, *Sintaksa e greqishtes së Vjetër* (origjinale), *Tri Biografi nga Plutarku* (adaptim), *Pjesë nga moralet e Plutarkut*, *Karakteret e Theofrastit* (përkthim), *Manuali i Epitektit* (përkthim), *Këshilla për Domenikun Isokrati* (përkthim), ka përkthyer të gjitha dramat e *Sofokliut*, 7 vepra; ka përkthyer të gjitha dramat e *Eskilit*, 7 vepra; ka përkthyer gjashtë drama nga *Euripidi*; ka përkthyer katër komedi nga *Aristofani*; *Poetika e Aristotelit*; ka hartuar antologjinë e prozës greke, ka përkthyer veprën monumentale *Historia e Luftës së Peloponezisë* të Tuqididit.

Nga *Jetët paralele* të Plutarkut janë përkthyer 21 vepra: *Aleksandri i Madh*; *Jul Çezari*; *Demostheni*; *Ciceroni*; *Aristidi*; *Katon Plaku*; *Perikliu*; *Fabius Maksimums*; *Themistokliu*; *Kamilli*; *Soloni*; *Poplikolas*; *Pirrua*; *G.Marius*; *Foqioni*; *Katoni i Riu*; *Mark Bruti*; *Tiberius Grakhos* etj.¹⁴

Eskili lindi më 525/524 p.e.r. Athinë dhe vdiq më 456/455 në Gela Sicili. Sipas të tjerëve ai shkroi rreth 90 vepra, por vetëm shtatë mbijetuan.

Vepra që kam zgjedhur për analizë është **Orestia** trilogjia që përbëhet nga tre pjesë: Agamemnoni, Keoforet dhe Eumenidet.

Në të parën jepet kthimi i Agamemnonit nga Troja si fitimtar dhe vrasja e tij nga gruaja Klitemnestra bashkë me të dashurin e saj Egjistin, në pjesën e dytë Oresti takohet me Elektrën të varri i Agamemnonit, për të bërë libasione, (përshtypje) për të atin e vdekur dhe në këtë pjesë Oresti i frymëzuar nga Elektra vret nënën bashkë me Egjistin armikun e Agamemnonit. Në pjesën e tretë dhe të fundit ndodh ndjekja e Orestit nga Eriniet dhe mbrojtja e tij nga Apoloni dhe

¹⁴<http://www.arkivalajmeve.com/Sotir-Papahristo---Helenisti-me-Autobiogafi-te-panjohur.233769/>

Athëna. Kjo trilogji për herë të parë u vu në skenën e Athinës në vitin 458 p.e.r.

Pjesa e parë e trilogjisë, *Agamemnoni* nis me përshkrimin e rojtarit që fle mbi çati për të parë shenjën e fitores, zjarrin që duhej të dilte nga Mali i Idës nga Troja. Në mënyrë spontane dhe retrospektive rrëfimi kalon te nisja e anijeve akeje për në luftë. Nisen një mijë anije për në Trojë i parë por deti nuk ka valë. Sipas Kalkas priftit orakull i cili ia komenton dukurinë Agamenonit se n.q.s, do erë të volitshme për të lundruar Artemisa, kërkon sakrificë dhe ky kurban duhet të jetë vajza e tij Ifigenia. Ky moment është mjaft interesant, e panjohura në atë kohë është komentuar me dukuri hyjnore, pra deti pa valë ka dashur sakrificë njerëzore, një kompromis i shtrenjtë dhe i dhimbshëm për Agamemnonin. Njeriu i lashtësisë kur sheh shenja nga qielli u jep atyre formë dhe kuptim, krijon perënditë, popullon qiellin, ekzistenca roli dhe atributi i tyre u caktua nga njerëzit, kjo i bën ata të plotësuar nga ana shpirtërore, siç thotë Karl Menninger *Njeriu ka etje metafizike dhe për këtë kërkon zëvendësim*, pra njeriu kërkon zëvendësim për homo religiosus që gjendet brenda tij. Edhe Sokrati i mësonte nxënësit e tij se shumësia e zotave nuk është realitet, por pjellë e imagjinatës së poetëve.

Agamemnoni kur pranon ta sakrifikojë Ifigeninë, nxit zemërimin e Klitemnestrës dhe ky akt e çon atë që të thurë planin për hakmarrje kur kthehet triumfues nga lufta. Kështu e përshkruan narratori vizionin e Kalkantit në epodë lutjen që i bën ai Artemisë dhe Apolonit që ajo të mos e pengojë nisjen e ushtrisë akeje për në Trojë:

*‘Un i lutem Apolonit
që të mos lëshoj’ e motra
erë kundër flotës Greke
[...] se ajo kërkon për vete
një fli tjetër të pa ligjë
pa gostira, fli që solli
zënje grindje shtëpiake
më në fund e vrasje burri*

*se mëria e tmerruar
u ndez brenda në pallat
plot dredhi, dinakëri
që s'harron të marrë hakun
e së bijës së flijuar
Ja të tilla tha Kalkanti* ¹⁵

Një epokë kur shumë popuj ishin fise tribale, akejtë, trojanët, pellazgët dhe ilirët kishin kanune të konsoliduara mirë për çdo element dhe dukuri shoqërore: të drejtat zakonore, dënimet, shpërblimet etj, por evidenca arkeologjike për një kanun ashtu siç kemi sot Kanunin e Lekë Dukagjinit akoma nuk ka, përveç se përmendet te Homeri dhe ky kanun është i shenjtë në bazë të fakteve që i përshkruan ai te Iliada, madje shkelja e mikpritjes, besës, betimit, gjakmarrja, imoraliteti etj, ishin shkaqet që çuan deri në këtë luftë me përmasa botërore. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit ‘‘596 *Nderën sejcilli e ka për vedi e nuk mund t’i përzihet kush kuej as me e rrethue me pegje e me pleq. Dy gisht nder në lule të ballit na i ngjiti i Zoti i Madh.*’’¹⁶.Dhe ajo që i ndodhi kësaj dere mbretërore ishte poshtërimi në sytë e popullit sepse në Kanun shkruan ‘‘600 *Aj të cillit iu muer ndera, xehet i dekun kah kanuja*’’.¹⁷

Në një periudhë rreth shtatëqind vjeçare pas Luftës së Trojës, në Greqinë antike kemi kushtetuta e kanune, si *E Drejta e Përgjithshme, E Gorthynit, Athinës, Spartës, ajo Helenike, e Egjiptit*, etj. Studiuësit modernë, nuk kanë në dorë ndonjë kanun shumë të hershëm përveç atyre ligjeve dhe të drejtave që dalin nga veprat e Homerit dhe që mund të jetë nga shek, XII-XIII p.e.r, ndërsa kodi zakonor i *Drakonit* është nga viti 620 p.e.r, e më vonë, ky ligj u reformua nga Soloni që ishte arkondi i Athinës, në vitin 593. Mjaft ligje dhe rregulla njohim dhe nga *Theogonia e Hesiodit, Shteti i Platonit, Politika e Aristotelit*

¹⁵ Eskili, (1982), Tragjedi, Orestia, Rilindja, Prishtinë, fq.141

¹⁶ Kanuni i Lekë Dukagjinit, (2015) Shtëpia botuese Kuvendi, Shkodër, fq.64

¹⁷ Po aty.

të cilët janë të periudhës së fundit klasike (gjashtë-shtatë shekuj pasi u shkrua Iliada).

Pra edhe flijimi ishte një kod zakonor popullor edhe pse këta flijime bëheshin për perënditë dhe në këtë rast duhej të flijohej Oresti, por Agamemnoni e flijon Ifigjeninë, sepse pasardhësit e fronit duhej të ishin djemtë. Ky akt e zemëron Klitemnestrën dhe të tri pjesët e trilogjisë funksionojnë mbi parimin shkak-pasojë. Shkaku i rrëmbimit të Helenës, fillon lufta mes akejve dhe trojanëve, shkaku i mungesës së valëve flijohet Ifigjenia, për shkak të marrjes me forcë të Brizeidës nga Agamemnoni e bojkoton luftën Akili, vritet Patrokli, si pasojë vritet Hektori, ideatori i Kalit të Trojës, Odhiseu i mallkuar nga Hekuba dhe trojanët, kthehet me dhjetë vjet vonesë në Itakë, ndërsa Agamemnoni vritet nga gruaja e tij, e kjo vritet nga djali i saj Oresti, etj.

Skena kur Agamemnoni vendos të flijojë Ifigjeninë është ndër më tronditëset. Kjo na kujton flijimin e gruas në Kalanë e Rozafës. Ky kompromis i dhimbshëm e bën atë fillimisht të luhatshtëm, por pastaj vendos ta flijojë bijën e tij. Kjo dramë e madhe do ta godasë edhe atë vet. Vendimi i këtillë tregon stadin e një civilizimi të hershëm dhe shpesh paradoksal. Ne në këtë kohë kemi filozofë, poetë, shkencëtarë por mendësia e besëtytnia kishin një rol të fuqishëm në jetën e tyre shpirtërore. Rrëfimtaret e këtyre kohërave, të miteve nuk e pyesnin veten nga u vjen ky frymëzim i përrallave dhe ndivnesave shpirtërore të orakujve që kishin dhuntinë për ta parë të ardhmen ose për të komunikuar me zotat e ndryshëm, ashtu si Kalakanti në këtë rast, që qetësinë absolute të detit e komentoi si kusht për flijim.

Më i madhi nga të dy Atridët tha:

*‘‘Është e rëndë mu si vdekja
Të mos bindem në ndivnesën
Po e rëndë është edhe
Të bëj fli fëmijën time
Q’është stolia e shtëpisë
Dorën time atërore*

*Ta spërkat me gjakn' e rrjedhur
Prej bijës sime të flijuar
Pran' altarit të nderuar
Nga këto të dyja cila
Mund të jetë pa dëm fare?
Ti braktis ti le anijet
Besëlidhjen ta shkelmoj?
Oh kërkojnë me të madhe
Flinë, gjakun e një vajze
Që të mund të zbutet era
E na qoftë për të mirë'¹⁸*

Në atë që sot e quajmë “Greqia Antike” thotë Jungu kishte mendje shumë të përparuara që besonin se historitë e jetës së zotave ishin veç rrëfime të ekzagjeruara të jetës së mbretërve apo kryetarëve të varrosur prej kohësh, të përcjella nga një traditë arkaike. Ata mendonin se miti ishte “i pabesueshëm” për t’u interpretuar sipas domethënies së tij të qartë, andaj u munduan ta sjellin në një formë të kuptueshme për të gjithë.¹⁹ Ai më tej thotë se ashtu si grekët që e kuptuan se *mitet ishin shtrembërim i historisë ‘normale’, racionale, disa nga pionierët e psikologjisë dolën në përfundimin që ëndrrat nuk thoshin atë që dukej se thoshin*,²⁰

Një ëndërr të keqe pa edhe Hekuba, para se të lindi Parin, që lindi një trung të ndezur i cili e dogji Trojën. Talmudi thotë “Ëndrra është vetë interpretimi i saj”. Në Antikitët siç duket njerëzit i kanë dhënë vet kuptimin e simbolikës së ëndrrës, apo njerëzit e specializuar i kanë interpretuar ato.

Duke pasur parasysh jetën e mbushur me besime pagane, simbole, e besëtytni, nuk është aspak e çuditshme kur shohim e lexojmë se këta njerëz, ishin supersticioz, madje edhe udhëheqës, mbretër e heronj

¹⁸ Eskili, (1982), Tragjedi, Orestia, Rilindja, Prishtinë, fq.144

¹⁹ Jung, Carl Gustav, (2010), Ese mbi gjurmimin e të pavetëdijshmes, Fan Noli, Tiranë, fq.100

²⁰ Po aty, fq.101

kërkonin këshilla nga priftëreshat e Dodonës, Delfit, e tempujve tjerë të shumtë në Antikit. Por siç përmenda më lartë, një Odhise dinak e një Agamemnon, nuk mund të jenë aq naivë të besojnë në besëtytni të cilat kërkojnë sakrifica të shtrenjta. Sipas Eskilit Ifigenia flijohet, ndërsa sipas Euripidit në momentin kur Artemisa u bind në besnikërinë e Agamemnonit, e ngriti Ifigeninë dhe flijoi një sorkadhe. Si rrjedhojë era nis të fryjë dhe anijet akeje shkojnë në Trojë, ku luftojnë plot dhjetë vjet derisa e mposhtin atë dhe e kthejnë prapë Helenën e bukur.

Në pjesën e parë ndodh intriga e Klitemnestrës, e cila e pret me shumë nderime burrin e saj dhe kur hyn në pallat bashkë me Egjistin e vret atë dhe skllaven e tij trojane Kasandrën.

Narratori vendos përsëri ndivnesat profetike si postulat, kësaj rradhe me parashikimet e Kasandrës e cila pa hyrë akoma brenda shtëpisë i shfaqen vizionet e të ardhmes së afërt që do ndodhë dhe përfundojnë të vdekur të dy bashkë me Agamemnonin. Imagjinata dhe intuita janë të dobishme për poetët dhe artistët, por edhe për shkencën dhe kuptimin tonë. Një pohim të tillë e bën Jungu, i cili thotë se edhe procesi logjik mund të çojë deri te rezultati i njëjtë si intuita.²¹ Pas vdekjes së Agamemnonit, Egjisti dhe Klitemnestra përballen me popullin që kanë dëgjuar se e kanë vrarë.

Në pjesën e dytë Keoforet, pason dalja në skenë e Elektrës dhe Orestit. Elektra bën libasjone për atin e vdekur. Këta elemente dhe rituale i bënin njerëzit të qetë dhe të vërtetë me veten, duke menduar se këto rituale e lumturojnë dhe e qetësojnë shpirtin e të vdekurit. Këta elemente apo simbole kulturore janë prezente në shoqëri të ndryshme njerëzore, edhe pse pak të zbehura. Ato madje është e pamundur të zhduken, edhe pse në dukje janë irracionale ato luajnë një rol shumë të rëndësishëm në strukturën tonë mendore. *Sipas Jungut n.q.s, tentojmë t'i zhdukim dhe t'i çrrënjosim këta simbole do të kishim pësuar humbje të rënda. Aty ku këta janë të shtypura ose të*

²¹Jung, Carl Gustav, (2010), *Ese mbi gjurmimin e të pavetëdijshmes*, Fan Noli, Tiranë, fq.104

shpërfillura, energjia e tyre specifike zhduket në pavetëdije me pasoja të pallogaritshme. Energjia e këtillë psikike zgjon dhe intensifikon atë që dominon në pavetëdije. Këto prirje krijojnë në vetëdijen tonë një ‘hije’, gjithnjë të pranishme dhe shkatërruese. Dhe për këtë, thotë Jungu ‘shekulli ynë ka dhënë mundësinë të dimë atë që ndodh, kur hapen dyert e botës së nëndheshme’,²²

Në skenën e dytë të Keoforet kemi lamentin tipik që e gjejmë te gjama e burrave dhe vajtimi i grave të shqiptarët:

*E dërguar nga pallati
Vinj në varr me libasione
Duk’ e i rënë kraharorit
Përmbi faqet tona duket
Hulli kuq, hull i gjakosur
Që ne vet e kemi bërë
Ja tashi me këto thonj
Mbasi zemra im’ushqehet
Me vajtime pa pushim
Edhe grushtet mbi krahëror²³*

Kjo pjesë është shumë e pasur me rituale dhe besime arkaike të kohës. Aty përmendet gjendja e Agamemnonit në Hades-mbretërinë e nëndheshme, ritualet dhe nderimi i jashtëzakonshëm që u kushtohet. Por në këtë vend takohen Orestia dhe Elektra, ku merren vesh për hakmarrje. Në aktin e pestë që është më tronditësi nga të gjithë përmbillet misioni i Orestit ai tashmë del me shpatën me të cilën Klitemnestra vrau Agamemnonin dhe rrobën e përgjakur të atit të tij për ta shfaqur para popullit. Me fjalë fisnike dhe i tronditur, ai rrëfen se për këtë veprim e urdhëroi Apoloni: ‘Në i bëfsh këto, më tha perëndia, fajtor nuk do quhesh, po në mos i bëfsh, s’do ta thom dënimin, s’ mund ta marrësh me mend sa i tmerrshëm është’,²⁴

²² Jung, Carl Gustav, (2010), Ese mbi gjurmimin e të pavetëdijshmes, Fan Noli, Tiranë, fq.104

²³ Eskili, (1982), Tragjedi, Orestia, Rilindja, Prishtinë, fq.220

²⁴ Po aty, fq. 273

Edhe triumfi i vdekjes kumbon nga ky fjalim i Orestit i cili bëhet gati të shkojë te tempulli i Febit atje ku rinin zjarret ndezur gjithmonë, e që mendohej se është qendra e tokës. Ai ka në kokë një kurorë dhe degë ulliri në dorë për të kërkuar pastrim dhe lehtësim nga mëkati sepse vrau një të fisit, nënën e tij. Ngushëllues është dialogu i tij me korin i cili orvatet ta bindë se :'' *asnjë nga të vdekshmit, se kalon dot jetën, pa ndonjë të keqe, medet ah medet,! Tashi një të keqe, një tjetër më vonë*''²⁵. Vargjet e fundit janë më të goditura, ku bëhet përmbledhje e tragjedisë së shtëpisë së Atrejve, që nga Thyesti, i cili dhunoi shtratin e vëllait dhe për këtë Atreu ia poqi fëmijët e tij duke e gostitur me mishin e tyre. Nga kjo kohë kishte filluar mynxyra në këtë pallat dhe ajo përfundon me vrasjen e Klitemnestrës.

Në fund të Keofoveve pasi rrëfëhet para korit, Oresti, bën të shkojë te tempulli i Febit me degën e ullirit, papritmas i shfaqen Eriniet e shëmtuara, si Gorgonet për të cilat mendon se i dërgoi nëna. Nga sytë e tyre del gjak i zi dhe në kokë kanë gjarpërinj. Narratori bën ngjyrosjen më të gjallë për ta treguar gjendjen shpirtërore dhe emocionale të Orestit, është e qartë se atë e vret ndërgjegjja sepse ka vrarë nënën. N.q.s, do t'i referohemi Jungut përsëri, sepse ai u mor me kundërpjesën shpirtërore të njeriut, animën dhe animusin. Anima pjesa femërore te meshkujt, te Oresti ka një ndikim negativ, pasi që e ëma e shiti te një tregtar në Feb. Një ndikim negativ i nënës te fëmijët meshkuj i bën ata me ngarkesë shkatërrimtare. Njerëzit Antikitët duke mos pasur njohurinë e mjaftueshme shkencore që ta shpjegojnë dhe kuptojnë në mënyrë racionale dhe të logjikshme këtë reagim të burrave të këtyllë, ia veshin atë magjisë së shtrigave, zanave të këqija dhe mashtruese, virgjëreshës helmuese, e cila gjithmonë mban helm në tesha, ose i dalin gjarpërinj nga goja etj. Në të gjitha shfaqjet e saj anima luan rolin e Hijes, që projektohet në forma të ndryshme, në varësi të asaj se cili ka qenë trajtimi i djalit nga e ëma. Ajo mund të ketë rol negativ, por edhe pozitiv, e gjithë kjo vjen nga kultura, sjellja dhe roli që ka lozur e ëma në edukimin e djalit dhe anasjelltas me

²⁵ Po aty, fq.273

vajzat.

Pas vrasjes të së ëmës, Oresti ka nisur betejën me ndërgjegjen e tij e cila është më e vështira. Në ndihmë do t'i vijnë Apoloni, Athëna dhe kori i cili vazhdimisht i kujton se ka bërë veprën që është më e drejtë për ta bërë.

Në të gjitha mitologjitë antike, ose veprat letrare artistike, figura femërore përfaqëson kaosin, sepse femërorja është vendlindja e të gjitha gjërave. Në Gjenezë thuhet është gjarpri ai që i dha njeriut vizionin, urtësinë dhe si rrjedhojë vetëdijesimin. Gjendja initiale e kontaktit, tek Orest, kur ai sheh Eriniet dhe shtanget, ashtu siç bëheshin gurrë njerëzit kur shihnin Meduzën.

Natyra i jep mbështetje kulturës, kultura e mbështet personin e vuajtur. Vdekja e Poliksenës përfaqëson pranimin e vullnetshëm të vuajtjeve të vdekjes, me dinjitet, pa vajtime dhe pa lutjen t'i falin jetën. Kjo përfaqëson madhësinë e pranimit të vdekjes dhe është një element i psikikës njerëzore. Ky kaos që shkaktoi ikja ose rrëmbimi i një mbretëreshe përfaqëson zanafillën e një kaosi të madh si rrjedhojë, këtu kemi të bëjmë me simbolin e Daos, ose jin/jan. Kaosi te bijat e Tindarit, Helena dhe Klitemnestra. Inicimi i kaosit Helena, por poeti antik Homeri, me indulgjencën njerëzore e paraqet këtë fakt se Parisi u mahnit nga bukuria e saj, ata të dy u dashuruan dhe vendosën të ikin.

Ikja e saj sjell shkaqet dhe pasojat të cilat prekin jetën e çdo qytetari në Trojë e në Greqinë e lashtë, ajo që ndodh pas është tmerri i vdekjes, zjarrit dhe tymit, kufoma, vajtime dhe mallkime. Dhe si duket këta mallkime i ndoqën udhëheqësit spartan, dhe familjet e tyre për një kohë të gjatë.

Por pas kësaj lufte Greqinë e kaploi një varfëri e skajshme, një pjesë e popullit të lirë, e rënduar nga taksat varfërohej dhe kalonte në kategorinë e tetëve (thites), njerëz të varfër që humbnin lidhjet e tyre me gjininë. Përhapja e lypjes dhe të pastrehëve, të cilët jetonin jashtë në natyrë, ndërsa dimrit mblidheshin në "shtëpi prej tunxhi", ose (kovaçhane), që shërbente si han i varfanjakëve, kjo ndodhi madje në

kohën e ‘‘Odisesë’’ dhe zgjati me dekada pas Luftës së Trojës.

Në pjesën e fundit të Eumenideve, pasi Oresti bën hakmarrjen për babanë e tij dhe kjo sipas të dhënave nga Historia e Tukididit, ndodhi tetë vjet pas vrasjes së Agamemnonit, ai shkon vërdallë tempullit të Febit, ku shpreson në ngushëllimin dhe mbrojtjen e Apolonit dhe Athenës ndjehet në vargjet me figura të gjalla e plot ankth që përshkruan autori, ku derdhet, vuajtja dhe brejtja e ndërgjegjes si nënëvrasës.

Orestin e ndjek hija e Klitemnestrës, ai në të vërtetë me vrasjen e saj, e vë në jetë ligjin e perëndive dhe madje mund ta shpjegojë atë. Ne mund ta kuptojmë atë "ligj" që lidhet me objektin e tij në nivelin e universalitetit, i cili është niveli që Klitemnestra zë. Në vend të kësaj, ne duhet të shohim se ajo ka kaluar kufirin, ajo ka shkuar përtej kufirit që është i përshtatshëm për një grua dhe është ky kufi që Oresti e mbron. Ai kishte mundësi për ta vvarë menjëherë por e priti momentin, d.m.th, pas tetë vjetësh që ta bëjë këtë. Pritja nuk ka të bëjë me pavendosmërinë e Orestit, sepse duke vvarë nuk është e mjaftueshme, ai dëshiron Klitemnestra të vuajë në ferrin e mëkatit, bashkë me Egjistin dhe përtej jetës, përtej botës së të gjallëve, ta mashtrojnë vdekjen disi, i bindur se ata të dy nuk do të pushojnë në paqe, të mos arrijnë ti rrëfejnë mëkatet e tyre perëndive, të mos vdesin me ndërgjegje të pastër në mënyrë që të vazhdojnë të vuajnë edhe pas vdekjes në Hades. Ky ankth është pikërisht që Klitemnestra nuk gjen qetësi, prandaj e ndjek kudo Orestin, njësoj edhe Eriniet, por ato gjithmonë flenë, sikur Athena dhe Apoloni i trullosin kur Oresti gjendet në tempull.

*O bobo! Po flini? Dhe gjumi na duhet !
Po unë ndër hijet e tjera të Hadit
Tepër e përbuzur sillem poshtë e lart,
Se më shajnë dendur për vrasjen që bëra
Dhe më ngjitin njollë-ja ku po ju them
Një njollë të madhe, po asnjë nga hyjtë
Nuk u zemërua kur pësova keq,*

*Kur më therri dora, dora e tim biri!
Ja plagët e mia! Shëkoi me mendje!
Se në gjumë mëndja shumë qartë sheh[...]
Sa herë ju kam bërë plot libasione
Pa një pikë verë po vetëm me mjaltë
Dhe me ujë të pastër! Shpesh herë ju kam ftuar
Në shtëpi për darkë pikërisht në orën
Kur asnjë nga hyjtë s' mund të marrë pjesë
Po këto të gjitha sot po i shkelmoni.²⁶*

Nga shprehja e Klitemnestrës drejtuar Erinieve, kuptojmë se ajo ka ndjekur një kult të shpirtave të këqij-shtrigave të Hadesit, për të cilat ka bërë libasione dhe nderime të veçanta, natën, kur perënditë dhe hyjtë në këtë kohë nuk merrnin pjesë. Hija e saj e ndjek ndërsa ato që kanë tagër ta marrin në botën e nëndheshme Orestin gjithmonë i zë gjumi kur ai është në prani të tyre. Dhe si avokatë të zotë prej dialogut të monologizuar të Klitemnestrës me Eriniet e fjetura, deri në fund të trilogjisë dialogojnë më shumë Apoloni dhe Athena me Eriniet, e më pak Oresti. Ato përpiqen ta dënojnë thonë fjalë të fuqishme, të dhembshura, të rrepta, por drejtësia e Athenës dhe Apolonit e mbron Orestin.

Orestit i bëhet gjyqi dhe Athina shfrytëzon parimin e së drejtës që ishte akoma në fuqi në Atikë, që n.q.s, i pandehuri merrte vota të barabarta me akuzuesin shpëtonte nga dënimi dhe në fund nga dy amforat që hidheshin votat u numëruan, ata dolën të barabarta dhe ankthi që e mbante pezull Orestin u shndërrua në gëzim e mirënjohje për Athenën. Kjo e bën Orestin ti shkëlqejë shpirti i trazuar dhe i lodhur nga ankthi dhe ikja e vazhdueshme, nga pritja e vendimit përfundimtar.

Përfundim: Sipas Jordan Peterson, femra është natyra, kaosi dhe rregulli. Qeniet njerëzore janë primat social, meshkujt janë hierarkia dominante ndërsa femrat subdominante. Kaosi sipas studiuesit

²⁶ Eskili, (1982), Tragjedi, Orestia, Rilindja, Prishtinë, fq. 84

Peterson vjen nga e panjohura. Rigjenerimi i stabilitetit vjen nga sfera e kaosit.²⁷

Sikurse te Iliada, prej së cilës rrodhën shumë vepra tjera të shkruara, nga Eskili, Euripidi, Sofokliu, etj, te të cilat hasim një mori perëndish e perëndeshash (të njëjtë) të cilët kanë një rol të jashtëzakonshëm, në disa raste madje edhe parësor. Kështu më i madhi i perëndive të Olimpmit, Zeusi përveç funksioneve të tjera është edhe zot i besës, mikpritjes, etj. Ai është në anën e akejve, bashkë me Athenën, Apolonin, etj, përveç Artemidës, motrës së Apolonit, e cila është ndihmëse e trojanëve dhe armike e akejve.

Nga poetika e Aristoteli e dimë që personazhet e tragjedisë janë mbretër, heronj, perëndi, gjysmëperëndi, etj, që janë të vetëdijshëm për mbarimin e tyre tragjik, por nuk zbrapsen për shkak të egos së tyre. Akti i rrëmbimit të Helenës ishte shkelje e nderit, miqësisë dhe mikpritjes, prandaj me kodet kanunore të atyre kohëve duhej të merret hak. Gjithashtu sipas Herodotit mes këtyre fiseve kishte pasur edhe rrëmbime të princeshës Medea dhe Hesiona nga ana e akejve dhe princeshës Ija nga fenikasis, bijë e mbretit Inah të Argosit. (Herodoti:5)

Nga Herodoti mësojmë se Agamemnoni ishte me origjinë nga Frigjia, pasardhës i drejtpërdrejtë i Pelopsit, birit të frigjianit Tantal, mbret i Frigjisë dhe Lidisë. (Herodoti; 389). Kjo vihet re në lutjen që i drejtohet Hekuba atij që t'i hakmerret mbretit të trakëve Polimistorit, të cilit ia besoi djalin, ndërsa ai e vrau dhe ia mori arin që kishte me vete. Pra ajo njihej me Agamemnonin sepse ishte me prejardhje frigjiane, ky fragment nga Euripidi dëshmon se kjo ishte luftë mes fisesh të njëjta.

''Arrin Agamemnoni. –Hekubë, përse nuk po vjen të marrësh trupin e vajzës e ta varrosësh? Sheh të vdekurin. Edhe një tjetër i vdekur këtu? Cili është ky? Hekuba rënë përmbys mbi kufomën nuk i përgjigjet. –

²⁷ Peterson, B. Jordan, (1999), Maps of Meaning, ROUTLEDGE, New York and London, fq.113

Përse nuk më flet? Cili është ky i vdekur?

Hekuba ngrihet dhe i përgjigjet: -Biri im është ! [...] Oh ç' kriminel, kur mësoi se ra Troja, ma vrau për t'i marrë arin ! ' (Euripidi :117)

Ndërgjegjja që kish treguar për pastërtinë e jetës së saj i shërben si kalim spontan të lutja që Agamemnoni ta ndihmojë atë për ti marrë hakun Polimistorit, në fillim Agamemnoni e refuzon por kjo ia kujton Kasandrën, vajzën e saj që ishte skllavja e tij. Ai pranon duke e këshilluar Polimistorin të shkojë te çadra e Hekubës bashkë me djemtë dhe skllavet e saj vrasin djemtë ndërsa mbretit thrakas ia verbojnë sytë. (Euripidi:121). Troja bie një pjesë e popullit vritet, gratë dërgohen skllave në Greqi, fëmijët e Hekubës dhe Priamit vriten, shpëton djali i Priamit nga një grua tjetër Heleni, i cili bashkë me Eneun dhe disa trojanë tjerë arrijnë të shkojnë në Romë, ku themelojnë kolonitë e veta dhe sipas studiuesit zviceran Eberhard Zangger, në vitin 250 p.e.r, Roma pranon prejardhjen e saj trojane.

Kjo luftë e tmerrshme dhe e çuditshme mes fiseve të njëjta ka qenë dhe është akoma aktuale, në vetëdijen e studiuesve, njerëzve të të gjitha profesioneve, ajo studiohet në të gjitha këndvështrimet, në atë të arteve marciale, traditave, zakoneve, ligjeve, kanuneve, kulturës, religjionit, gjuhës e gjenit, mitologjisë, etj.

Literaturë

Aristoteli, (1998), *Poetika*, Rilindja, Prishtinë.

Bekos, Janis (1991), Euripidi në prozë, Naim Frashëri, Tiranë.

Cermanovic, A. Srejovic, D. (1992), *Leksikon religjia i mitova drevne Evrope*, NOLIT, Beograd.

Eberhard Zangger (2016): *The Luëian Civilization: The Missing Link in the Aegean Bronze Age*. Ege Yayınları, Istanbul. 292 pages, 148 color illustrations. ISBN 978-605-9680-11-0

Eskili, (1982), *Tragjedi, Orestia*, Rilindja, Prishtinë.

Froj, Zigmund (2010), *Mbi letërsinë dhe artet*, Fan Noli, Tiranë.

Gerald, P. *Dictionary of Narratology*, (2010), Nebraska University Press.

- Harl, Kenneth, (1971), Great Ancient Civilisation of Asia Minor, Berkeley: University of California Press.
- Jung, Carl Gustav, (2010), Ese mbi gjurmimin e të pavetëdijshmes, Fan Noli, Tiranë.
- Kanuni i Lekë Dukagjinit, (2015) Shtëpia botuese Kuvendi, Shkodër.
- Kodra, Z. Et al. (1996), *Folklor Shqiptar Proza Popullore I*, Tiranë.
- Lotman, J. (2005), *Strukturata na umetnickoite tekst*. Detska Radost, Shkup.
- Menninger, Karl, Man Against Himself, (1985), San Diego : Harcourt Brace Jovanovich.
- Peterson, B. Jordan, (1999), Maps of Meaning, ROUTLEDGE, Neë York and London.
- Shepherdson, Charles, (2008), Lacan and the Limits of Language, Fordham University Press Neë York.
- Tresider, J.(2001), *Речник на симболи*, Детска Радост, Скопје.
- Zhenet, Zh. (1985), *Figura*, Rilindja, Prishtinë.

VALBONA SINANAJ

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë
valbona.sinanaj@gmail.com

SOTIR PAPAHRISTO SI NJË ORGANIZATOR I ARSIMIT KOMBËTAR DHE KONTRIBUTI I TIJ PEDAGOJIK

Periodha para Rilindjes e shqipes letrare është periodha e dokumentimit dhe e kristalizimit të saj si gjuhë e shkruar. Në fillim të kësaj periudhe gjuha shqipe është shkruar kryesisht nga klerikët dhe priftërinjtë për nevojat fetare. Tri dokumentet e shkruara të shqipes: “Formula e Pagëzimit”²⁸, “Fjalori i Arnold von Harfit”²⁹ dhe “Perikopeja e Ungjillit”³⁰ megjithëse janë shkrime të pjesshme, kanë rëndësi historike sepse dëshmojnë që shqipja ka qenë e shkruar qysh në atë kohë, si në Veri (që ishte nën ndikimin e kulturës latine), ashtu edhe në Jug të Shqipërisë (që ishte nën ndikimin e kulturës bizantine-greke).

Lufta për gjuhën e shkruar shqipe që shqiptarët kanë zhvilluar në shekuj, përfaqëson përpjekjet e tyre për të ruajtur e afirmuar identitetin kombëtar, dëshirën e tyre për të folur dhe shkruar shqip. Këto përpjekje i shprehën fuqishëm rilindësit, të cilët ishin jo vetëm patriotë të mëdhenj, por edhe mendimtarë të shquar me ide përparimtare e demokratike të kohës. Çlirimin kombëtar të shqiptarëve ata nuk e ndanin kurrë nga progresi social i tyre. Rilindësit i jepnin rëndësi lëvrimin dhe zhvillimit të gjuhës shqipe, njësimin të alfabetit,

²⁸“Formula e Pagëzimit” (1462), është një tekst i shkurtër, i shkruar në gegërisht me alfabetin latin, nga kryepeshkopi i Durrësit, Pal Engjëlli. Në përmbajtje të tij është një formulë pagëzimi, e cila ka vlera historike. Ky dokument është zbuluar nga Nikolla Jorgo në bibliotekën e Firences, në vitin 1915.

²⁹ “Fjalori i Arnold von Harfit” (1496), është i një udhëtari gjerman, i cili duke u ndalur në Ulqin, Durrës e Sazan për nevoja komunikimi shënoi aty 26 fjalë, 18 fraza e 12 numërorë shqip, me përgjegjëset në gjermanisht.

³⁰ “Perikopeja e Ungjillit” ose “Ungjilli i pashkëve” sipas Matheut (shek. XV), i cili përbëhet prej dy pjesësh të vogla shqip, brenda një dorëshkrimi greqisht, Dokumenti është shkruar në dialektin toskë me alfabetin grek.

hapjes së shkollave në gjuhën shqipe. Këtu e ka burimin edhe thirrja patriotike e rilindësit Naim Frashëri: “Dhe drita e diturisë, përpara do të na shpjerë, përpara drejt lirisë!” J. De Rada në “Testamentin politik” ka shkruar: “Ndoshta përgatitje e shumëdëshiruar e kësaj gjendje përfundimtare është zgjimi i ndërgjegjes kombëtare shqiptare, e cila ka nevojë të njësohet në studimin e gjuhës së vet, në një kundrim punëtor dhe shërbyes të lavdive të shkuara...”³¹.

Në këtë kumtesë do të paraqesim një pjesë të kontributit të Sotir Papahristos, si drejtues në institucionet arsimore shqiptare dhe si studiues i talentuar në fushën e pedagogjisë.

Historia dhe letërsia shqiptare janë burimi kryesor i dokumentacionit për zhvillimin e idesë kombëtare në Shqipëri. Ndërmjet fundit të shekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XIX vërehen përpjekje individuale gjuhësore dhe letrare të intelektualëve shqiptarë, por vetëm pas Lidhjes së Prizrenit (1878-1881) merr hov dhe zhvillohet jeta kulturore kombëtare, hapen shkollat në gjuhën shqipe, lulëzon letërsia dhe zë fill përpunimi dhe pasurimi i gjuhës. Shqipja si lëndë shkollore do të hyjë në programet arsimore vetëm nga fundi i shekullit të XIX.

Shteti i pavarur shqiptar në vitin 1912 nuk trashëgoi një sistem arsimor kombëtar. Shkolla shqipe ka përkrahur një rrugë të mundimshme dhe të vështirë. Periudha nga shpallja e Pavarësisë (1912) deri në kongresin e Lushnjës (1920), shënon fillimin ligjor dhe formal të shteti shqiptar, gjatë së cilës ndërrohen pesë qeveri. Ministri më jetëgjatë është Luigj Gurakuqi, zgjedhja e tij në krye të punëve të arsimit në tre qeveri, i ka shtuar kësaj periudhe vlerat dhe kontributet në fushën e arsimit kombëtar. U zgjerua rrjeti i shkollave fillore, u hodhën hapat në arsimin e mesëm për vajza dhe djem.

Me rikthimin e Ahmet Zogut në pushtet (janar 1925- shkurt 1927) rifillon punimet Kuvendi Kushtetues, i cili miraton Statusin Themeltar të Republikës Shqiptare.³² Në artikullin 4, nga 145 artikuj

³¹ J. De Rada, *Il testamento politico*, Shejzat, nr. 5-6, 1964, f.189.

³² AQSH, Fondi nr. 295, viti 1925, dosja nr.86, fl.1-18.

që përmban ky Status përcaktohet se “Shqipja është gjuhë zyrtare”. Shqipëria nën drejtimin e Ahmet Zogut, është periudha më e konsoliduar në drejtim të zhvillimit të arsimit. Pikërisht në këtë periudhë, merr formë një nga reformat më të mëdha në fushën e arsimit, lufta kundër analfabetizmit. Shumë personalitete, një nga të cilët edhe Sotir Papahristo, kontribuan me punën e tyre për krijimin e legjistacionit të shkollës, krijimin e një sistemi të vetëm shkollor në të gjithë vendin, hartimin e programeve shkollore, si dhe përpjekjet për zgjerimin e sistemit shkollor në të gjitha nivelet.

Me një rëndësi të madhe për kohën është hartimi i “Ligjit për Administratën Civile të Republikës Shqiptare” dhe miratimi i tij, më 23 maj 1928. Dokumenti firmoset nga Ahmet Zogu, Ministri i Drejtësisë Hiqmet Delvina, Ministri i Punëve të Jashtme Iliaz Vrioni, Ministri i Arsimit Xhafer Ypi, Ministër i Punëve të Brendshme Koço Kotta, Ministri i Financave dhe Ministri i Bujqësisë e Pyjeve Milto Tutulani dhe Ministri i Punëve Botore Sali Vuçitërmi. Sipas këtij ligji, drejtori i arsimit ose i shkollës është nënpunës i administratës (Kreu II, art. 4); një nga detyrat e Prefektit dhe të nënpunësve të prefekturës është sigurimi i “përhapjes s’arësimit botuer” (Kreu IV, Artikulli 18, ç.); nënprefekti detyrohet në çdo katër muaj të bëjë një udhëtim në qarkun e vet me qëllim kontrollin e krahinave dhe shëtitjen e katundeve, gjatë të cilave duhet të këqyrë edhe përmbushjen e detyrave që lidhen me arsimin (Kreu V, Artikulli 35); krahinari “asht ma i madhi nëpunës i krahinës” dhe ndër detyrat e tij bën pjesë edhe kontrolli i vazhdimësisë së mësuesve në shkollë dhe “të shtrëngoje prindërit e nxansavet qi t’i dërgojnë fëmijën e tyre në për shkolla” (Kreu VI, Artikulli 43, h)³³.

Sotir Papahristo punon si Drejtor i Përgjithshëm i Arsimit, vetëm në kohën kur ishte Zogu President, me kryeministër Koço Kottën, post të cilin, ai e merr pas një kalvari të gjatë si inspektor në këtë drejtori duke zënë vendin e Mihal Sherkos. Së bashku me

³³ V. Nathanaili, *Rruga e mundimshme e shkollës shqipe. Çështje, politika & veprimtari në fushën e arsimit, 1912-1944*, Tiranë, 2016, f. 101.

personalitete të tjera të njohura si Aleksandër Xhuvani, Mirash Ivanaj, arrin të ndërtojë rregulloren dhe programet e para të arsimit. Në Kongresin Arsimor të Tiranës (1922), ku merr pjesë si delegat, Papahristoja bie në sy për përgatitje të lartë profesionale dhe prirjet e tij përparimtare për reformimin e shkollës shqiptare. Me pasion për punën megjithëse u gjend në kushte shumë të vështira të kohës, i emëruar si kryeinspektor i shkollave të prefekturës së Korçës, Papahristoja arriti të gjejë zgjidhjet për problemet që i dolën si mësues dhe inspektor. Me mbështetjen sidomos të ministrit të Arsimit Rexhep Mitrovica, ai u tregua shumë aktiv, duke shkruar jo vetëm artikuj të ndryshëm pedagogjikë, vepra didaktike, metodike dhe përkthime në shtypin e kohës, por edhe çështje të kulturës në përgjithësi si: “Mbi rritjen e foshnjës (përkthim) 1924; “Qeverimi i fëmijëve në shkollë” 1929; “Mësime shembullore për shkolla fillore dhe të mesme” 1930; “Hartimet dhe ushtrimet në shkollat fillore dhe të mesme” 1936, etj.

Krijimi i sistemit arsimor unik kombëtar si elementi më i rëndësishëm i reformës arsimore, kërkonte angazhimin e specialistëve të aftë, me dije teorike e praktike dhe njohës të mirë të situatës arsimore në vend. Drejtori i DPA, S. Papahristo, në prill 1925, i paraqiti ministrit të Drejtësisë, rregulloren për formimin e një komisioni teknik³⁴. Si kandidatura për komisionin ai propozoi personalitete të shquara të arsimit, si Leonidha Naçi (doktor në shkencat e matematikës e fizikës), dy normalistë e metodistë të shquar të arsimit, Gaspër Mikeli e Andon Paluca dhe një nga dijetarët më të mirë të gjuhës dhe me përvojë të gjatë në fushën e arsimit, Simon Shuteriqin. DPA në përfundim, pranoi në përbërje të komisionit teknik, S. Shuteriqin, G. Mikelin, M. Ivanajn, ndërsa L. Naçi do të merrte pjesë në mbledhjet e komisionit të jashtëm. Për punën e bërë ata do të paguheshin nga fondet e parashikuara në buxhetin e DPA³⁵.

³⁴ AQSH, F. 125, V. 1926, D. 1, fl. 177. Raport për lehtësim të administratës e lehtësim të burokracisë.

³⁵ Musaj, F. *Republika shiptare 1925-1928*, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë, 2018, f. 652.

Komisioni kishte si detyrë të trajtonte çështjet më thelbësore që shtroheshin para arsimit kombëtar si: përcaktimi i arsimit arsimor që do t'i përshtatej shtetit shqiptar, përpilimi i programit unik analitik për shkollat fillore të fshatrave, plotore dhe ato të mesme, plotësimi i ligjeve e i rregulloreve arsimore që ishin në veprim³⁶.

DPA e drejtuar nga Sotir Papahristo, Pertef Popogoni, deri në qershor të vitit 1927, krahas përgatitjes së bazës ligjore, u angazhua për zbatimin e saj dhe brenda mundësive që u lejonte buxheti, t'u jepnin zgjidhje disa prej çështjeve më të domosdoshme të arsimit. Para së gjithash ajo e drejtoi vëmendjen tek personeli ekzistues arsimtar sidomos në drejtim të aftësimin profesional. Gjatë vitit 1925, DPA organizoi kurse kualifikimi pothuajse në të gjitha prefekturat si në atë të Shkodrës, Kosovës, Dibrës, Beratit, Vlorës, Kavajës, Elbasanit, Gjirokastrës, Korçës etj., për të gjithë mësuesit e shkollave fillore që nuk kishin kryer arsimin e duhur për mësuesit³⁷. Nën drejtimin e DPA, u hartuan disa rregullore për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe në organizimin e shkollave, shfrytëzoi buxhetin e caktuar për botimin e librave shkollorë, duke i hartuar ato sipas parimeve të psikologjisë e të metodikës, në mënyrën e të shkruarit të tyre, duke u larguar nga dialekti me bazë gegërishten, në mënyrë që ato të kuptoheshin edhe nga shkollat e krahinave të Jugut³⁸.

Shumë filozofë, psikologë e pedagogë përmes kërkimit të tyre e kanë analizuar të nxënësit për shekuj me radhë. Shumë teori janë përcaktuar rreth tij, por në një mënyrë ose tjetrën ato kanë ndikuar mbi metodat e mësimdhënies, janë vëzhguar e kontrolluar gjatë praktikës në klasë, duke u bërë kështu një repertor pedagogjik, i larmishëm i punës së mësuesve. Të gjitha këto teori ose praktika të të nxënësit të cilat janë pranuar, kanë dëshmuar se çelësi i suksesit të tyre është krijimi lidhjeve profesionale, por në mënyrë të veçantë

³⁶ Po aty.

³⁷ AQSH, F. 125, V. 125, D. 9, fl. 3. Raporti i DPA, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, për përmirësimin e punës së mësuesve, Tiranë, më 5 qershor 1925.

³⁸ AQSH, F. 35, V. 1925, D. 168, fl. 157. Njoftim për hapjen e librarisë "Lumo Skëndo dhe Kristo Luarasi", Tiranë, maj 1926.

përshtatshmëria me qëllimet arsimore dhe me metodat mësimore që zhvillon, realizon e përmbush shkolla.

Ekzistojnë studime të shumta rreth procesit të të nxënit në shkolla. Të nxënë të është një proces i vazhdueshëm dhe kompleks, dhe si i tillë, të kuptuarit rreth tij nuk mund të përfundojë asnjëherë. Është e vështirë të depërtosh në mendjen e nxënësit, por duhen gjetur mënyrat e duhura për të drejtuar këtë proces. Studimet kanë vënë re që për një kohë mjaft të gjatë në shkollat tona, dominues në shkollë ka qenë mësimdhënia që nënkupton një proces mësimor që sundohej plotësisht nga mësuesi.

Ndërveprimi pedagogjik nënkupton që procesi mësimor, të ketë në themel ndërveprimin si filozofi dhe praktikë, brenda të cilit nxënësi të ndihet mirë, të motivohet vazhdimisht, duke u bazuar mbi nevojat dhe interesat e tij, në përputhje sa më të plotë harmonike me kërkesat dhe trysinë që mbart në vetvete shkolla dhe programet e saj.

Për vetë natyrën e tij, të nxënë lidhet me shumë elementë, të cilët e bëjnë funksionale atë si proces, vetëm përmes koordinimit dhe bashkërendimit të tyre me njëri-tjetrin:

- Atmosfera e përgjithshme psiko-shoqërore në mjedisin e të nxënit.
- Marrëdhëniet midis mësuesit dhe nxënësve.
- Format e komunikimit pedagogjik.
- Qëllimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënit.
- Metoda, teknikat e mësimdhënies dhe të të nxënit që plotësojnë kërkesat për natyrën e njohurive dhe qëllimet e të mësuarit.

Sotir Papahristoja, një personalitet arsimor me shumë vlera dhe me kontribute në arsimin shqiptar të periudhës 1920-1939, si mësues, drejtues shkolle, inspektor, specialist në Ministrinë e Arsimit, drejtor i Drejtorisë së Parë Qendrore të Arsimit në Tiranë, që më vonë u kthye në Ministri Arsimit, si dhe më pas në detyra dhe poste shtetërore, trajton elemente të pedagogjisë aktive që zbatoheshin në procesin mësimor, nëpërmjet shkrimeve të tij në revistën “Normalisti”. S. Papahristoja dalloi si studiues në fushë të pedagogjisë, duke vepruar

me mendësinë e një shkencëtari.

Duke vlerësuar studimin e Papahristos “Qeverimi i fëmijëve në shkollë”, botuar në Tiranë, më 1929, albanologu i njohur italian Gaetano Petrotta, në librin e tij të njohur “Popolo, lingua e letteratura albanese” (Palermo, 1931), e çmoi lart këtë studim me fjalët: “Sotir Papahristo drejtor i Liceut të Korçës, ka shkruar një vepër interesante pedagogjike për disiplinën e shkollës, pra një punim që sillet rreth regjimit disiplinor të fëmijëve gjatë jetës së tyre shkollore. Dhe vepra e këtij mësuesi të ndritur, përbën një ndihmesë të çmuar në letërsinë shkencore shqiptare”³⁹.

Në shkrimet e tij pedagogjike, Papahristoja rrahu të gjitha çështjet themelore të mësimit dhe edukimit që dalin para shkollës, familjes dhe shoqërisë shqiptare. Veçanërisht i shqetësuar duket Papahristoja në çështjen e madhe të përmbajtjes mësimore të shkollës, me atë çfarë merrte nxënësi si dituri dhe me çfarë brumosej ai si qytetar në shkollë. Në një artikull studimor botuar në revistën “Bota e re”, në gusht 1936, duke polemizuar për çështjen e përmirësimit të programeve mësimore, Papahristoja si mendimtar i lirë dhe i përparuar, kërkon që mësuesi të bëjë punë krijuese të diferencuar, sipas niveleve të shkollës dhe të nxënësve, sepse vetëm kështu do të lulëzonte personaliteti njerëzor, sipas dhuntive me të cilat e kishte pajisur natyra⁴⁰.

Fjalitë e mëposhtme të Papahristos, janë tregues të qartë të motivit të tij të fortë e profesional për metodat e pedagogjisë aktive:

“Një mësues me dije të gjanë mbi mjeshtërinë e tij, me një dashuri për punë dhe një dëshirë për pëmirësim, nuk mund të rrijë në nivelin që gjindet, por kërkon e vëzhgon gjana të reja. E për të mbrimë këtë gjendje, duhet ta lëjë mënjanë programin e të mos bëhet skllav i tij. Programi i zbatue pikë për pikë, asht një zinxhir që e lidh mësuesin këmbë e duar, e nuk e lë shpirtin e tij të kullosë lirisht në fushat pedagogjike që atij i tregon teoria dhe praktika, e ndihmon që të bjerë shpejt në rutinë. Ja ku na del përpara rutina, ky zinxhir

³⁹ G. Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura Albanese*, Palermo, 1931.

⁴⁰ <http://www.forumshqiptar.com/threads/55165-Sotir-Papahristo-njeriu-i-arsimit>,

skllavërimi i mendjes njerëzore, ky krimb që na bren e na paralizon shpirtin e që na mekanizon trurin”⁴¹.

“Një të mësuar pasiv nuk zhvillon pavarësi mendjeje as vetveprim. Nxënësit e sotshëm kanë frikë të shfaqin mendimin e tyre lirisht, nuk kanë iniciativë. Aktiviteti fitohet vetëm me anë të vetveprimit, vetëm me zbatimin e njohurive”⁴².

“Në një klasë të mbaruar/të përkryer, duhen vetëm aktorë dhe jo spektatorë, cilido duhet të lozë rolin e tij”. Fëmija ka brenda vehtes shumë zotësi, të krijojë, të fantazojë, të ndryshojë...këto cilësi duhet t’ua drejtojnë e zhvillojnë”⁴³.

...nevoja e fëmijës është veprimi i tij, aty gjen kënaqësi e interes, atje ku ka gjallësi, aktivitet, emocion...⁴⁴.

“Qëllimi i shkollës së re nuk është me përgatit nxënësin për jetën, por me e ba atë të rrojë.

Shkolla është jetë. T’i afrohem parimit të Spenserit “me mësue sa më pak që të jetë e mundur, me ba e me gjetë sa më shumë të jetë e mundur”⁴⁵.

Në udhëtimin e gjatë dhe kompleks të të nxënës, mësuesi duhet ta shoqërojë nxënësin, duke e inkurajuar dhe motivuar, ta mbështesë në vështirësitë dhe ta ndihmojë që t’i kapërcejë pengesat. Ai duhet të jetë një lehtësues gjatë procesit të nxënies, duhet pra, të krijojë kushte optimale për t’ia bërë më të lehtë mësimin nxënësve të tij.

Klasa është një mjedis ku ndërveprojnë aktorë, si mësuesi, nxënësi që luajnë role të përcaktuara qartë. Funkcioni i klasës duhet të perceptohet jo vetëm si mjedis fizik ku mësojnë nxënësit, por edhe si vend social.

Në veprën “Profeti” të K. Xhibran⁴⁶ roli i mësuesit përkufizohet: “Nëse mësuesi me të vërtetë është i zgjuar, ai nuk duhet t’ju urdhërojë

⁴¹ S. Papahristo, Revista “Bota e re”, Nr. 3, Korçë, 1936.

⁴² S. Papahristo, Revista “Normalisti”, Nr. 1, nëntor 1936.

⁴³ S. Papahristo, Revista “Normalisti”, Nr. 1, janar 1937. Thënie e A. Vessiot.

⁴⁴ S. Papahristo, Revista “Normalisti”, Nr. 1, maj 1933.

⁴⁵ S. Papahristo, Revista “Normalisti”, Nr. 1, shkurt 1934.

⁴⁶ Është artist, poet dhe shkrimtar libanezo-amerikan.

që të hyni në dhomën e tij të dijes, por përkundrazi, t'ju drejtojë drejt fillimit të mendimit tuaj”.

Ndërveprimi tek nxënësit zhvillohet normalisht përmes dy elementëve:

Bashkëpunimit dhe Motivimit.

Përmes bashkëpunimit stimulohet të nxënit e nxënësve. Kështu, mësuesit sugjerojnë përdorimin e metodave ndërvepruese, të cilat të jenë mbizotëruese në procesin mësimor, proces i cili duhet të jetë i mbushur me sa më shumë veprimtari aktive dhe ndërvepruese.

Kjo ka bërë të mundur dhe reformimin e procesit mësimor, që lidhet me mësimdhënien dhe të nxënit, i cili duhet :

- Të identifikojë nevojat e nxënësve për të nxënë.
- Të identifikojë vështirësitë që ata paraqesin në këtë proces.
- Të përzgjedhë metoda, teknika, strategji për t'i përdorur në mësim, në mënyrë, që të krijojë ndërveprim dhe që stimulojnë të nxëturin.

Motivimi është një proces, që nxit e stimulon vazhdimisht nxënësin në procesin e të nxënit. Në këtë kuptim, motivimi përfshin nxënësit, mësuesit, familjen, qëndrimet e marrëdhëniet e tyre me të mësuarin, duke i parë ato të lidhura me qëllimet, synimet dhe objektivat e tij, pa lënë mënjanë mjedisin mësimor. Brenda motivimit kemi të bëjmë dhe me gjendjen shpirtërore të vetë nxënësit. Nëse ai ndihet mirë, sigurisht ai do të përpiqet të mësojë dhe të arrijë dhe rezultate të kënaqshme. Nëse ky besim, optimizëm i mungon, ky përbën një element vështirësie për ecurinë e tij.

Nxënia aktive nënkupton një tërësi elementesh që duhen zhvilluar në procesin e të nxënit. Të nxësh do të thotë të pasurosh përvojën tënde me një përvojë të re. Të zotërosh njohuri do të thotë të jesh në gjendje t'i përdorësh ato. Nxënësi është partner me mësuesin gjatë nxënies së tij dhe mësimdhënia duhet të bëhet sa më tërheqëse nga ana e mësuesit, me qëllim që të arrihet në një nxënie të kënaqshme nga ana e nxënësit.

Teoritë konstruktiviste dhe social-konstruktiviste me përfaqësues

Piazhenë⁴⁷ dhe Vigotskin⁴⁸, të cilat i kanë dhënë rëndësi gjuhës dhe të folurit, po gjejnë mbështetje në kurrikulën e zbatuar në shkollat e vendeve perëndimore. Këto pikëpamje dhe praktika bazohen thellësisht mbi ndërveprimin njerëzor, duke e rekomanduar atë në fushën e edukimit nëpërmjet ndërveprimit aktiv pedagogjik.

Të gjitha problemet që lidhen me procesin e mësimdhënies si dhe marrëdhëniet midis mësues-nxënës-shoqëri, si një tërësi elementesh që zhvillojnë procesin e të nxënës u trajtuan dhe u studiuan nga intelektualit me ide përparimtare, mësuesi i ndritur Sotir Papahristo, i cili dha një ndihmesë të çmuar edhe në fushën e pedagogjisë. Sotir Papahristo do të mbetet personifikimi i studiuesit me ide përparimtare që punoi me mendësinë e një shkencëtari.

Përfundime

Me këtë kumtesë u përpoqëm të paraqesim një pjesë nga kontributi i madh i Sotir Papahristos, si organizator i arsimit kombëtar dhe si studiues i talentuar në fushën e pedagogjisë shqiptare.

Sotir Papahristo do të mbetet një personalitet me shumë vlera dhe me kontribute në arsimin shqiptar; një mësues i talentuar, organizator, inspektor, drejtues, specialist me një veprimtari të rëndësishme teorike dhe praktike në fushën e arsimit, intelektual me një horizont të gjerë, njeri praktik, krijues dhe origjinal, përkthyes, studiues i talentuar në fushën e pedagogjisë shqiptare.

Gazeta “Koha” e Mihal Gramenos, e ka quajtur kolosale veprën dhe punën e Papahristos në krye të dikasterit të arsimit: “Për punën që

⁴⁷Piazhe njihet si babai i teorisë konstruktiviste të të nxënës. Procesin e njohjes e lidh me aspektet psikologjike dhe gjenetike, gjithashtu thekson se njohja e fëmijës ndërtohet mbi njohjen paraprake dhe se sistemi i tij paraqet një sistem dinamik në zhvillim.

⁴⁸Vitgosti është bashkëthemeluesi i teorisë konstruktiviste bashkë me Piazhenë dhe themelues i teorisë social-konstruktiviste, por ndryshe nga Piazhe, ai thekson se procesi i të nxënës është rezultat i ndërtimit të dijes në ndërveprimin social të fëmijës me mjedisin që e rrethon, dhe se është gjuha që e mundëson një gjë të tillë. Qëndrimet e tij për të nxënës e gjuhës si proces social e konfirmojnë edhe studimet e bëra në fushën e neuroshkencës. Në një studim të bërë në Angli me binjakë identik dhe joidentik është konstatuar se edukimi dhe kultura kanë rëndësi më të madhe se roli i trashëgimisë (gjenetikës).

bëri z. Papahristo si drejtues i përgjithsëm i arsimit, çdo lëvdim na duket i vogël”⁴⁹ – shkruan gazeta e njohur demokratike.

Literaturë

AQSH, Fondi nr. 295, viti 1925, dosja nr. 86.

AQSH, F. 125, V. 1926, D. 1, fl. 177. Raport për lehtësim të administratës e lehtësim të burokracisë.

AQSH, F. 125, V. 125, D. 9, fl. 3. Raporti i DPA, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, për përmirësimin e punës së mësuesve, Tiranë, më 5 qershor 1925.

AQSH, F. 35, V. 1925, D. 168, fl. 157. Njoftim për hapjen e librarisë “Lumo Skëndo dhe Kristo Luarasi”, Tiranë, maj 1926.

Gazeta, “Koha”, Korçë, dt. 05.09.1925.

Petrota, G. *Popolo, lingua e letteratura Albanese*, Palermo, 1931.

Lafe, G. *Disa saktësime lidhur me përcaktimin e italianizimeve në gjuhën shqipe*, në “Perla”, Revistë shkencore-kulturore 2018/2.

Memushaj, R., *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë, 2008.

Musaj, F. *Republika shiptare 1925-1928*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë, 2018.

Nathanaili, V., *Rruga e mundimshme e shkollës shqipe. Çështje, politika & veprimtari në fushën e arsimit, 1912-1944*, Tiranë, 2016.

Osmani, T. *Shekulli i komisisë letrare shqipe në Shkodër (1916-1918)*, Tiranë, 2016.

Papahristo, S., Revista “Bota e re”, Nr. 3, Korçë, 1936.

Papahristo, S., Revista “Normalisti”, Nr. 1, maj 1933.

Papahristo, S., Revista “Normalisti”, Nr. 1, shkurt 1934.

Papahristo, S., Revista “Normalisti”, Nr. 1, nëntor 1936.

Papahristo, S., Revista “Normalisti”, Nr. 1, janar 1937.

Petrota, G., *Popolo, lingua e letteratura Albanese*, Palermo, 1931.

<http://www.forumishqiptar.com/threads/55165-Sotir-Papahristo-njeriu-i-arsimit>

⁴⁹ Gazeta “Koha”, Korçë, dt. 05.09.1925, nr. 236.

PANDI BELLO

Korçë

pandibelo@yahoo.com

SOTIR PAPAHRISTO DHE PORTRETI I TIJ KULTUROR

Sotir Papahristo u lind në Vëmbel, një fshat pranë kufirit shqiptaro-grek, në vitin 1887. Pas mësimëve të para në shkollën e fshatit dhe pastaj në gjimnazin serb të Manastirit, kreu gjimnazin grek në Korçë. Studimet universitare i bëri në Univeritetin e Athinës. Ditën e fillimit të Luftës të koalicionit ballkanik kundër Perandorisë Otomane, pra më 5 Tetor 1912 (siç shkruan ai në kujtimet e veta), u diplomua në këtë universitet, në specialitetin e Filologjisë.

“Fati im s’deshti të më largojë nga studimet e klasikëve të vjetër grekë, për të cilët kisha një dashuri të veçantë dhe me të cilët do të lozja më vonë një fare roli të dobishëm si profesor dhe si shkrimtar”, - shkruante Sotir Papahristoja kur po i afrohej viteve të fundit të jetës.

Kultura e tij filologjike ishte e jashtëzakonshme, ndërsa tragjedianët dhe filozofët e Antikitit grek, po ashtu. Personazhet e veprave të tyre ishin figurat më të larta morale dhe më të afërta shpirtërore për të. I frymëzuar prej tyre ai filloi rrugën e tij në përhapjen e dijes së pari në gjimnazin grek të Korçës, gjatë një periudhe të tensionuar dhe komplekse në vitet 1912-1920 dhe vazhdoi pas kësaj si Inspektor e Kryeinspektor i Arsimit dhe Drejtor i Liceut Kombëtar francez në Korçë. Në Tiranë, një kohë ai ishte Drejtori i Përgjithshëm i Arsimit dhe Drejtor i Institutit Femëror “Nëna mbretëreshë”. U emërua në këtë detyrë me vendosmërinë e ministrit të arsimit të asaj kohe Mirash Ivanaj, i cili, kur do të çelej shkolla, pra në vitin 1933, kishte deklaruar: “Ja vjen Papahristo si drejtor i Institutit, ja nuk e çel fare shkollën”. Mirëpo, në maj të viti 1939, ministri i ri Ernest Koliqi e transferoi në gjimnazin e Shkodrës. Siç shënon Papahristoja në jetëshkrimin e vet, si shkak iu përmend fakti se “nxënësit e Institutit ishin tepër patriotë dhe në disa raste shfaqën

hidhërimin për humbjen e pavarësisë dhe urrejtjen ndaj Italisë fashiste”.

E gjithë veprimtaria pedagogjike dhe aktiviteti letrar i Papahristos, përkthimi i një numri impresionant nga veprat e shkrimtarëve të lashtë grekë, u udhëhoqën nga besimi i tij në praninë e disa vlerave të përhershme themelore në jetën e njeriut. Ndër to, liria njerëzore, e dobishmja, e vërteta, liria krijuese, e bukura, ishin edhe shtyllat mbi të cilat u ngrit në kohët e vjetra shoqëria helene.

Kur Papahristoja e filloi aktivitetin e vet prej korifeu të kulturës, Shqipëria po shkëputej nga periudha më e errët e historisë së saj. Vendi, pra, duhej të nisej drejt Evropës dhe në këtë udhëtim duhej të fitonte sa më shumë nga koha e humbur. Papahristoja ishte i bindur se vlerat themelore njerëzore dhe kategoritë bazë të etikës kanë një ndikim të madh në emancipimin e shoqërisë dhe në formimin e personalitetit të njeriut. Në konferencat me karakter pedagogjik dhe në artikujt e tij për parimet didaktike, por edhe në konferencat për artet dhe kulturën, mund të konsatatohet shpirti evropian dhe analiza racionale. Pikërisht drejt këtij modeli kishte filluar të orientohej kultura shqiptare.

Sotir Papahristoja e lidhte kulturën me zhvillimin e një arsimit cilësor dhe në një masë të caktuar të zgjeruar. Kështu i trajtoi ai problemet e sistemit shkollor në fillim të viteve '20 të shek. XX. Sigurisht në këtë lëvizje të madhe arsimore kur do të hidheshin baza solide, në kushtet e lirisë kombëtare më në fund të fituar, ai dha një rol të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm edhe kulturës klasike. Po ashtu ai tërhoqi vëmendjen e opinionit shoqëror mbi “dobitë e gjimnastikës dhe të atletizmit” dhe mbi “ndikimin që ushtron muzika mbi shpirtin dhe karakterin e njeriut”.

Sotir Papahristoja e mendonte krejt të veçantë dhe posaçërisht human misionin e mësuesit. Në artikullin *Dashuria e nxënësve për mësonjësin*, parimet pedagogjike ndërtohen mbi bazën e një raporti njerëzor thelbësor. Ai shkruante : “Kur një nxënës ndjen dashuri të vërtetë për mësonjësin e tij, padyshim do të përpiqet të mos i sjellë

kurrë ndonjë herë pengime në punën e tij”. Nga ana tjetër ai thekson se : “Mësonjësi i cili kupton se nuk do mundë të ndiejë e të ushqejë një dashuri për natyrën e fëmijëve do të bënte shumë mirë të mos e merrte përsipër detyrën e mësonjësit”.

Në kujtimet e veta helenisti i shquar shkruante ndër të tjera: “Duke dashur të vihen themelet e një rinie të shëndoshë moralisht dhe fizikisht, botova nga fundi i vitit 1924 librin Boiskautizma”. Pothuajse gjithçka që shkroi dhe përktheu Papahristoja pati një efekt me vlerë si në aspektin teorik edhe në atë praktik, veçanërisht në mjedisin korçar. Ai nuk ndalej vetëm me botimet tij me tematikë të paprekur deri në atë kohë. Në gazetën *Koha* të Korçës, më 20 Mars 1926 jepej ky njoftim : “Boiskautizma në qytetin tonë po formohet në sistemin e fundit me përkudeshjen e Z.Sotir Papahristo, Direktorit të Lisesë. Gjer më sot janë shkrojtur 50 djema, të gjithë të shëndoshë, të cilët kanë paguar edhe të hollat për uniformën që prej kohësh u porositën në Paris”.

Papahristoja kishte një formim klasik dhe ashtu edhe si helenisti tjetër i shquar i Korçës, profesor Spiro Konda, njihej si adhurues i muzikës. Të dy ishin edhe kitaristë të zotë. Luanin në kitarë klasike. Vajza e Papahristos, pianistja Vasilika Papahristo-Petrela na ka pohuar gjatë një bisede se kur ishte e vogël dhe jetonte akoma në Korçë, pati dëgjuar nga pllakat e gramafonit të tyre mjaft vepra të kompozitorëve klasikë. I pati bërë përshtypje të veçantë atëhere pjesa ciklike për piano e kompozitorit rus Modest Musorgskij, të cilën e kishte aranzhuar për orkestër njëri prej themeluesve të impresionizmit muzikor, kompozitori francez Maurice Ravel.

Nga gjithë sa ka shkruar mund të thuhet se Papahristoja ishte jo vetëm një admirues i artit, por edhe një propagandues aktiv i tij. *Gazeta e Korçës* e datës 24 Nëntor 1925 lajmëronte se profesor Sotir Papahristoja dha një konferencë në Shoqërinë e Arteve të Bukura, duke folur mbi dobinë dhe zhvillimin e tyre në vendin tonë dhe mbi qëllimet e shoqërisë në fjalë. Ai entuziazmohej kur të rinjtë e kwsaj shoqërie, e cila luajti një rol të pakrahasueshëm me formacione të tjera

në jetën artistike të Korçës menjëherë pas konsolidimit të Pavarësisë të shtetit shqiptar, vinin në skenë pjesë teatrale, apo kur shfaqnin koncerte, tw cilat mund të perjetoheshin gati me të njëjtin gëzim edhe sot. I përshëndeste këto veprime me entuziazëm të madh. Në numrin e datës 31 Maj 1924 në *Gazeta e Korçës*, pas komentit që i bënte shfaqjes të komedisë *''Nata e mëshirës''*, Papahristoja shkruante: *''Në 6 Prill dha koncertin e parw Orkestra Simfonike në sallën e Kopështores të Mitropolisë''*dhe theksonte në vazhdim se me këtë koncert u dha rasti *''të shkojmë një jetë të shkurtër në një sferë të lartë e të kulluar me anën e influencës të artit divinae''*. Ai shtonte më tej se *''atje ku lulëzojnë artet e bukura do të gjesh përgjithësisht virtyte të larta, ndjenja të holla e fisnike, vepra njerëzore, dashuri mëshirë, njerëzim''*.

Sipas rrëfimit të vajzës të Papahristos,pra Vasilikas,ai e adhuronte qytetin e tij, Korçën e viteve parardhëse të Luftës së II Botërore. Shëtiste shpesh në zonën Panda-Shetro, sodiste qytetin nga kodra e Shën Thanasit dhe ëndërronte se si mund të zhvillohej më tej, mendonte për progresin e vazhdueshëm të kësaj qendre me tipare të kulturës europiane. *''Unë isha i lidhur ngushtë me Korçën – shkruante ai. Aty isha rritur, mund të thoni, aty kisha bërë studimet gjimnaziale, aty kisha qenë profesor i gjimnazit gjatë dhjetë viteve, aty u martova dhe u lidha me një rreth familjar nga më të shquarit e qytetit, nga të cilët më ishte e vështirë të shkëpitesha''*.

Dashuria për vendin dhe dashuria për punën, këmbëngulja në arritjen e një rezultati me vlerë dhe të rëndësishëm në krijimtarinë e tij intelektuale si dhe toleranca në marrëdhëniet me njerëzit ishin parimet e paluejtshme për Papahriston. Ai besonte fort në lirinë dhe kënaqësinë që dija i falte njeriut.

Njerëzit që e patën njohur nga afër na e kanë përshkruar si një shembull *sui generis* tw edukatës që bazohet në vlerat e larta të normave shoqërore, po ashtu si njeri të dashur dhe korrekt, pa asnjë shenjë urrejtjeje për këdo që ndeshte ngado dhe përkrahës të moralit të lartë kristian. Me fjalë të tjera, mund të thuhet se ishte një

personazh i formuar në mënyrë të harmonishme, pra nga ato personazhe që nuk i has patjetër kudo dhe kurdo në këtë botë të ndërlikuar. Virtytet e tij u shprehën jo vetëm në veprimet e tij për përhapjen e një morali të shëndoshë shoqëror, por edhe në faktin se përmes qëndrimeve dhe sjelljes së tij përmes formës së komunikimit Papahristoja ishte edhe mishërues i drejtpërdrejtë dhe plotësisht i sinqertë i këtyre vlerave.

Për shkak të cilësive të tilla, por edhe për arsye të karakterit të tij në tërësi, gjithashtu për shkak të dijeve të mëdha të natyrës enciklopedike, shtëpia e tij në Tiranë, pasditet e të dielave shndërrohej në një vatër të diskutimeve të vërteta akademike. Ndër vizitorët dhe bashkëbiseduesit e zakonshëm ishin edhe personalitetet e lartë të kulturës kombëtare si gjuhëtari Eqrem Çabej, historianët Aleks Buda dhe Petraq Pepo, poeti Lasgush Poradeci, shkrimtarët Mitrush Kuteli dhe Sterjo Spasse etj. Në këto biseda binte në sy konsequenca dhe ndershmëria intelektuale e Papahristos, sigurisht edhe e shumë prej miqve të tij. Padyshim se ndër vizitorët e shpeshtë të Sotir Papahristos ishin edhe figura të tjera më pak të famshme në historinë e kulturës kombëtare sesa të lartpërmendurit. Për mjaft prej tyre bisedat me filologun e shquar i ngjanin një leksioni të vërtetë dhe shumë dobiprurës .

Sot kur për shkak të rënies kulturore po ndeshemi me deformimin e vlerave humaniste dhe zbehjen e idealit të vërtetë të dijes, Sotir Papahristoja, përmes dinjitetit njerëzor që e karakterizonte si dhe në sajë të rezultateve të pazakonta të aktivitetit të tij të shumanshëm mund të shihet si modeli udhëzues dhe shembulli i të gjithë atyre që ndjekin pasionet e mëdha dhe qëllimet më sublime jetësore.

ILIR SHYTA
Universiteti i Korçës
ilirshyta@yahoo.com

UTILITET PËRMES PËRKTHIMIT “FOSH NJA”, SJELLË NË SHQIP NGA SOTIR PAPAHRISTO

Përkthimet hapën portën e ekzistencës kombëtare dhe u dhanë shkollave shqiptarëve tekste interesante, frymëzuese dhe utilitare, duke kultivuar në këtë prizëm zbatimin e dijes ndër shtetas. Në këtë kuadër, Sotir Papahristoja mbetet një ndër emrat përveçues të këtij misioni me vlerë mbarëkombëtare në disa drejtime, kryesisht në fushën e iluminimit arsimor, të kulturës, përkthimit dhe publicistikës.

Kështu, në fundin e shekullit XIX dhe fillimin e shekullit XX, forcat intelektuale shqiptare u angazhuan në nisma konkrete arsimore për krijimin e një ambiguiteti kulturor në gjuhën shqipe. Tekstet e përkthyer, mbeteshin projekte me vlerë jo vetëm individuale, për një emancipim koherent dhe praktikë cilësuese si ndër më të përzgjedhurat, nga shumësia globale.

Sotir Papahristoja ishte drejtor administrativ i Liceut Francez të Korçës, ndërsa bashkëpunoi ngushtë me Spiro Kondën, Eqrem Çabejn, Aleksandër Xhuvanin apo profesorin francez Bally Konte. Më 1925, ai emërohet në Tiranë, drejtor i përgjithshëm i Arsimit Shqiptar, duke u bërë kështu një zë i fuqishëm në arsimimin kombëtar. Salloni i tij personal në Tiranë ka qenë qendër e takimeve intelektuale të kohës. Pas çlirimit të vendit Sotir Papahristoja merret denjësisht me përkthime pedagogjike, didaktike dhe metodologjike si “Bioskautizmi”, “Foshnja” ose “Mbi rritjen e foshnjës”, “Jeta e Pirros, sipas Plutarkut”, “Jeta e Marit sipas Plutarkut”, “Pjesë nga moralet e Plutarkut” dhe “Karakteret e Theofrastit” etj.

Pjesët e përkthimit në origjinal po me titullin “Foshnja”, të autorit, mjekut peditër, doktorit grek Melisinos Vrefos, vijnë menjëherë pas faqes 12-të të tij, në shtypin dhe botimin e librit në Korçë, më 1926.

Saktësoj se libri është shtypur nën kujdesin e A. Vangjelit. Kapitujt e përkthimit gjithsej janë plot njwzet dhe në përmbajtjen e tyre kanë kryesisht edukimin shkencor dhe utilitar. Nisin me ushqimin e natyrshëm, atë të përzjerë, artificial, ushqime të tjera, pastaj vijohet me të pirët, të zvjerdhurit, të larit, mveshjen, mbathjen, djepin dhe krevatkën, dhomat e fjetjes, gjumin dhe shëtitjet, tepelekun e kokës së foshnjës, të daljen e dhëmbëvet, veshët, sytë, të peshuarit dhe jashtëqitjen e foshnjavet. Të gjithë këta kapituj shtojnë dozën e utilitetit në Shqipëri, duke e shndëruar përkthimin për kohën, në një libër unik dhe të rrallë, lidhur me këshillat që ai përcjell. *“Në qendër të pjesëve të përkthyera qëndrojnë rregullat kryesore të cilat duhet t’i ndjekë çdo nënë në të rriturit të foshnjës së saj. Detyra më e shënjtë e nënës është t’a rritë ajo vetë foshnjën. ...është puna m’e e rëndë dhe m’e rëndë që mund të bëhet për një shoqëri dhe për një komb. Fëmija përbëjnë të pritmen e një kombi, në qoftë se rriten mirë që prej foshnjërie, do bëhen anëtarë të dobishmë e të vlefshmë të shoqërisë e të kombit; në qoftë se ngjet e kundërta-sikundër ngjet mjerisht nër ne-as për vehten e tyre bëhen të dobishme, as për kombin e tyre.”*⁵⁰ Duke mbetur utilitar deri në fund të këtij përkthimi, Papahristoja e sjell atë jo vetëm për nënat, por edhe për baballarët. Kjo duket te thjeshtësia e përkthimit që ai përshtat, për të qenë një ndihmë e madhe në përgjithwsi për familjen shqiptare. Këtë përkthim, madje ai ia dedikon kryetarit të bashkisë së Korçës, z. Vasil Avrami, inspironjësit të botimit të këtij libri. *“Dhe do të vazhdonte t’ish, pium desiderium, dëshira ime, në qoftë se nuk më shtynte Kryetari i Bashkisë Z. Vasil Avram. I meritueshmi Kryetar i Bashkisë së Korçës me kthjellësin’ e mëndjes së tij. E kuptoj fare mirë se nuku mjafton vetëm ndiçimi i qytetit me iliktrik, zbukurimi i tij me kopshte publike, me rrugë, me ujëra etj., mejtoj se këto janë gjëra të mira e të bukura, por janë vetëm një ndriçim e një qytetërim i përjashtëm; ndjevi pra nevojën që të vijë dhe një ndriçim dhe qytetërim i brëndshëm; ky ndriçim i brenëdshëm i popullit nuku munt të vinte, për veç se me antë librash*

⁵⁰Melisinós. Foshnja, shtyp. A. Vangjeli, Korçë, 1926, fq. 79

*të shkrojtura me një mënyrë që munt të këndohen e të kupëtohen lehtë e me një dobi prej popullit.*⁵¹ Shfrytëzimi i tij nga të rriturit, mesa duket është detyrë mbi detyrat për atdhetarin erudit Papahristo. Përmajtja e kuptimit të kapitujve të përkthimit është e rëndësishme për mëmat e reja, ndërsa për më të rriturat, ai është në sintoni të plotë me përgatitjen prej tyre, të brezit të ri. Duhet theksuar, se të gjithë kapituajt për lexim, kanë utilitet dhe elemente shkencore në trajtim. Ndër pjesët më të rëndësishme, njëherazi edhe utilitare, përmendim ato me tituj: “Gjumi”, “Ushqimi i natyrëshme”, “Mbathje”, “Mveshje” dhe “Tepeleku i kokës”.

Mesazhi: *“Nga duart pra të nënave mvaret e pritmja e mirë ose e keqe e një populli; në qoftë se nuk interesohen me mish e me shpirt për rritjen e fëmijëve të tyre, rezultati do të jetë i keq si për fëmijët, si për vehten e tyre, si për shoqërinë ku jetojnë, po të jetë se kujdesohen t’i rritin si pas porosirave të shkencës-të cilat shkurt përmbliohen në këtë libër-duhet të kenë siguri të plotë se fëmijët e rritur në këtë mënyrë do të jenë të dobishme jo vetëm për vehten e tyre, jo vetëm për prindërit e tyre, por edhe për shoqërinë edhe për kombin e tyre”*⁵² është ndër më aktualët që përcjell libri “Foshnajt”. Gjithmonë tekstet të tilla të përkthyer kanë një vlerë të rëndësishme utilitare sikurse ky syresh i përzgjedhur nga Sotir Papahristoja.

Interesant vjen ky përkthim edhe për mënyrën e përvojës së sprovuar në këtë fushë, saktësisht prej një mjeshtri. *“...të përkthesh do të thotë të kuptosh sistemin e brendshëm të një gjuhe dhe strukturën e një teksti të caktuar në atë gjuhë, dhe të ndërtohet një sistem të dyfishtë tekstor që me një përshkrim të caktuar, mund të shkaktojë pasoja të ngjashme tek lexuesi, si në planin semantik e sintaksor ashtu edhe në atë stilistik, metrik, fonosimbolik, e po aq në efektet gjithë pasion që teksti burim prirej të sillte”*⁵³. Pra, ky përkthim mbetet interesant duke përcjellë mesazhe koherence. Një përkthim i

⁵¹Po aty, fq. 8

⁵²Po aty, fq. 79-80

⁵³Umberto Eco. Të thuash gati të njëjtën gjë. Përvoja përkthimi. Dituria, Tiranë, 2006, fq. 17

mirë, është i njëjtë me mos humbjen e kohës së një njeriu. “Qesharake koha e humbur tallet para dhe pas nesh”⁵⁴, vargëzon Tomas Eliot të “Toka e shkretë”. Pra, përkthimi i mirë të kursen kohën, veç të tjerash me rastet e tij edhe të shërben ty si lexues. “...dhe kur mendojmë se përkthimi është i pamundur, në praktikë gjendemi gjithnjë përballë paradoksit të Akilit dhe breshkës: Në teori Akili nuk duhet ta arrijë kurrë breshkën, por në të vërtetë (siç na mëson përvoja) ia kalon asaj. Ndoshta teoria synon një pastërti pa të cilën përvoja mund edhe të bëjë, por problemi që ngjall interes është se sa dhe për çfarë mund të mos ketë nevojë përvoja. Nga këtu lind ideja që përkthimi bazohet në disa procese negociate, për të fituar diçka hiqet dorë nga diçka tjetër-dhe në fund palët duhet të dalin nga loja me një ndjesi kënaqësie të arsyeshme e të ndërsjelltë në dritën e parimit të artë, sipas të cilit s’mund të kemi gjithçka”⁵⁵ Mesazhet e librit edhe sot janë aktualë, gjenerojnë urtësi dhe përvoja, të cilat ngjallin interes dhe shuajnë kërsërinë e nënave dhe baballarëve... “Angllosaksonët janë, siç dihet m’i shëndoshë ndofta dhe më i lumturi popull; këtë lumturi dhe përparim e kanë fituar, se përbëhen prej qytetarësh të shëndoshë e të fortë nga trupi, gjë të cilën e kanë arrirë duke u përkujdesur me një nxehtësi të madhe për yshqimin e mirë dhe çvillimin e fuqive trupore të kalamanëvet që prej foshnjërie”⁵⁶ Edhe titujt e kapitujve, radhiten më së miri, duke ruajtur logjikën e mirërritjes së një fëmije, sipas të gjitha etapave që kalon rritja e shëndetshme e tij. Tekste të tilla sërishmi shërbejnë për të ngulitur mirë në memorjen prindërore, vlerat e urta të rritjes së një fëmije. Në shqip, aktualisht nuk ka shumë tekste të tilla. Numërohen rreth 8 tw tilla, të botuara në intervale kohore të ndryshme, nga ente të ndryshme botuese në vend. E gjemë të udhës të themi se edhe ky tekst i rrallë për vlerat që mbart, duhet ribotuar, duke ndërhyrë për ta

⁵⁴Tomas Eliot. Toka e shkretë. Tiranë 2000, fq. 56

⁵⁵Umberto Eco. Të thuash gati të njëjtën gjë. Përvoja përkthimi. Dituria, Tiranë, 2006, fq. 19

⁵⁶Melinos. Foshnja, shtyp. A. Vangjeli, Korçë, 1926, fq. 5-6

prezantuar në shqipen e sotme letrare. E përsëris, teksti mbetet një utilitet që duhet të shkundë pluhurin e harrimit.

“Tepeleku i kokës” është ndërkaq, ndër kapitujt më të rëndësishëm edhe në përcjelljen e kwshillave për prindërit. *“Tepeleku i kokës përbëhet prej kockash të ndryshme, të cilat lidhen dhe bashkohen, (ngjiten) me njëra me tjetrën. Kjo lidhje te disa bëhet vonë, si-do-mos në vëndin që është për mbi ballët dhe në mes të tepelekut. Pas lindjes së foshnjës po t’a vëmë re këtë vënd, do të shohim se në muajt e parë është krejt i hapur dhe i pabashkuar; më vonë fillon të vogëlohet gjersa të bashkohet fare në muajin e 16-të ose dhe më parë. Sa kohë ky vënd është i pa-bashkuar është i butë dhe munt të pësonjë shumë lehtë; prandaj duhet kujdes i madh që të mos e shtërngojmë foshnjën në këtë vënt, dhe mos e goditim. Ky vënt në moshën e 2 vjeteve mbyllet fare, por veç se në disa kalamanë, të cilët janë delikatë dhe të dobët”.*⁵⁷

Ndërtimi i librit mbetet interesant edhe në lëmin shkencor në të gjithë kapitujt e paraqitur për lexim. Përmes tyre përvetwsohen rregulla bazë për mirërritjen e fëmijës që foshnjë e deri te hapat e parë që ai hedh. Kapitujt kanë lidhje me njëri-tjetrin edhe mbi bazw të një vijueshmërie shkencore. I botuar në vitin 1926, teksti me përmbajtjen e tij shkencore dhe utilitare u qëndron barrierave të kohës, duke e përçarur më tej kontributin e dhënë në fushën e përkthimit nga personalitete të rëndësishme sikurse Sotir Paphristoja. Botimi ka 81 faqe dhe mbetet një lloj guide praktike për prindwrit në mirërritjen e fëmijëve të tyre. Shumica e përkthyesve të kohës ishin dhe mbetën njëkohësisht pedagogë dhe luftëtarë, shkencëtarë dhe veprimtarë të çështjes kombëtare, tekstologë dhe veprimtarë të arsimit. Ata me dijen dhe përvojën e tyre na lanë një fond të pasur në iluminizmin kombëtar shqiptar, veçanërisht në utilitetin njerëzor. Përkthimi në përgjithwsi ka lënë gjurmë në kulturën shqiptare, ka krijuar traditë, duke zënë një vend të rëndësishëm dhe të nderuar edhe për funksionet

⁵⁷Po aty, fq. 57

didaktike që përshfaq. Përkthimi vijon të kryejë një rol kyç në jetën e vendit.

Sotir Papahristoja ishte dhe mbeti një personazh plot vlera shpirtërore e atdhetare, një shembull atdhedashurie. Deviza dhe ëndrra e tij kryesore ishte që ta shikonte vendin dhe popullin e tij të ditur, të shkolluar, të kulturuar, të qytetëruar, me të drejta të barabarta si të gjithë popujt e tjerë të botës, mbi të gjitha ta shikonte popullin e tij të shëndetshëm. Sotir Papahristoja, autor i shumë teksteve shkollore dhe jo vetëm, veçmas i përkthimeve të ndryshme, përpiloi stilin e vet të të shprehurit dhe të paraqitjes para një audience koherente. Ai publikoi pikërisht në kohën kur shqiptarët dhe vendi kishin (dhe kanë) nevojë përsëri për to, gjithmonë duke u përpjekur të gjente metoda të reja ndikuese të bashkëkombasit e tij. Këtë sintezë utilitare Sotir Papahristoja e monumentalizon edhe përmes përkthimit të tij të thjeshtë, por me plot vlera për të gjithë, me titullin “Foshnja”.

Literaturë

Melinos. Foshnja, shtyp. A. Vangjeli, Korçë, 1926, 81.f

Umberto Eco. Të thuash gati të njëjtën gjë. Përvoja përkthimi. Dituria, Tiranë, 2006, 413f.

Tomas Eliot. Toka e shkretë. Tiranë 2000, 80f.

LAURANT BICA
Tiranë

DIJETARI SOTIR PAPAHRISTO

Dijetari Sotir Papahristo për mua ka qenë pak i njohur. Do të ishte një bisedë me mikun tim të vjeter e të vyer , mjeshterin e muzikës Pandi Bello që do t'i zgjeronte përmasat e këtij personaliteti në sytë e mi. Duke punuar për të mbledhur materiale më ndihmoi dhe rastësia. Po lexoja librin e Ilinden Spasses “Im atë Sterjo”. Në pesë vende aty më dilte emri i Sotirit. Pastaj lexova artikullin e Prof. E.Çabej me rastin e vdekjes së tij. Ndërmjet të tjerash shkruhej se shkuarja me bursë e Sterjo Spasses në Shkollën Normale të Elbasanit ishte vepër e tij. Duke dëgjuar një emision muzikor për violinistin Islam Petrela dhe gruan e tij Vasilika Papahristo .që e kishin kthyer shtëpinë e tyre në një lice të dytë artistik, do të mësoja se bashkë me ta e kish kaluar pjesën e fundit të jetës pedagogu, studiuesi e dijetari Sotir Papahristo. Zhani Ciko, ish-drejtor i Teatrit te Operas dhe Baletit, do të kujtonte se në atë shtëpi kishte parë në krah të njëri-tjetrit, duke biseduar përzemërsisht profesor Çabejn e profesor Papahriston. Ai do t'i takonte sa herë e sillte rasti të vinte në atë vatër mikpritëse. Hyra në internet dhe lexova një artikull shkencor të Iljaz Gogaj për dijetarin S.Papahristo si arsimtar.Figura e tij mori përmasa më të mëdha. Në fund më ra në dorë “Autobiografia” e plotë e dijetarit e shkruar nga ai vetë. Atëhere kuptova se para meje qëndronte një personalitet i madh, i cili duhet të dalë sa më parë në dritë. Kështu, hap pas hapi do të rritej figura e “Mësuesit të Popullit” Sotir Papahristo në përfytyrimin tim.

Në kumtesen time unë do të ndalem në dy përkthime të tij: veprën “Pirro” të Plutarkut marrë nga “Jetët Paralele” të tij dhe veprën “Poetika” të Aristotelit. E para dalë si botim i Ministrisë së Arsimit më 1934 dhe e dyta nxjerrë në vitin 1961 nga shtëpia botuese “Naim Frashëri”. Këto do të shihen kryesisht në planin filozofik dhe në atë

historik, pa lënë mënjanë dhe aspekte të tjera të lidhura me to për të nxjerrë figurën madhështore të dijetarit helenist, të profesorit iluminist, gjithmone në suazën e atdhetarizmit të tij të kulluar. Natyrisht, përmasat e një kumtese dhe koha relativisht e shkurtër na detyrojnë të flasim vetëm në vija të trasha, pasi një figurë e jashtëzakonshme si e prof. Sotir Papahristos meriton ose me saktë e ka merituar prej kohësh që të shkruhej një monografi dinjitoze për të. Jane me qindra e qindra faqe të botuara në libra të ndryshem dhe me qindra e mijëra të tjera në dorëshkrim që presin të shohin dritën e botimit. Gjithashtu janë artikuj të panumërt të shperndarë andej -këtej që presin dorën e hulumtuesve të kujdesshëm për t'u radhitur në korpusin e veprës së dijetarit Papahristo të krijuar për dekada e dekada të tëra. Aty numërohen krijime origjinale, përshtatje nga veprat e autorëve të huaj e mbi të gjitha përkthime, sidomos nga greqishtja e vjeter. Dijetari ynë zotëronte 7-8 gjuhë të huaja. Ai edhe sot mbetet helenisti më i madh në trojet tona, që ka shok vetëm veten. Ai është një kontinent ende i pazbuluar, është një minierë që sa më thellë të hyjmë në të, aq më shumë gjëra me vlerë kemi për të zbuluar brenda saj. Në rast se një ditë do të dalin veprat e këtij njeriu të shquar të kombit tonë, atëherë do të ndërëgjegjësohemi dhe do të kuptojmë se ç'pasuri përfaqëson ky mësues i mësuesve, siç e kanë quajtur, ky studiues i lashtësisë greko – romake si rrallëkush, ky potencial i madh i dijes njerëzore, ky intelektual erudit, që ende, për fat të keq, mbetet pak i njohur. Ai është një pus i shkencës, i dijes e me plot gojën do të thosha një akademik që duhet të dalë sa më shpejt në dritë , të zërë vendin që meriton në letrat shqipe. Profesor Sotirit nuk i kanë munguar gradat e titujt shkencore si: kandidat i shkencave filologjike, bashkëpunëtor i vjetër shkencor, bile, nga shteti francez në vitin 1931, ka marrë dekoratën “Oficer d’Academie” etj. Sipas studiuesit të mirënjohur të arsimit shqiptar, Iljaz Gogaj “është fakt se krahas Mirash Ivanajt e Rexhep Mitrovicës, edhe Sotir Papahristoja bën pjesë ndër titullarët më përparimtarë dhe më të përkushtuar të zyrës së lartë të shkollës së shtetit shqiptar në vitet’20-30 të shekullit XX.” Le

të shpresojmë që dita kur krijimtaria e puna e tij të dalin siç janë në të vërtetë, të jetë sa më e afeërt. Edhe kjo konferencë shkencore është një kontribut me vlerë që nderon organizatorët e saj.

Dijetari shok me dijetarë. E kemi fjalën vetëm për profesor Eqrem Çabejn se nuk mungojnë edhe te tjerë si Aleksandër Xhuvani, Mirash Ivanaj, Kostaq Cipo etj. Çabej ishte shoku i ngushtë i jetës së tij. Deri sa vdiq në moshën 92-vjeçare nuk iu nda kurrë Papahristos, bile u takua me të edhe disa orë para se të vdiste. Ai foli edhe në varrimin e tij dhe në gazetën “Mesuesi” shkroi “Dy fjalë kujtimi për profesor Sotir Papahriston”. Qysh sa erdhi Eqremi nga Vjena pas mbrojtjes së doktoratës në vitin 1933, ata të dy kanë qenë në lidhje të pandërprerë, pavarësisht se ku i hodhën dallgët e jetës njërin apo tjetrin. Në vitin 1940, kur pushtuesit italianë, nga Instituti Femnor e degdisën Sotirin në gjimnazin e Shkodrës, do të ishte Çabej që atëherë ishte drejtor në Ministrinë e Arsimit të kohës, që do ta ndihmonte të fillonte punën si profesor i greqishtes së vjetër në gjimnazin e Tiranës. Po fjalën e kemi diku gjetkë; për marrëdhëniet intelektuale midis tyre. Atë që do të bente Sotir Papahristoja në lëmin e historisë e filozofisë qysh më 1934, dy vjet më vonë do ta bënte Eqrem Çabej në fushën e gjuhësisë. Por të dy kishin një qëllim të vetëm, zgjimin kombëtar dhe forcimin e ndjenjës atdhetare. Në shtypshkronjën “Kristo Luarasi” do të botohej libri “Pirro” i Plutarkut, përkthim nga greqishtja e vjeter i S. Papahristos, aprovuar nga Ministria e Arsimit e kohës si literaturë leximi për shkollat e mesme. Në po të njëjtin funksion, por si tekst mësimi për shkollat e mesme, në vitin 1936 do të botohej vepra e hartuar nga Eqrem Çabej me pjesë të zgjedhura nga letërsia jonë shqipe e vjeter, e arbereshëve të Italisë, e arbërorëve të Greqisë, të periudhës së Voskopojës, letërsia e Rilindjes me Naimin në krye, letërsia e pas Pavarësisë me Nolin, Konicen, Gjergj Fishtën etj., me titull “Elemente të gjuhësisë e literaturës shqipe”. Vetë Çabej në atë kohë ishte përgjegjës për arsimin e mesëm në këtë ministri. Fill pas luftës, po Eqrem Çabej do të botonte dy tekste mësimore për arsimin e lartë “Linguistikë” dhe “Albanologji”, tekste për Institutin

Pedagogjik (Tiranë, 1947).

Dijetar që nxori dijetarë. Një figurë tjetër e shquar e lidhur me emrin e Sotirit, si njeri, si drejtues i arsimit, si profesor, është shkrimtari Sterjo Spasse. Propozimin për shkollimin e tij në Normalen e Elbasanit e bëri vetë ai dhe i dha gjatë tërë kohës një përkrahje të fuqishme. Të dy tërë jetën mbetën miq të pandarë. Në vitin 1922 profesor S.Papahristoja bashkë me profesor Spiro Kondën moreën pjesë në Kongresin e Arsimit Shqiptar të organizuar nga ministri i kohës i arsimit Rexhep Mitrovica. Ata ishin përfaqësues të gjimnazit të qytetit të Korçës dhe të dy ishin diplomuar në Universitetin e Athinës. Pas kësaj ata u emëruan në Korçë; Papahristoja si inspektor i arsimit të shkollave të qarkut, ndërsa Konda si drejtor i shkollës femnore të Korçës. Ishte ky i fundit që do të shkruante në fund të viteve '50 një libër tepër të rëndësishëm për origjinën e popullit tonë "Shqiptarët dhe problemi pellazgjik". 22 vjet më vonë në zjarrin e luftës çlirimtare më 25 nëntor 1944, Sterjo në gjurmët e mikut të vet Papahristos, merr pjesë në Kongresin e Arsimitarëve Antifashistë dhe foli plot zjarr aty për të ardhmen e arsimit shqiptar dhe të shkollës sonë.

Ne vitin 1945 një grup prej 9 arsimtarësh të shquar, ku përfshihej dhe Kahreman Ylli, Sterjo Spasse dhe Sotir Papahristo, do t'i kërkonin Ministrisë së Arsimit të krijohej një revistë për problemet e arsimit shqiptar. Kërkesa u aprovua dhe në dhjetor 1945 doli numri i parë i saj me emrin "Shkolla e re". Në të do të punonte për dhjetë vjet si redaktor i saj nxenesi i Papahristos, Sterjua. Ajo që dua të nënvizoj këtu është se dijetari, prof.Sotir Papahristo, nxorri nga duart e veta dijetarë siç është rasti me shkrimtarin Sterjo Spasse, i cili, nga ana e tij, tërë jetën e vet ishte mik i ngushtë me njerëz të shquar të dijes, kolegë të tij shkrimtarë etj.si: Mitrush Kuteli, Vedat Kokona, Petro Marko, Nonda Bulka, Mahir Domi etj. E pyeta njëherë Sterjon për një term filozofik si "Nihilizmi" që përmendte diku në një vepër të tij. Paraprakisht kisha lexuar diçka në një fjalor filozofik. Përgjigja e tij ishte befasuese për mua. Më ka folur një copë herë për përmbajtjen e

tij. Aty, unë pedagogu i ri i filozofisë, pashë se ç'kulture të gjerë, përfshi edhe atë filozofike kishte ky shkrimtar. Dëshmi e saj dhe e dijeve të tij të gjera e të thella të fituara nga studimet e pareshtura, sidomos në fushen e historisë, ishte dhe cikli i romaneve të tij "Rilindasit", që shkroi në fund të jetës. Bibliografine shteruese për veprën e Sterjo Spases e ka përgatitur miku im Ilindeni, i biri i tij dhe ajo pret që të shohë dritën e botimit. Një bibliografi të tillë e kërkon koha edhe për dijetarin Sotir Papahristo dhe ajo duhet të përgatitet sa më pare. Kjo do të shërbejë si bazë për botimin e plotë të korpusit të veprave të tij. Rëndësia e veprës së tij i kalon përmasat lokale. Ajo është kombëtare, ballkanike e më gjerë. Për mendimin tim, siç ka një shtëpi botuese "Çabej", "Mitrush Kuteli", "Kokona" etj., të drejtuara nga familjarët përkatës, duhet të ngrihet një e tillë, për botimin në vazhdimësi të veprës të të madhit, dijetarit tonë Sotir Papahristo, të cilin Eqrem Çabej do ta quante si "një nga shtyllat e rënda të arsimit shqiptar".

Vepra "Pirro" e Plutarkut

Qysh në vitin 1931 Sotir Paparistoja përktheu nga "Jetët paralele të Plutarkut" biografinë e Pirros, mbretit ilir. Në vitin 1934 ajo do të botohej nga Ministria e Arsimit "si këndim për shkollat" siç shprehet vetë profesori, ashtu thjesht në autobiografinë e vet. Në fakt ajo do t'i shërbente edukimit atdhetar që në atë kohë i vihej shumë rëndësi në shkollat e mbretërisë, siç edhe i sherbeu. Këtë do ta ribotonte shtëpia botuese "Bargjini" nën titullin Plutarku "Pirro", Tiranë, 2002. Këtë temë e kishin marrë edhe më parë shkrimtarë të ndryshëm shqiptarë. E filloi Mihal Gramenoja me dramën "Vdekja e Pirros", botuar në Sofje 1906 dhe Selanik 1910, vazhdoi Kristo Floqi me botimin e një drame tjetër "Pirro Neoptolemi", Vlorë, 1923 dhe më 1934, Et'hem Haxhiademi boton në Tiranë, Shtëpia botuese "Kristo Luarasi", tragjedinë "Pirroja". Më 1944 botohet një libër tjetër për Pirron. Më 1963 profesor Skënder Anamali boton një artikull studimor për Pirro Mollosin në një revistë shkencore, për të ardhur deri në ditët e sotme me botimin historik të autorit amerikan Jacob Abbott "Pirro, njerezit

që bënë historinë”, Botimet Jozef, 2016.

Profesor Paparistoja më 1944, në Librarinë “Argus” do të botonte edhe një përkthim tjetër mjeshëtor nga “Jetët paralele të Plutarkut” për tre figura të lashtësisë që kishin lidhje edhe me Shqipërinë si: Jul Qezari, F.Maksimi dhe Katoni i ri. Më pas ai do të vazhdonte të përkthente nga ky libër figura të tjera me qëllim që ta shqipëronte të tërin. Arriti, siç tregon vetë në autobiografi, deri në 22 figura, të cilat mbetën në dorëshkrim tek ai në shtëpi apo dhe në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri”, diku nëpër sirtarët e saj. Pas vitit 1990, përkthyesi Shpëtim Çuçka ka botuar gati gjysmën e figurave të librit të Plutarkut, kuptohet përfshi dhe Pirron e Epirit. Tani në vitin 2018, përkthyesja Ilirjana Angoni ka nxjerrë në bashkëpunim me shtëpine botuese “Plejad” vëllimin e parë të “Jetët Paralele” të Plutarkut. Le të shpresojmë ta kemi më në fund të gjithë Plutarkun (50 figura) të shqipëruar. Sigurisht të sjellë nga ndonje gjuhë perëndimore e jo nga origjinali, greqishte e vjetër, se këtë mund ta bënte, siç e bëri deri diku, helenisti ynë i madh Sotir Papahristo, por që për fat të keq mbeti në dorëshkrim, shumica dërmuese e pabotuar dhe e harruar. Ka pasur tani vonë një përpjekje për të botuar dorëshkrimet e Plutarkut të S.Paparistos, por që nuk u realizua.

Karakterit edhe filozofik i vepres. Vepra “Pirro” e përkthyer nga profesori ynë, veç karakterit historik, ngërthen në brendinë e saj edhe momente që kanë të bëjnë me filozofinë e Antikitit greko-romak dhe me një figurë tonën ilire në fushën e filozofisë si Kinea Mendimtari, apo Thesalioi,-një nga ndihmësit dhe këshilltarët, më të afërt tëmbretit Pirro. Ja ç’thote amerikani Abbott për të:”...një gjeneral dhe ministër i shquar, lindur në Thesali...”,”Burrë prej Thesalie shumë i mençëm...” përkthen Paparistoja nga Plutarku. ”...nxënës i Dhimostenit,-shkruan Sotiri, kishte aq zotësi në të folur, sa oratorët e tjerë të asaj kohe ...(e konsideronin L.B.) se vetëm ay ishte fytyra e gjallë e Dhimostenit”. Mandej vazhdon: “ishte edukuar në Greqi prej Demostenit, ishte orator i shkëlqyer dhe një burrë shteti. Gjithashtu, Pirroja e kishte përdorur si ambasador në shume raste (si

në Romë, Siçili etj. L.B.) dhe Kinea e kishte justifikuar shumë mirë besimin e Pirros. Madje Pirroja me mirënjohje, thoshte se Kinea kishte fituar me shkathtësine e vet më shumë qytete se sa kishte fituar vetë Pirroja me armë”.

Ndërsa për pikëpamjet e Kineas Plutarku do të shkruajë:”Në mes të bisedave të tjera, Kinea e solli fjalën për Greqinë dhe për filozofët e saj, e sidomos për Epikurin (341- 270 p.e.s.,L.B.) parimet e të cilit zuri t’i zhvillojë. Tha, dmth se ç’mendime kishin Epikureanët për Perënditë, për çështjet politike dhe për qëllimin e fundit që ka njeriu në këtë botë. Qëllimi i fundit, pas mendimit të këtyre ...qëndron vetëm në kënaqësitë, në gëzimet e në dëfrimet dhe jo në punët e politikës, nga e cila çdo njeri duhet të largohet, mbasi ajo dëmton dhe prish lumtërin’ e njeriut. Sa për Perënditë, këta me asnjë mënyrë nuk ndiejnë ndonje gëzim, zemërim ose përkujdesje për njerëzit, por të hequr me një anë, shkojnë një jetë të qetë dhe plot me dëfrime”. Kjo është pikëpamja e mirëfilltë hedoniste e materialistit të lashtë, Epikurit grek dhe nxënësit të tij latin, Lukrecit (99-55 p.e.s.) në Romën e Vjetër. Ky i fundit, këto pikëpamje i paraqiti gjerë e gjatë, hollësisht, në veprën e tij poetike “De rerum natura”(Mbi Natyrën). Për pikëpamjet politike të romakëve të vjetër Plutarku nënvizon:”Kinea, në kohën që ndenji në Romë, nuk u mor vetëm me çështjen e paqes, por u kujdes që të studiojë edhe jetën private të Romanëve, si dhe të mirat e jetës publike të tyre, duke erdhur në bisedime me njerëzit më të shquar të asaj kohe...Senati i Romanëve iu duk si një mbledhje mbretërisht;sa për popullin Roman,..tashi q’ë njofti mirë këtë, kishte frike se mos kishin të bëjnë me një Hydre Lernë të dytë”. Këtu kemi rast të shohim se ç’njohuri të thella ka dijetari Papahristo. Ai në fusnota bën këtë shënim:”Sipas mithologjisë, kjo ishte dragua me nëntë krerë dhe banonte nëpër kënetat afër qytetit Argos. Këtë, siç dihet, e vravi Irakliu”. Për pikëpamjet psikologjike të Kineas marrim një ide të zbehtë nga këto fjalë të Plutarkut:”Kinea i kishte thënë Pirros për këtë (konsullin romak G.Fabrici L.B.),se ishte një njeri,të cilin në Romë të gjithë e nderonin për karakterin e tij të lartër, për

zotësinë e tij në punët ushtarake dhe për vobëkësine e tij shumë të madhe”. Është për të ardhur keq që emri i Kineas, këtij filozofi të shquar ilir, nuk del në enciklopeditë e ndryshme, kurse emri i filozofit tjetër ilir me origjinë mesape, Kuint Eni (239-169 p.e.s.) epikurean, që e përmend edhe Lukreci, afërsisht të kësaj kohe, nuk mungon pothuajse në asnjë enciklopedi apo fjalor filozofik të Perëndimit. Ky i fundit e admiron Pirro Burin.

Vepër që u morën dijetarë. Profesor Sotiri jo vetëm që përktheu dijetarë si Plutarku, Thuqididi, Aristoteli, por me përkthimet e tij, si vepra “Pirro”, u morën dijetarë bashkëkohës të tij si korçari Ilo Mitkë Qafëzezi, Zef Valentini, Nebil Çika etj. Tek këta të tre do të ndalemi më poshtë.

Kronologjikisht i pari u mor studiuesi Ilo Mitkë Qafëzezi, i cili njihet për shkrimet që ka botuar sidomos për periudhën historike që lidhet me qytetin e Voskopojës në shekullin XVIII. Në vitet 20-30 shekullit XX, ai nuk do të lëre kishe, manastir, xhami e objekte kulturi të tjera në Voskopojë, Vithkuq, Korçë e gjetkë pa eksploruar, do të “rrëmojë” me zellin e një arkeologu gjithandej edhe nëpër biblioteka librat e vjetra etj. Shumica e kërkimeve të tij kanë mbetur të pabotuara dhe fondi i dorëshkrimeve të tij bën “gjumin e madh” në Arkivin e Institutit të Historisë dhe në Arkivin e Shtetit. Dijetari Ilo Mitkë Qafëzezi që zotëronte disa gjuhë, përfshi dhe greqishten e vjetër dhe të re, e meriton një simpozium apo një konferencë shkencore si kjo e sotmja, ashtu sikurse arkivi i tij i pasur pret dorën e studiuesve të rinj për të parë sa më shpejt dritën e botimit. Ai ka pasur dhe formim filozofik dhe ka shkruar, pavaresisht se të botuara ose jo, për humanistin shqiptar nga Arta e Çamërisë, Mihal Artioti apo i njohur si Maksim Greku, i ka kushtuar një monografi oparakut Protopapë Teodor Kavalioti, ka shkruar për voskopojarin Kostandin Çekani dhe iluministin Evgjen Vullgari etj. Ai ndonëse nga fundi i jetës u verbua, vazhdoi të shkruajë deri sa vdiq, i ndihmuar nga e bija Tefta.

Ndonëse kaq i përgatitur dhe i lidhur me albanologët e huaj,

sidomos ata rumunë, Papakostea dhe Kapidan, ndaj librit të Sotir Papahristos do të mbante një qëndrim tepër dashamirës, duke e vlerësuar përkthimin: “shkruar me një gjuhë të ëmbël dhe të rrjedhshme...nga drejtori i Liceut Francez të Korçës, Sotir Papahristo” dhe do të shfaqte një respekt të jashtëzakonshëm, te “Gazeta e Korçës”, në dy numra në vazhdim në datat 4 dhe 6 janar 1933, nën titullin “Dy përkthime shqip të Pirros së Plutarkut”. Shënime dhe barabijte të domosdoshme”ai do të flasë dhe për përkthimin e bërë prej atij vetë të “Pirros”me një parathënie dhe një hyrje të tij 60 faqëshe për kohën kur u shkruajt prej Plutarkut, bazuar në historianët e shquar Thuqididi dhe Momsen, me origjinalin në greqishten e vjetër përballe faqes shqip, me kujdesin e tij për shqipërimin e emrave etj. Nuk dimë në e pa dritën e botimit përkthimi i IloMitkë Qafëzëzit për Pirron e Epirit i shoqëruar dhe i pajisur me shënime sqaruese të hollësishme siç thotë ai vetë.

I dyti është dijetari i mirënjohur Zef Valentini që shkroi një kritikë me pseudonimin Zalvi në rubriken “bibliografi” të revistës “Leka”që dilte në

Shkodër për librin e S. Papahristos, në tetor 1934 dhe në gusht të vitit 1935. Përgjigja e Papahristos ishte në numrin e janarit 1935. Pavarësisht se të dy njiheshin publikisht nga opinionin shoqëror i kohës dhe e njihnin njëri-tjetrin ,kishin respekt për njëri- tjetrin, prapë kritika e Zalvit nuk ishte dashamirëse. Dihet kush ka qenë dijetari Zef Valentini në Shqipëri e më pas në Itali pas ardhjes në fuqi të komunistëve. Albanologu Valentini e vazhdoi punën e nisur në Shqipëri si drejtor i Institutit Albanologjik në Palermo të Sicilisë, që e krijoi vetë dhe ku punoi derisa vdiq.Veprën e tij, pothuajse të gjithën, mbi 32 volume të përkthyer e të botuara nga shtëpia botuese “Plejad” në gjuhën shqipe, e kemi në sajë të punës së përkushtuar të drejtorit të saj zotit Ndriçim Kulla. Ata, Valentini dhe Papahristoja në faqet e revistës “Leka” ishin si dy gladiatorë në ring, por “ustai’, mjeshtri i filologjisë greko –latine që kishte studiuar në burim në Universitetin e Athinës, megjithë kulturën që kishte Z.Valentini i dha

një përgjigje dinjitoze. Profesor Sotiri, atëherë Drejtor i Institutit “Nëna Mbretneshe ,”punëtor e i thjeshtë, mësues e helenist i shquar”, siç e cilëson Llazar Siliqi, tregoi në këtë polemikë nivelin e lartë të dijës e sjelljes së tij. Nga katër-pesë fjalë që diskutuan midis tyre që duheshin përdorur në përkthim,për katër prej tyre si p.sh. fjala origjinë dhe fis, koha e sotme i ka dhënë të drejtë Papahristos dhe vetëm për një fjalë *korent* dhe *rrymë* (filozofike L.B.) Zotit Valentini, në fund të përgjigjes së tij, profesor Sotiri, në lidhje me mënyren e përkthimit nga një gjuhë në tjetrën, thotë se i qëndron besnik frymës e jo përkthimit gërmë për gërme, siç kanë bërë dhe bëjnë shkrimtarët e tjerë në botë. Këtu as më shumë as më pak dijetari S.Papahristo ecën në gjurmët e Nolit tonë të madh.”Këtë parim (te perkthimit L.B.) pikërisht kam ndjekur dhe unë, e këtë parim ka për të ndjekur sigurisht edhe Zalvi, në qoftë se merr mundimin të kthejë në gjuhen tonë ndonjë nga veprat e shkrimtarëve klasikë të vjetër”.

I treti është dijetari Nebil Çika nga Borshi i Bregut të detit Jon. Në vitin 1943 riboton veprën e përkthyer prej profesor Sotirit nën titullin “Biblioteka e Kulturës Popullore, Plutark PIROJA-nën të shkruhet: Përkthyer prej S.Papahristos me Shtëpi Botuese “Distaptur”1943. Ka dhe një 2 të madh të futur në një rreth të madh. Si duket, është libri i dytë në kuadrin e kësaj biblioteke të krijuar me të njëjtin emër nga Ministria e Kulturës Popullore. Nebil Çika, firmos thjesht “N.Ç.”në fund të parathënies së librit që e ribotoi vetë ai, duke qenë me sa duket titullar në atë ministri. Padyshim, ai e nje nga afër profesorin, i di mirë kapacitetet intelektuale të dijetarit Papahristo dhe gjykon që mjafton emri i tij në kopertinë për të kuptuar vlerën e librit. Ndaj pa përmendur Sotirin shkruan në fund të parathënies këto fjalë:”Vlera që ka libra “Pirroja” e Plutarkut dhe sidomos vlera që ka për ne shqiptarët e shtyti Ministrin’e Kulturës Popullore që t’a ribotojë, duke mos patur dyshim se këndonjësi do të kënaqet”. Ka dhe një moment që duhet nënvizuar. Më 1934 vepra doli si botim i Ministrisë së Arsimit të kohës, pra për një numër sido që të jetë i kufizuar njerëzish, nxënësit e shkollave të mesme. Kurse tani pas gati 10

vitesh, ajo nxirret nga një ministri tjetër, ajo e kulturës dhe i drejtohet masës së gjerë të lexuesve në mbarë vendin. Pra libri ka fituar një popullaritet më të madh në opinionin publik dhe u ndje nevoja e ribotimit të tij. Në lidhje me aspektin filozofik të çështjes, Nebil Çika do të

shkruajë dhe këto në parathënien e tij.”*Historiani dhe moralisti i madh grek Plutark, ka qenë familjar me historinë, me filozofinë, me kritikën letrare, me rethorikën, me gramatikën e me moralin... Morali që parashtrohet ai...është morali i mendjes me kuptim të saktë dhe i ndershëmërise praktike*”.

Po kush është dietari Nebil Çika ? Në Shqipëri njihet ai botuesi i gazetës “Arbëria” dhe i revistës “Minerva” e të ndonjë organi tjetër në vitet ‘30 të shekullit XX. Me 1943 ai botoi një traktat filozofik social me emrin “Njëmendësia Shqiptare”(Tiranë, 1943), shumë i rëndësishëm për kohën, por dhe për ditët e sotme. Regjimi komunist në ditët e çlirimit të Tiranës bashkë me 144 të tjerë të pafajshëm i futi plumbin, për të mos e patur nëpër këmbë në ditët që do të vinin, në bodrumet e hotelit “Internacional”.

Në Perandorinë Osmane në fillim të shekullit XX, ai mbahet bashkë me një shokun e tij të shkollës, Baha Tefik, nën emrin Ahmet Nebil, si botuesi i të parës revistë filozofike turqisht “ Felsefe Mecmuasi”,i një fjalori filozofik në faqet e saj, i së parës Histori Filozofie në dy vëllime, përkthim nga frëngjishtja, i një biografie për Niçen mbështetur në burime gjermane e daneze, i një psikologjie,-përkthim nga frëngjishtja, që ndër 30 psikologjitë që ndoqën psikologjinë e Hasan Tahsinit, mbahet si më e mira . Në kuadrin e bibliotekës filozofike u botuan 11 libra, bile njëri dhe për darvinizmin. Midis tyre u sollën dy libra filozofikë me peshë të përkthyer nga Nebil Çika, alias Ahmet Nebil dhe shoku i tij Baha Tefiku. Por, “violinë e parë” ka qenë shqiptari Nebil,e jo siç paraqiten gjërat sot me kokë poshtë në Turqi, sikur autori kryesor është shoku i tij turk. Librat që shkaktuan një tronditje të jashtëzakonshme në opinionin intelektual të kohës si në tërë botën e qytetëruar, ishin vepra

e filozofit dhe shkencëtarit Ernest Hegelit “Enigmat e Universit” dhe libri i materialistit vulgar Ludvig Byhner “Materia dhe Fuqia”. Fatkeqësisht, sot e kesaj dite kemi një Nebil Çika të ndarë, në një pjesë të aktivitetit të tij intelektual në Turqi dhe pjesa tjetër kur u kthye në Shqipëri.

Klima filozofike e kohës .Janë edhe nje varg personalitetesh të tjera që luajtën rol në jetë n intelektuale të viteve 20-30 te shekullit XX dhe që në një mënyrë ose një tjetër, drejtpërdrejt ose tërthorazi, patë n lidhje të drejtpërdrejta ose të tërthorta me prof .S.Papahristo. Këta patën ndikim në Shqipëri, bile dhanë kontribut të vyer edhe në lëmin e filozofizë. Ismet Toto do të përkthente nga libri i Durant “Heronjtë e Mendimit të Platonit” dhe do ta botonte në Tiranë në vitin 1937. 60 vjet më vonë këtë do ta ribotonte Shtëpia Botuese Toena. Ky libër pas lufte do të lexohej fshehurazi në burgjet e diktaturës komuniste. Branko Merxhani, filozof, sociolog e psikolog, do të nxirrte në vitin 1937 revistën “Perpjekja Shqiptare”, në faqet e së cilës do të kishte edhe shkrime me karakter ideologjik, në të cilat pasqyrohej realiteti shqiptar i kohës. Vangjel Koça nga Gjirokastra, intelektual i shquar, me rastin e 400-vjetorit të botimit do të sillte në shqip veprën filozofike të Dekartit “Arsyetime për metodën”, gjë që përbënte një ngjarje të shënuar për kohën. Këtë nuk do të mungonte ta vinte në dukje publicisti Branko Merxhani. Në numrin e prillit 1944 të revistës kulturore –fetare “Njeriu”, drejtori i saj Sadik Begaj, një intelektual i formuar, do të botonte nën pseudonimin “Koshienca”, gati ne dy faqe të saj, një shkrim për filozofinë hollandeze të shekullit XVIII, Benedikt Spinoza. Kryeredaktori i gazetës “Demokratia” që dilte në Gjirokastër, Xhevat Kallajxhiu, do t’i mbante hapur shtyllat e saj dhe për shkrime të karakterit filozofik. Edhe në mërgim, në Amerikë, pas Luftës II Botërore, ai do të shkruante artikuj dhe studime me karakter filozofik.

I famshmi Mirash Ivanaj, do të kryente një vit për filozofi në Beograd dhe pastaj në Romë do të përfundonte studimet e larta në dy fakultete, për filozofi e jurisprudencë. Me insistimin e tij, kur ishte

ministër i arsimit të Zogut , më 1933 do të vendosej Drejtor i Institutit Femnor në Tiranë Profesor Sotir Papahristo. Lasgush Poradeci, poeti – filozof apo filozofi – poet, që do të shfaqej si meteor në shtypin e viteve ‘30, do të bëhej në Viene, doktor i shkencave filozofike. Disertacionin e tij të doktoratës e kemi të botuar edhe ne shqip. Ishte po ky Lasgush që do të lexonte “Vedat”-indiane (monument filozofik i lashtësisë) në gjuhën sanskrite në origjinal. Tajar Zavalani , një tjetër erudit shqiptar, do të shkruante libër dhe një ditar për historinë e Shqipërisë, të botuar tani së fundmi. Dhe për t’i dhënë fund këtij qarku filozofik, ku u përfshi dhe helenisti i shquar Sotir Papahristoja me përkthimin e veprës “Poetika “ të Aristotelit, po përmendim atdhetarin dhe dijetarin Hafiz Ali Korçën. Ai përktheu nga origjinali persisht, me porosi të rilindasit Naim Frashëri, nxenes i të cilit ishte, veprën “Rubairat” të filozofit - poet iranian Omer Khajam. Pra, ky është qerthulli filozofik, në të cilin u botua dhe libri “Pirro” i Plutarkut, i përkthyer prej akademikut tonë të shquar , Sotir Papahristos.

Vepra “Poetika” e Aristotelit e të tjera

Kjo vepër e Papahristos, me rreth 100 faqe, u përkthye e u botua në vitin 1961 nga shtëpia shtetërore botuese “Naim Frashëri”. Ajo u pasua edhe nga botimi në Kosovë. Ne vitin 2006, e shoqëruar me një parathënie të gjatë, u ribotua nga shtëpia botuese “Çabej”. Në vitin 2010, po kjo vepër, por në shqipërimin e një autori tjetër kosovar, Murat Bejta, u botua nga shtëpia botuese “Gjon Buzuku”. Këtu lindin dy pyetje logjike:”Pse nga Antikiteti grek, Papahristoja zgjodhi pikërisht Aristotelin dhe pse nuk përktheu nga veprat e shumta të tij një vepër të mirëfilltë filozofike, por pikërisht veprën “Arti i Poezisë” apo thënë sipas greqishtes “Poetika”?

Aristoteli (384-322 p.e.s.) është filozofi më i madh i lashtësisë dhe një nga më të shquarit e të gjithë kohërave;një mendje enciklopedike që përmbledhi në veprat e veta gjithë dijet e Greqisë së Vjeter. Vepra”Poetika” është një traktat për letërsinë që u ka sherbyer për krijimtarinë e tyre për 23 shekuj shkrintarëve, poetëve dhe krijuesve

të fushave të tjera , përfshi dhe filozofët. Për më tepër kur edhe këta të fundit, për shekuj e shekuj të tërë, gati deri në ditët tona,në një shumicë të tyre e kanë shprehur mendimin filozofik me gjuhën e poezisë ,pra në vargje.

Aristoteli shkroi në lashtësi kur filozofia konsiderohej si dashuri për dije dhe vetë vepra e tij, e tëra filozofike, përfshinte logjikën, etikën, politikën, etiken, poetikën, retorikën, fizikën, metafizikën, psikologjinë, astronominë, zoologjinë etj.Pra në këtë kuptim edhe “poetika” ishte filozofi. E vërteta e shekujve është se ato kanë qenë të ndërthurura me shumë fije. Edhe sot, kur dijet janë të diferencuara, ka rryma filozofike si ekzistencializmi francez që letërsia me filozofinë nuk ndahen dot. Papahristoja ynë i mençur, duke parë stadin foshnjor të dijeve, të krijimtarisë tek ne , produkt e i prapambetjes shekullore që e konstatoi vetë si para luftime ashtu e pas saj ne vitet 50-60, iu drejtua stadi foshnjor të njerëzimit dhe kështu përktheu “Poetikën”. Për më tepër, grekët ishin fqinjët tanë dhe kjo përputhej me formimin e tij filologjik. Pra një përputhje ideale dhe profesor Sotir Papahristoja bëri atë që duhej në kohën e duhur dhe vendin e duhur. Mirënjohje,vetëm mirënjohje! Plus që ju trazuat një rrugë të re, atë të sjelljes në shqip të letërsisë e filozofisë antike greke, nga e cila ka parë me admirim në mijëvjeçarin mbarë njerëzimi! Filozofia e mirëfilltë me natyrën e saj të vështirë i takonte një stadi të mëvonshëm. Pra vepra e tij e përkthyer erdhi si përgjigje e nevojave të kohës, i stadi që po kalonte filozofia e letërsia në gjuhën shqipe. Historikisht ato kanë qenë të pandara. Diku Aristoteli shkruan, duke krahasuar poezinë me historinë: “Poezia flet më tepër mbi të përgjithshmen, historia mbi të përveçmen, prandaj poezia është më filozofike dhe më serioze se historia”. Nga vitet ‘20-‘30 të shekullit XX ose më mirë pas shpalljes së Pavarësisë nga Ismail Qemali e më pas, përfshi e në Kosovë e Maqedoni për vetë kushtet që kanë jetuar shqiptarët deri në fund të Luftës II Botërore, bile deri më sot, në literaturën shqiptare kemi një ndërthurje të filozofisë me letërsinë, historinë, arsimin e atdhetarizmin. Akademiku Papahristo ka menduar

për sot e për nesër ,për të ardhmen.

Në veprën “Poetika” në lidhje me dijen e mirëfillte filozofike, ka rreth tre momente që dua të nënvizoj. Kapitujt 19, 20, 22, 25 respektivisht me titujt: “Te menduarit dhe të folurit”, “Elementet gramatikore të të folurit”, “Kritika letrare –Parime të përgjithëshme”, kanë më tepër “miell” filozofik. Nuk po futemi në analizën e tyre sepse kornizat e kumtesës nuk më lejojnë, por aty rrihet problemi i madh filozofik gjuhë-mendim. Ne të parin përmendet dhe filozofi sofist Protagora nga Abdera (490-420 p.e.s.) që ka lënë gjurmë të thella në historinë e filozofisë. Në veprën e tij “Mbi saktësinë e të folurit” Protagora është i pari që trajton probleme gjuhësore e gramatikore, që kishin të bënin me artin e oratorisë dhe të shprehurit bukur, që për sofistët ishte gjëja më e rëndësishme. Së fundi, të gjitha shënimet e fusnotave, që si në botimin e Shqipërisë, ashtu edhe të Kosovës janë kryesisht të të madhit Papahristo, na sjellin jehonën apo kanë në sfond filozofinë antike greke me korifejtë e saj si Aristoteli, Platoni, Demokriti, Epikuri etj.

Veprat teologjike të përkthyer dhe Revista “Jeta Kristiane”. Këtu pa i hequr asnjë presje po ja lë fjalën Profesor Sotir Papahristos, se çfarë thote për përkthimet e veta të veprave fetare. Të tërheq vemendjen fakti se ndryshe nga veprat e tjera që janë të daktilografuara nga faqja 41-44 në fund të “Autobiografisë” të Sotir Papahristos që mban datën 2-IX-1969, vjen një shënim për librat fetare me shkrim dore. Pse? sepse atëherë ziente kazani i luftës kundër fesë dhe Paparistojë druante se mos ajo binte në duar jo të mira. Mundet t’i ketë shtuar më vonë...” Shënim-Libra fetare. 1) Ora e shpirtit; 2) Mjeku izraelit; 3) I biri i shtëpisë së Davidit; 4) Pjesa nga Gojarti.

Prej vitit 1940 gjer në vitin 1944 bashkëpunova në Revistën Fetare “Jeta Kristiane” me artikuj të ndryshëm, sidomos Apologjetike me pseudonimin “Shpresëtari”. Këto mund të formojnë volume të tëra”. Katër librat e sipërpërmendur janë shqipërime të paraluftës. Ndërsa siç tregon vetë, ai dhe teologu Dhimitër Beduli ishin dy shtyllat kryesore që morën nismën për krijimin e revistës fetare dhe

që e mbajtën me shkrime dhe përkthime revistën fetare të ortodoksve shqiptarë deri në fund. Në këtë fushë për të mësuar më shumë për Sotiri Papahriston, duhet të lexojmë librat e botuara nga Dhimitër e Kristofor Beduli, at e bir. Në faqen 40 të Autobiografisë së vet, Papahristoja në fund të saj bën këtë shenim: Më 1958 Kryepiskopata më emëroi Kryetar të Komisionit për të përkthyer librat kishtarë në gjuhën shqipe. Puna vazhdoi derisa u mbyllën kishat”. Në këtë fushë prof. Sotir Papahristo ecën në gjurmët e Fan Nolit në shqipërimin e librave kishtarë. Për filozofinë në revistën fetare, jam i bindur se ka thesare. Sotir Papahristoja ka botuar shtyllën me Fjalë të Arta që kanë rëndësi në drejtimin filozofik. Në vitin 1946 ka nxjerrë nga duart e veta përkthimin “Fjalët e urta të Pitagorës” edhe ky i rëndësishëm në aspektin filozofik.

Në këtë pikë duhet theksuar fakti se Sotir Papahristoja me bashkëpunimin e tij në revistën fetare dhe artikujt e shkruar tërë jetën në shtypin shqiptar, duhet parë dhe në një dimension tjetër si gazetar. Ai vetë shprehet se ka botuar:”artikujt mbi çështje pedagogjike, didaktike, metodike, letrare e të tjera si edhe kritika letrare nëpër gazetatat e revistat e vendit, që mund të formojnë volume të tëra.

Dijetarët grekë të historisë.

Akademiku Sotir Papahristo na solli në gjuhën shqipe edhe një sërë historianësh të lashtësisë, nga më të shquarit e më të dëgjuarit, grekë e latinë si Thuqididi, Plutarku, Herodoti, Straboni etj. Këto përkthime “frenë” nëpër arkiva apo kanë parë dritën e botimit pjesërisht apo në ndonjë rast të veçantë janë botuar tërësisht. Për gjendjen në të cilën i ka lënë, le t’ia lëmë fjalën autorit. “Nga historianët grekë dhe romakë përktheva pjesët që flasin për Shqipërinë (përfshihen këto në qindra faqe të daktilografuara). Përktheva veprën monumentale (Historia e Luftës së Peloponezitet) të Thuqidhidhit (bashkë me një hyrje të gjatë). Përktheva 22 biografira nga “Jetet Paralele të Plutarkut” (përkthimi vazhdon)... Teksti i Thuqidhidhit bashkë me hyrjen dhe “Jetet Paralele të Plutarkut” ndodhen në zyrën e Institutit të Historisë e Gjuhësisë, ca janë të

daktilografuara ,ca janë dorëshkrime”. Vepra e Thuqidhidhit është një përkthim dinjitoz që e nderon helenistin Papparisto, sepse ai sjell të plotë veprën më kryesore të një prej historianëve më të mëdhenj të Greqisë së Vjetër e të mbarë botës së lashtë. Ajo dëshmon për kapacitetin e tij dhe kulturën e gjerë që ka në lëmin e gjuhësise, historisë e të përkthimit, për lartësinë e tij si dijetar.

Dijetari i fushës së letërsisë e arsimit. Helenisti i shquar. Do të flasim fare shkurt, thjesht për atë se këto sfera përfshihen në dimensionin e profesor Sotir Papahristos si dijetar. Ai përktheu nga letërsia klasike greke autorë të tillë, dramaturgë si Eskili, Sofokliu, Euripidi dhe komedianë si Aristofani. Nga i pari nga shtatë dramat e përkthyer prej tij, u botuan vetëm tre, nga i dyti prej shtatë u botuan dy, nga i treti nga gjashtë dramat panë dritën e botimit dy dhe nga i katërti, Aristofani, nga katër komeditë e përkthyer vetëm dy. Për fatin e tyre ai shkruan në një shënim në fund të autobiografisë së vet:”Tërë dramat e komeditë ndodhen të daktilografuara në zyrën përkatëse të Ndërmarrjes së Botimeve “Naim Frashëri” të Tiranës. Për të shumtat kam kopje në bibliotekën time”. Gjithashtu ai hartoi “Antologjinë e prozës greke” (pjesët më të zgjedhura nga prozatorët më të mëdhenj të Greqisë së Vjetër),e cila në vitin 1962 u botua nën titullin “Proza Antike Greke”, me rreth 300 faqe. Profesori me ato qindra faqe të dramave,tragjedive e komedive greke që perktheu, solli me kompetencë e profesionalizëm në realitetin shqiptar mendimin e lashtë grek, si pjesë e pandarë e trashëgimisë kulturore botërore, që bart në substancë mitologjinë e filozofinë antike greke.

Sotir Papahristoja ishte dhe një dijetar i çmuar i fushës së arsimit. Në një traktat të një studiuesi belg,reformator i madh i arsimit, Dr. Decroly që ai e solli në 32 faqe në formë të përmbledhur në formën e një broshure praktike për arsimtarët ai i referohet, një filozofi e pedagogu të madh ,siç ishte Xhon Djuj (John Dewey 1859-1952) tre herë për idetë e reja që pruri në pedagogji. Djuj, themelues i pragmatizmit, me dy librat e tij të njohur në mbarë botën si “Shkolla dhe Shoqëria” dhe “Demokracia dhe Edukimi”, dy gurë themeli në

filozofinë e edukimit botëror, zë vend të veçantë në pedagogjinë moderne. Vetë Decroly shkoi në Amerikë për t'u takuar me të. Në këtë broshurë Sotir Papahristoja me gojën e Decrolyse u kundërvihet ideve të vjetëruara e të shndëruara në dogmë të Pestalocit (1746-1827) dhe të Herbartit (1778-1841) dhe që siç shprehet Papahristoja, i kishte mbuluar balta e rutinës. Aty në atë traktat të vogël përmenden dhe filozofë e psikologë të tjerë si Renani, Frojdi, Gustav le Bon, Maria Montesori etj. Me të drejtë, studiuesi Iljaz Gogaj e përmend profesor Sotir Papahriston jo vetëm si njeri të arsimit, si drejtor të liceut të Korçës, por edhe si studiues të pedagogjisë. Ndhimesa e tij në këtë drejtim është tepër e vyer.

Mbi te gjitha ai është dhe mbetet një përkthyes i madh nga greqishtja e vjetër, një helenist i shquar që i ka të rrallë shokët në Ballkan e më gjerë. Ai ka qenë dhe mbetet deri në ditet tona helenisti më i madh shqiptar. Pas një përvoje të gjatë pedagogjike në mësimin e tyre në shkollë dhe përdorimin e saj në përkthime, S. Papahristoja është hartuesi i tre teksteve origjinale: Gramatika e Greqishtes së Vjetër vol.I-1938, vol.II-1940 dhe Sintaksa e Greqishtes së Vjetër 1942. Ribotimi i tyre sot do të jetë një ndihmesë edhe për helenistët shqiptarë që do të përgatiten sot e në të ardhmen.

Përfundime

Profesor Sotir Papahristos si dijetar në fushën e filozofisë duhet t'i njohim disa merita:

Së pari, ai është përkthyesi në shqip i filozofisë antike greke nga origjinali;

Së dyti, përkthyes i figurës më të madhe të mendimit të lashtë, Aristotelit, që e kanë quajtur "princi" i filozofëve të asaj kohe;

Së treti, dijetar i filozofisë dhe Antikitetit grek;

Së katërti, me kulturë të madhe, të gjerë dhe të lakmueshme filozofike si rrallëkush;

Së pesti, është pionier i pasurimit të bibliotekave tona, sidomos në fillimet e tyre, me literaturë nga veprat klasike greko-romake;

Së gjashti, ai është nga prijësit e literaturës filozofike në shqip në

truallin shqiptar, duke perdorur terminologjinë filozofike me kategoritë e filozofisë ose duke u mbështetur te gjuhëtarë si miku i tij i ngushtë, dijetari Aleksandër Xhuvani, për terma të ndryshme si neologjizma ose duke i marre direkt nga frëngjishtja.

Një rekomandim apo sugjerim për një projekt për realizimin e botimit të veprës së plotë të profesor Sotir Papahristos nga Universiteti “Fan S.Noli”, sigurisht po të shihet i arsyeshëm, i këtij “kontinenti” që po e zbulojmë me vonesë. Nen kryesinë e një grupi pedagogësh, me dy kompjuteristë shumë të aftë, të kulturuar dhe me një bibliograf në Tiranë, mund të grumbullohet gjithçka nga vepra e tij dhe ky grup të mbështetet financiarisht derisa të botohen veprat e plota të tij. Financimi, sipas natyres së veprave të bëhet në këtë mënyrë:

- I.Veprat historike në arkivin e Institutit të Historisë- Bashkia Korçë;
- II.Veprat fetare – Kisha Autoqefale Ortodokse;
- III.Veprat arsimore –Komuniteti vllah me biznesmenët e vet;
- IV.Veprat e përkthyer letrare, historike dhe metodat e greqishtes së vjetër –të shihet mundësia për një kontribut nga Konsullata Greke në Korçë.

Ky është një sugjerim dashamirës që vepra e dijetarit Sotir Papahristo të mos vazhdojë të mbulohet edhe paskëtaj nga pluhuri i harresës si deri më sot. Shpresoj që do të ketë veshë që të na dëgjojnë. Nuk është ndonjë ndërmarrje kushedi sa e madhe, përveçse e vlefshme.

Literaturë

- Aristoteli “Poetika”, Tiranë 1961;
- Gazeta e Korçës, 4 ,6 janar 1933;
- I.Gogaj”Sotir Papahristo,Njeriu i Arsimit”,Tiranë 2005.
- Plutarku “Pirro”, Tiranë 1934;
- Revista “Leka” nr 10,1934,nr 1,8,1935, Shkodër;
- S.Papahristo “Autobiografia”,Tiranë 1969;
- S.Papahristo”Dr.Decroly” ,Tiranë 1936;
- S.Pëllumbi”Fjalor Filozofik”,Tiranë 2011

DORENTINA XHAFA

Tiranë

shpanid@yahoo.com

**“GRAMATIKA E GREQISHTES SË VJETËR” -
PIKËTAKIM NDËRMJET ARSIMIT DHE PËRKTHIMIT
NË VEPRËN E SOTIR PAPAHRISTOS**

Personaliteti i Sotir Papahristos është mjaft i dalluar në kulturën shqiptare, veçanërisht në fushën e arsimit. Kontributi i tij në arsimin kombëtar dhe veprat e tij pedagogjike janë bërë objekt i studimeve të ndryshme.

Po ashtu, një fushë në të cilën ai është dalluar dhe ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm është ajo e përkthimit. Ka një sërë veprash të letërsisë antike greke, që mbajnë vulën e përkthimit të tij. Përmendim këtu dramat e Sofokliut, të Eskilit, të Euripidit; komeditë e Aristofanit; si edhe mjaft vepra të rëndësishme të autorëve të njohur grekë, si Aristoteli apo Tukididi.⁵⁸

Domosdo, këtyre përkthimeve u ka paraprirë formimi i këtij personaliteti me kulturën dhe gjuhën greke. Do të shprehej vetë në autobiografinë e tij se "Më 1901 im atë - prift atëherë - më shpuri në gjimnazin grek të Korçës me bursë të mitropolisë së këtij qyteti."⁵⁹ Dhe më vonë, prej vitit 1907-1912 do të studionte në Universitetin e Athinës dhe pas kthimit të tij në Korçë do të punonte si mësues dhe

⁵⁸ Shih për këtë regjistrimet në <http://www.bksh.al/adlib>; autobiografinë e autorit, të botuar në gazetën "Standard" më 26-30 prill dhe 1 maj 2009, por që mund të konsultohet prej lexuesit në <http://www.arkivalajmeve.com>; e po ashtu edhe intervistën e znj. Vasilika Petrela, vajzës së S. Papahristos, me gazetaren Elsa Demo, e botuar në gazetën "Shekulli" nr. 2453, 1 nëntor, 2008, f. 10 - 11, e konsultuar prej nesh në <http://www.arkivalajmeve.com>, ku ajo tregon hollësi të jetës dhe të përkthimeve e botimeve të veprës së tij.

⁵⁹ Papahristo, S., Murati, Violeta, *Helenisti i fundit me "Autobiografi" të panjohur: përkthyesi i Tukididit boton autobiografinë e tij*, e botuar në gazetën "Standard" nr. 1225, 25 prill, 2009, f. 17 - 18, e konsultuar prej nesh në <http://www.arkivalajmeve.com>.

do të jepte, ndër të tjera, edhe lëndën e greqishtes së vjetër.⁶⁰

Pa dashur që të përmendim rishtas kontributet e tij të çmuara, të cilat janë tashmë të njohura për lexuesin⁶¹, do të gjenim rastin për të dalluar një pikë të rëndësishme takimi midis dy fushave ku Papahristoja u dallua më së tepërmi: që janë pikërisht fusha e arsimit dhe ajo e përkthimit. Me siguri kjo ka ardhur, përveçse si një shtysë pasioni për gjuhën dhe kulturën greke, edhe si një nevojë – të cilën do ta paraqesim më poshtë – për shkollën shqiptare dhe lëndët, të cilat ai i mësonte në shkollë.

Këtë pikë takimi dhe plotësimi të këtyre dy fushave të rëndësishme (= arsimit dhe përkthimit) do ta përbënte botimi i veprës së tij "Gramatika e greqishtes së vjetër" e botuar në dy pjesë.

Pjesa e parë mban titullin <SHQYRTUE PREJ KOMISJONIT TEKNIK | Nr. 11 | Gramatika | e | GREQISHTES SË VJETËR | PJESA E PARË | prej | S. PAPAHRISTOS | Drejtorit t'Institutit Femnuer "Nana Mbretneshë" | Si mbas vendimit të Komisionit Teknik, | pëlqyem prej Ministris s'Arsimit me Nr. 1033/I d. 16-III-1939. | TIRANË, 1939 | SHTËPIJA BOTONJËSE "KRISTO LUARASI">, ndërsa pjesa e dytë <Gramatika | e | GREQISHTES SË VJETËR | PJESA E DYTË | prej | S. PAPAHRISTOS | Si mbas vendimit të Komisionit Teknik N. 11 | pëlqyem prej Ministris s'Arsimit me N. 1033/I d. 16-III-[1]939 | TIRANË, 1941 | SHTËP[I]JA BOTONJËSE "KRISTO LUARASI" >.

Shqyrtimin e jetës së Papahristos dhe studimin e kontributit të tij e ka lehtësuar sidomos autobiografia e autorit⁶², ashtu sikurse pikasjen në përkthim, që duket qartë prej veprave që kemi.

Po ashtu edhe dallimin dhe vënien në dukje të një pikëtakimi dhe plotësimi të tillë na e ka lehtësuar po autori vetë, i cili e bën të

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Shih po ashtu edhe Iljaz Gogaj, *Sotir Papahristo, njeriu i arsimit*, botuar në gazetën "Korrieri" 2-4 tetor 2005, e konsultuar prej nesh në <http://www.forumishqiptar.com>.

⁶² Shih më lart fusnotën nr. 58.

qartë këtë në parathëniet e dy librave të tij (= dy pjesëve të së njëjtës gramatikë). Konkretisht në parathënien e pjesë së parë ai shkruan:

<Botimi i kësaj gramatike të Greqishes së vjetër ka për të plotësue, si kujtoj, një nga mungesat kryesore që kanë degët klasike të Licevet t'ona.

Libri i përpiluem në bazë të provës së gjatë të auktorit dhe të veprave të kësaj lloji që janë botue në gjuhë të hueja, u përgjigjet, më duket, mjaft mirë kërkimevet të metodës së ré dhe i arrin qëllimit të caktuem prej programës zyrtare.

S. PAPAHRISTO

Tiranë, me 20-II-1938.> (Papahristo, *Gramatika... Pjesa I* 1939 3)

Papahristoja, jo vetëm që ka plotësuar një mangësi të shkollave të mesme të kohës, të cilat pas gjasash deri atëherë e studionin letërsinë antike greke pa marrë njohuri për greqishten e vjetër, por është bërë njëkohësisht edhe autori i parë i një gramatike të tillë të kësaj gjuhe. Qartazi këtë e thotë sërish ai vetë në parathënien e pjesës së dytë të gramatikës së tij:

<... Tue marrë parasysh se nxënësi shqiptar nuk ka as një mjet ndihmës për studimin e greqishtes së vjetër, e gjeta të nevojshme t'a pasuroj këtë pjesë të dytë të gramatikës me një listë të foljevet të parregullshme, që janë në përdorim të dendur, si edhe me një fjalor të vogel greqisht — shqip.

Gjithashtu e gjeta te domosdoshme që të japë ne formë shtese disa njoftime elementare mbi emnat, peshat, monedhat, masat dhe kalendarin që përdorehin n'Attikën.

Në funt pastaj, për t'a lehtësuar nxënësin shqiptar në studimin e veprave të Homerit dhe të Herodorit, baj fjale në një menyre të shkurtën mbi dialektet e ketyne auktorëve, tue theksue format e përbashkëta që kanë, si dhe ato të veçanta.

Auktori

S. PAPAHRISTO

Tiranë më 8-II-[1]940 > (Papahristo, *Gramatika... Pjesa II* 1941 3)

Faktin se autori (= Papahristo) për ndërtimin e kësaj gramatike nuk ka pasur parasysh asnjë autor paraardhës shqiptar dhe se është vetë ai që e formuloi një gramatikë të greqishtes së vjetër për nxënësit shqiptarë, e përforcon edhe bibliografia e përdorur prej tij, ku gjejmë dy gramatika të greqishtes në frëngjisht (1926, 1927), një në greqisht (1924), një në gjermanisht (1930) dhe një në italisht (1927). Kjo bibliografi është shënuar përkatësisht në faqen 5 të pjesës së parë dhe në faqen 2 të pjesës së dytë si më poshtë:

<Librat që patëm parasysh, janë këto:

Riemann et Goelzer: La première grammaire grecque
(Paris 1927).

” ” ” *Grammaire complète* (Paris 1926)

Zagojani-Filiku: Gramatiki tis arkeas Eliniqis
(Athinë 1924).

Adolf Kaegi: Kurzgefachte griechische Schul-
Grammatik (Berlin 1930).

Giovanni Zenoni: Morfologia Greca (Venezia 1927).>
(Papahristo, *Gramatika...Pjesa I* 1939 5 dhe *Pjesa II* 1941 2)

Struktura mbi të cilën është ndërtuar teksti dypjesësh ngjason të jetë ai i një gramatike të mirëfilltë të një gjuhe, pasi në përmbajtjen e tij gjejmë:

Në pjesën e parë⁶³:

- fonologji (shkronjat, theksi, ndryshime të fjalëve, shenjat e pikësimit);

- morfologji (nyjat; emrat dhe lakimi i tyre: lakimi i parë, i dytë dhe i tretë; mbiemrat: kategoria e parë, e dytë dhe e tretë, si edhe shkallët e mbiemrit; numërorët; përemrat: dëftorë, vetvetorë, vetëpësorë, pronorë, pyetës, e pakufishëm, lidhorë; si edhe foljet: koha, veta, forma, mënyra).

⁶³ Shih përmbajtjen e pjesës së parë të gramatikës në faqet VII-VIII: Papahristo, *Gramatika e greqishtes së vjetër, pjesa e parë*, 1939 7-8.

Në pjesën e dytë⁶⁴:

- vazhdim i morfologjisë (foljet: më tema të ndryshme dhe sipas disa kategorive; ndajfoljet: mohimi, vendi, kohe, sasi, mohimi dhe pyetjeje; parafjalët: me një rasë, me dy rasa, me tri rasa dhe që përdoren si parafjalë; lidhëzat dhe pasthirrmat);

- etimologjia (prejardhja: e foljeve, emrave dhe mbiemrave; përngjitja: për disa kategori gramatikore);

- si edhe tri shtesa (shtesa e parë: emrat e grekëve të vjetër; peshat, monedhat e masat; dhe kalendari Attik; shtesa e dytë: foljet e parregullta; shtesa e tretë: dialektet e Homerit dhe të Herodotit dhe fjalor greqisht-shqip).

Porse, veç faktit se kjo gramatikë është hartuar si tekstet e tjera shkencore të kësaj natyre, ajo që e dallon, është funksioni i mëtuar. Ky tekst do të shërbente si tekst mësimor për nxënësit e shkollave të mesme (= liceve) dhe për këtë arsye për secilin koncept apo kategori gramatikore autori jep edhe ushtrimet përkatëse. Kështu, në pjesën e parë të gramatikës gjejmë 86 ushtrime, ndërsa në pjesën e dytë së saj gjejmë 59 ushtrime, të cilat i mëshojnë karakterit didaktik të tekstit.

Kësisoj, fakti i hartimit të një gramatike si tekst mësimor i mëshon karakterit arsimor të këtij teksti e, nga ana tjetër, fakti i përfshirjes në të i një fjalori greqisht shqip e i disa shtesave me informacione mjaft të dobishme për kulturën dhe gjuhën greke, të cilat mendohej të merreshin kryesisht nëpërmjet veprave artistike, i mëshon përvojës së tij si përkthyes dhe njohës i mirë kësaj gjuhe e kulture.

Prandaj, kjo gramatikë e greqishtes së vjetër, është një sintezë e rëndësishme e punës së Sotir Papahristos në fushën e arsimit dhe të përkthimit.

⁶⁴ Shih përmbajtjen e pjesës së dytë të gramatikës në faqet 223-224: Papahristo, *Gramatika e greqishtes së vjetër, pjesa e dytë*, 1942 223-224.

Literaturë

Demo, Elsa, *Fjala e fundit e helenistit: Sotir Papahristo. Edhe intervistë me vajzën, Vasilika Petrela*, <http://www.arkivalajmeve.com>: gazeta "Shekulli" nr. 2453, 1 nëntor, 2008, f. 10 - 11.

Gogaj, Iljaz, *Sotir Papahristo, njeriu i arsimit*, <http://www.forumishqiptar.com>: gazeta "Korrieri" nr. 241-243, 2-4 tetor, 2005.

Papahristo, S., Murati, Violeta, *Helenisti i fundit me "Autobiografi" të panjohur: përkthyesi i Tuqididit boton autobiografinë e tij*, <http://www.arkivalajmeve.com>: gazeta "Standard" nr. 1225, 25 prill, 2009, f. 17 - 18.

Papahristo, Sotir, *Gramatika e greqishtes së vjetër, pjesa e dytë*, shtëpia botuese "Kristo Luarasi", Tiranë, 1942.

Papahristo, Sotir, *Gramatika e greqishtes së vjetër, pjesa e parë*, shtëpia botuese "Kristo Luarasi", Tiranë, 1939.

MELIHATE ZEQIRI
Prishtinë
melihatez@gmail.com

SOTIR PAPAHRISTO NJË MODEL KULTUROR

Në këtë kumtesë do të paraqesim një model kulturor, siç është Sotir Papahristoja dhe ndikimin e tij për të arsimuar femrën shqiptare.

Si një punëtor me përvojë në praktikën shumëplanëshe arsimore, me formimin e tij teorik dhe me prirje në fushën e letrave, Papahristoja dallohej edhe si studiues në fushë të pedagogjisë. Në shkrimet e tij pedagogjike, ku më pak e ku më shumë, Papahristoja rrahu të gjitha çështjet themelore të mësimit dhe edukimit që dalin para shkollës, familjes dhe shoqërisë shqiptare. Veçanërisht i shqetësuar duket Papahristoja në çështjen e madhe të përmbajtjes mësimore të shkollës, me atë çfarë merrte nxënësi si dituri dhe me çfarë brumosej ai si qytetar në shkollë.

Pedagog i talentuar me veprimtari të frytshme praktike e teorike, drejtues e organizator i shquar arsimit, përkthyes e studiues prodhimtar në fushë të pedagogjisë, intelektual erudit, helenisti dhe humanisti Sotir Papahristo i dha vendit dhe popullit të vet, nga jeta e tij fatmirësisht e gjatë, 56 vjet të mira pune me rendiment të begatshëm⁶⁵.

Si një punëtor me përvojë në praktikën shumëplanëshe arsimore, me formimin e tij teorik dhe me prirje në fushën e letrave, Papahristoja dallohej edhe si studiues në fushë të pedagogjisë. Më disa dhjetëra artikuj në gazeta e revista dhe më 13 tituj librash origjinale, të përshtatura ose të përkthyer, Papahristoja veproi me mendësi prej shkencëtari. Duke vlerësuar studimin e Papahristos "Qeverimi i fëmijëve në shkollë", botuar në Tiranë me 1928, albanisti i njohur italian Gaetano Petrotta, në librin e tij të njohur "Popolo, lingua e letteratura albanese" (Palermo 1931), e çmoi lart këtë studim

⁶⁵Më 30 shtator 2005, dr. Iljaz Gogaj www.forumshqiptar.com

me fjalët: *"Sotir Papahristo drejtor i Liceut të Korçës, ka shkruar një vepër interesante pedagogjike për disiplinën e shkollës, pra një punim që sillet rreth regjimit disiplinor të fëmijëve gjatë jetës së tyre shkollë. Dhe vepra e këtij mësuesi të ditur, përben një ndihmesë të çmuar në letërsinë shkencore shqiptare"*. Në listën e shqipërimeve të paraluftës të Papahristos, hyjnë edhe katër tituj librash fetare: "Ora e shpirtit", "Doktori izraelit", "I biri i shtëpisë së Davidit" dhe "Pjesë nga Gojarti".

Në shkrimet e tij pedagogjike, ku më pak e ku më shumë, Papahristoja rrahu të gjitha çështjet themelore të mësimit dhe edukimit që dalin para shkollës, familjes dhe shoqërisë shqiptare. Veçanërisht i shqetësuar duket Papahristoja në çështjen e madhe të përmbajtjes mësimore të shkollës, me atë çfarë merrte nxënësi si dituri dhe me çfarë brumosej ai si qytetar në shkollë. Në një artikull studimor botuar në revisten "Bota e re", në gusht 1936, duke polemizuar me disa dogmatikë të kohës për çështjen e përmirësimit të programeve mësimore, Papahristoja, si mendimtar i lirë dhe i përparuar, kërkon që mësuesi të bëjë punë krijuese të diferencuar sipas niveleve të shkollës dhe të nxënësve, sepse vetëm kështu do të lulëzonte personaliteti njerëzor, sipas dhuntive më të cilat e kishte pajisur natyra. *"Një mësues me dije të gjanë mbi mjeshtrinë e tij, me një dashuri për punë dhe me një dëshirë për përmirësim, - thekson Papahristoja, nuk mund të rrijë në nivelin që gjindet, por kërkon e vëzhgon gjana të reja. E për të mbrimë këtë gjendje, duhet ta lejë mënjatë programin e të mos bëhet skllav i tij"*. Pastaj me tutje, duke kërkuar çlirimin e mësuesit nga vargonjtë e programit, ai do të shtojë: *"Programi i zbatue pikë për pikë, asht një zinxhir që e lidh mësuesin këmbë e duar e nuk e le shpirtin e tij të kullojë lirisht në fushat pedagogjike që atij i tregon teoria dhe praktika, e ndihmon që të bjerë shpejt nën rutinë. Ja ku na del përpara rutina, ky zinxhir skllavërimi i mendjes njerëzore, ky krimb që na bren e na paralizon shpirtin e që na mekanizon trurin. Programi dogmatik i tillë siç asht zbatue deri më sot ndër ne e ushqen më duket këtë krijesë të rrezikshme"*.

Prandaj Papahristoja do të kërkonte që me ndihmën e inspektorëve dhe në bashkëpunim me ta, mësuesit të nxiteshin të studionin e të përpilonin projektet e tyre që mbi atë bazë, të ndërtonin programe në përputhje më nivelin e kërkesat e kohës në Shqipëri dhe jo të merreshin shabllone, sikundër ishin marrë nga bota e jashtme.

Puna e bërë në Institutin Femëror "Nana Mbretëshë" dhe përvojat e fituara në praktikën mësimore të atjeshme, e shtynë Papahriston të thellohet në studime të arsimimit dhe edukimit të femrës shqiptare. Në një artikull të rëndësishëm me titull: "Rëndësia e edukatës femërore dhe e zhvillimit të saj në Shqipëri", ku citohen disa emra autoritarë të pedagogjisë e të filozofisë botërore, i botuar në gazetën "Shtypi" në Tiranë, në dhjetor 1938, Papahristoja deklaronte: *"Atje ku është lënë pas dore edukimi i gruas, atje nuk ka mundur të lulëzojë një qytetërim i vërtetë dhe tërë përfundimet e tij të shkëlqyera."* Duke i bërë thirrje opinionit shqiptar, për rëndësinë e edukimit të femrës, Papahristoja do të citonte Jul Simonin: *"Kur edukon mirë një djalë, përgatit për shoqërinë një burrë të mirë: por kur përgatit një vajzë, i jep shoqërisë një familje të re"*. Më në fund, Papahristoja do të bënte apel për arsimimin e shëndoshë të vetë femrës shqiptare, sepse ajo e meritonte për dhuntitë që i kishte falur natyra, dhe do të shtonte: *"Vajza shqiptare është pajosur prej natyre me dy cilësina shumë të vlefshme: me zgjuarësi të jashtëzakonshme dhe me një etje e dëshirë të pakufishme për dituri e për kulturë"*.

Në të njëjten kohë, me nismën e prefektit të Korçës Ismet Kryeziu dhe të kryetarit të bashkisë Vasil Avrami, Papahristoja me kolegë të tjerë intelektualë korçarë me konferencat publike kulturore, vijuan e pasuruan një traditë të hershme, duke ia begatuar jetën kulturore qytetit të tyre. Me tërë ndihmesën në fushë të studimeve të pedagogjisë, të historisë së pedagogjisë dhe historisë në përgjithësi, Papahristoja renditet pa medyshje ndër studiuesit më në zë, të cilët referuan dhe publikuan punët e tyre në vitet '20-'30 të shek. XX.

Veprimtarinë aktive aq frytdhënëse të Papahristos e frenoi

pushtimi fashist i vendit. Me ndjenjat e tij delikate atdhetare, ai e ndjeu peshën e rëndë të pushtimit. Është me interes të shënohet se Papahristoja i papërtuar dhe i palodhur kurrë, që dikur bënte raporte analitike të gjata shumëplaneshë, tani në raportin e fundit të vitit shkollor 1938-1939 i ishin mpirë duart dhe nuk shkroi veçse dy faqe e gjysmë, pa bërë kurrëfarë komplimenti për pushtuesin, sikundër mjerisht bënë disa të pakët që ranë në grackën e ndikimit fashist. Ky frenim ishte më shumë një protestë. Ministri i atëhershëm e transferoi Papahriston në Shkodër për arsye "teknike". Kjo ishte një goditje e rëndë për pedagogun e vjetër atdhetar, por goditja më e madhe ishte për vetë Institutin, që te Papahristoja kishte gjetur atë drejtues që nuk do t'i kthehej me kurrë. Për me keq, u pushua nga puna, sepse bënte pjesë në listën e arsimtarëve antifashistë, sipas dekretit të Mëkëmbësisë së Përgjithshme të datës 31.10.1940 nr.528. Pas një viti u rimor në punë si mësues i greqishtes së vjetër se "ishte pushue gabisht", thuhej në dokumentin e datës 19.6.1941, nr.5610/7.25).⁶⁶

Mësuesit francezë do ta çmonin më notat më të merituarra pedagogun, që fliste pak e bënte shumë. Në të vetmen të përkohshme "Lyceum", që botoi Liceu i Korçës më 1937, lexojmë këtë vlerësim mjeshtëror: *"Një dekret i jepte Liceut rregulloren definitive që, pak a shumë e inspiruar nga ajo a Gallata Sarajt, themelonte një drejtim administrativ për të siguruar vazhdimisht dhe aty për aty mbarëvajtjen e Liceut dhe për të theksuar karakterin kombëtar të këtij instituti. Kjo qe detyra në të cilën e thirrën në tetor Papahriston. Ai do të mbushte në mënyrë të lumtur këtë detyrë delikate në saj të një butësisje dhe lakushmërie që shpjegonte saktësia e formimit të tij platonik."* Dhe konkretisht, në shpërblim moral ndaj punës së mirënjohur, qeveria franceze i dha profesor Papahristos në vitin 1931, dekoratën "Oficer d'Academie". Ishte ai vit, kur qeveria franceze, njohu zyrtarisht ekuivalencën e dëftesës së maturës të Liceut të Korçës.

⁶⁶ Publikuar më 1-4 tetor 2005, www.forumishqiptar.com dr. Iljaz Gogaj

Për të qëndruar sa më lart në misionin e edukatorit të kohës, Papahristoja u tregua i rreptë ndaj teprimeve të tualetit, veshjes, qëndrimit dhe sjelljes së disa mësueseve, që donin të "evropianizoheshin" para kohës. Jashtë mureve të shkollës, sigurisht që ato ishin të lira, të visheshin dhe të silleshin si të donin, po në klasë, duhej të ishin model i çdo dukurie dhe sjelljeje ndryshe, sipas Papahristos, nuk kishin vend në atë shkollë. Në këtë mes, drejtori i Institutit Femëror, pati që në fillim, mbështetjen e patundur të ministrit Mirash Ivanaj. Po Papahristoja me edukatën familjare, me kulturën, botën e tij shpirtërore dhe pjekurinë e moshës, diti të ndërtojë marrëdhënie të mira me vartësit, që u mbështeten gjithnjë në respekt të ndersjelltë. Si specialist i aftë, por edhe njeri i thjeshtë pa kurëfarë ambicie, Papahristo synonte për t'i ngritur në shkallën e merituar të gjithë mësuesit e shkollës që ai drejtonte.

Ndërsa ishte intelektual me horizont dhe tejpamje të kthjellët, njeri praktik, për çështjet e disiplinës, nuk toleronte dhe nuk falte lehtë. Kishte parime të vetat pedagogjike. P.sh. për çështjet e programit dhe në përgjithësi të normave të tjera pedagogjike, nuk u tregua kurrë pedant, por gjithnjë krijues dhe zhvillues origjinal. Prandaj, duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e formimit arsimor dhe edukativ, si edhe dobësinë në mësimet e nxënësve, të cilat kishin ardhur nga shkolla të ndryshme, për provimet e para të maturës të vitit 1935, ai i kërkoi Ministrisë së Arsimit: "*E quajmë të nevojshme që të përsërisim këtu edhe njëherë mendimin tonë që kemi shfaqur me gojë shpesh herë do të dëshirojmë në personalisht një butësi e një indulgjencë pak më të madhe kundrejt maturantëve, sidomos normalistëve, për arsye se këto, siç dihet, kanë qenë elemente të ardhur prej shkollash të ndryshme me programe të meta e me personel shumë herë të pabazë". Ndërsa për programin mësimor, në mënyrë që ai të qasej sa më afër nevojave praktike të shkollës dhe të botës shqiptare në përgjithësi, ai do të raportonte për lëndën e matematikës ndër të tjera edhe këto: "*Nxënëset duke u marrë me tepër me ekuacione algjebrike se sa me aritmetikën praktike, e lënë pas**

dore këtë të fundit dhe kështu bëhen ndofta të zonjat n'algebër, po mbetën të dobëta n'arithmetikën praktike, domethënë pikërisht n'atë lëndë që asht e domosdoshme për karrieren e mësuesit."

Në vitet '20 dhe sidomos në vitet '30, në bazë të zhvillimit të përgjithshëm arsimor, në shkollat shqiptare, u duk një veprimtari e larmishme dhe e dendur jashtë mësimit, e cila ndikonte shumë në formimin e nxënësve dhe që shpesh i kalonte me sukses muret e shkollës, për të ndikuar edhe më tej. Për këto veprimtari, dallohej edhe Instituti Femëror "Nana Mbretëshë". Nga libri "10 vjet mbretni" botuar me 1938, po shkëpusim këta rreshta që i përkasin këtij Instituti: *"Janë proverbiale manifestimet që zhvillon ky institut për mbylljen e çdo viti shkollor, ato japin të kuptosh dy të vërteta, që i bien në sy menjëherë kujtdo që ndjen prirjen për shfaqjet që e prekin shpirtin njerëzor. Njëra nga këto, asht përgatitja e elementit në sheshin e shfaqjeve intime artistike dhe e dyta ajo e arritur prej këtyre vajzave brenda periudhash të gjata studimesh".* Në këtë veprimtari, dhanë ndihmesë edhe specialistë të jashtëm që nuk punonin në Institut, të cilët falë reputacionit që gëzonte Papahristoja, shkonin me kënaqësi të ndihmonin për organizimin e shfaqjeve artistike. Dhe Papahristoja gjithnjë mirënjohës, do të dinte që t'i shpërblente ata, jo vetëm materialisht. Në vitin 1935, ai do të falënderonte publikisht artistin e njohur Sokrat Mio në gazetën "Vatra" e cila dilte në kryeqytet, me këto fjalë: *"E ndjej për detyrë të shfaq botërisht falënderimet më të nxehta z. Sokrat Mios, i cili me energji të pashoqë duke mos përfillur mund e lodhje u përkujdes për përgatitjen e dekoracioneve të skenës në festimet e Institutit".*

Në fund të viteve '20 dhe në fillim të viteve '30, në shkollën shqiptare, kishte filluar të frynte erë progresive, ku mësuesit po i ngrihej autoriteti dhe po e ndjente veten gjithnjë e më shumë misonar se sa rrogetar. Ndërmjet arsimtarëve po krijohesh një atmosferë autoriteti dinjitoz, që frymëzohej nga idetë fisnike për përgatitjen e qytetarit të ndershem, të ditur dhe mbi të gjitha atdhetar. Për brumosjen e atdhetarit, shkolla shqiptare derdhi lëndë të pasur, e cila

zuri vend në shpirtin e shkollarëve. Një klimë e tillë i jepte dorë të mirë Papahristos me shokë, që të begatonin më tej veprën e tyre për përgatitjen serioze të brezave të rinj të kombit. Duke vlerësuar veprën e Papahristos në këtë rrafsh, gazeta "Drita" e kryeqytetit në qeshor 1937, shkruan kështu: "*U mbushën 4 vjet prej themelimit të këtij Instituti kaq të vlefshëm dhe me gjithë pengimet të një natyre të ndryshme, të cilat u shfaqën në fillim, Instituti ka bërë përparime të lavdërueshme në çdo pikëpamje.*" Dhe më tej shtonte: "*Me zellin dhe me durimin e lavdueshëm të drejtorit të tij dhe të profesorëve i zhdukën shumë nga të metat dhe shumë nga pengimet e shfaquna në fillim të jetës së tij*".

Sotir Papahristoja është njeriu i arsimit dhe model për të rinjtë, për gjeneratat që janë duke u përgatitur për të qenë mësimmësues të arsimit shqip. Njeriu që la gjurmë për shekuj të tërë për kulturën dhe arsimimin e brezave të rinj.

Literaturë

Gaetano Petrotta: Popolo.lingua e letteratura albanese, Palermo, 1931

"Gazeta e Korces", Korce, dt. 1.9.1933, nr.1880

"Revista Pedagogjike", Tirane, 1925, nr.3

Gazeta "Zeri i Korces", Korce, dt.5.8.1925, nr.85

Revista "Bota e re", Korce, viti 1936, nr.3

Gazeta "Shtypi", Tirane, dt.14.12.1938

Gazeta "Besa", Tirane, dt./11.3.1933, nr.499

AQSH, FMA, dok.,dt.19.6.1941, nr.5610/7

Sotir Papahristo: "Jeteshkrimi im"

ëëë.forumishqiptar.com

DION TUSHI
Universiteti i Korçës
diontu@gmail.com

**SOTIR PAPAHRISTO-HARTUES I METODODËS SË
PARË TË MËSIMËDHËNIES SË GREQISHTES SË
VJETËR NË GJUHËN SHQIPE**

Një figurë shumë e rëndësishme e arsimit dhe kulturës shqipe është pa dyshim edhe Sotir Papahristoja, i njohur më tepër si shqipëruer i letërsisë klasike kryesisht helene, dhe shumë pak i trajtuar dhe i përmendur si një ndër themeluesit kryesorë të arsimit kombëtar qysh me krijimin e Drejtorisë Kombëtare të Arsimit dhe si ristrukturues dhe themelues i dy qendrave të rëndësishme të arsimit të mesëm në vendin tonë, Liceut Kombëtar të Korçës, i njohur si Liceu Francez dhe shkollës pedagogjike për vajza “Nana Mbretreshë” në Tiranë. Sotir Papahristo është i njohur edhe si hartues i parë i gramatikave të greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe, si një metodë mësimdhënëse. Pra për Sotir Papahriston, ka shumë për të thënë, kontributi i tij i shumanshëm dhe tepër i çmuar patjetër që duhet të ngacmojë studiues të sferave të ndryshme të historisë së arsimit, pedagogjisë, didaktikës, sociologjisë dhe përkthimit të letërsisë klasike. Në këtë punim, jemi fokusuar kryesisht në tekstet gramatikore të greqishtes së vjetër, si libra për mësimin e kësaj gjuhe, në metodikën e veçantë që i karakterizon, si dhe në arsyet e hartimit të tyre nga S. Papahristoja. Duke u përqëndruar vetëm në dy librat e para.

Libri i parë i Gramatikës të Greqishtes së Vjetër, i autorit Sotir Papahristo, që është në përgjithësi një libër morfologjie, nis me një kapitull të veçantë, të cilin ai e quan Fonologji. Këtu mbasi jepet alfabeti i greqishtes së vjetër, shpjegohen, veçoritë e shkrimit të kësaj gjuhe, ku një vend të rëndësishëm zë shkrimi i theksave dhe shënjave të tjera në fjalën e shkruar, dhe kjo për faktin se një gjuhë tejet

muzikore si greqishtja e vjetër, paraqet një shkallë të lartë vështirësi edhe në shkrimin e fjalëve, pasi edhe në gjuhën e shkruar duhet që të evidentohen uljet dhe ngritjet e zërit, në bazë të theksave dhe frymraveve (Pnevmata). Dhe pikërisht sqarimi i një fenomeni të tillë është delikat dhe i vështirë. Shtojmë këtu se kemi parë metoda të ndryshme, se si autorët hartues janë përpjekur ta japin këtë veçori në gramatikat e hartuara prej tyre, duke u përqëndruar kryesisht tek librat gramatikorë tek të cilat është bazuar edhe S. Papahristo, dhe konkretisht në Metoda franceze e Reimann et Golzer, “La premiere grammaire grecque”, botuar në Paris 1927. 2. Metoda greke e Zangojani – Filiku, Gramatiqi tis Arkeas Ellinikis, Athinë 1924. 3. Metoda gjermane Adolf Kaegi, Kurzgefalte Grieschische Schul – Grammatik, Berlin 1930) 4. Metoda italiae Giovanni Zenoni, Morfologia Greca, Venezia 1927. Dhe krahasuar me to, kemi arritur në përfundimin se S. Papahristo e zgjidh këtë problem në një mënyrë tepër origjinale. Kështu, greqishtja e vjetër ka tre theksa, që quhen, Theks i Mprehtë (Οξία), Theksi i Rëndë(Βαρεία) dhe Theksi i Përkulur Περιπωμείνη). Theksi i mprehtë tregon se zëri ngrihet, theksi i rëndë tregon se zëri ngrihet pak më ulët se i mprehti, ndërsa zëri i përkulur tregon, se zëri ngrihet dhe ulet në të njëjtën kohë. Për ta bërë këtë gjë të kuptueshme për lexuesin, ai shkruan në metodën e tij se: “Kur rrokjet e patheksuara kanë, zërin e notës muzikore sol, rrokja që ka theksin e rëndë, duhet të marrë zërin e notës si, ndërsa rrokja me theks të përkulur, duhet të marrë menjëherë zërin e notave si dhe sol njëkohësisht”⁶⁷. Duke vazhduar më tej sqarimin edhe për rastet e tjera, në të njëjtën mënyrë.

Duke patur parasysh se për cilin auditor e harton kryesisht ai këtë metodë, arrijmë në përfundimin se kjo zgjidhje nëpërmjet njohurive muzikore, tregon përveçse aftësi në fushën e metodikës dhe njohuri të gjerë të hartuesit, edhe nivelin e shkollave të mesme të asaj kohe, ku

⁶⁷ . Papahristo Gramatika e Greqishtes së Vjetër, Pjesa e Parë. Shtyp. Luarasi 1939. Fq. 14.

rëndësi e veçantë, i vihej edhe edukimit muzikor. Në lidhje me këto libra, duke gjykuar nga kopertina mësojmë se Pjesa e Parë dhe Pjesa e Dytë e Gramatikës së Greqishtes së Vjetër, janë botuar përkatësisht në vitet 1939, dhe 1940, dhe pjesa e tretë, Sintaksa e Greqishtes së Vjetër, është botuar në vitin 1942. Duke i studiuar këto libra, arrihet në konkluzionin se me të drejtë S. Papahristo, i quan në dorëshkrimin e tij “Autobiorafi” fq. 41 – 42⁶⁸, punime origjinale. Dhe kjo pasi që të tre librat nuk janë vetëm një pasqyrim i gramatikës së greqishtes së vjetër, vetëm sintaksë dhe morfologji, paralelisht, ato janë edhe një studim i mirëfilltë të gramatikës, së gjuhës shqipe, ku në çdo rast autori shpjegon për lexuesin përkitshmëritë dhe të parbashkëtat midis këtyre dy gjuhëve, dhe diçka e tillë, nuk lehtëson vetëm atë që mëson këtë gjuhë, por është njëkohësisht dhe një shpalosje nëpërmjet një analize të hollë, të gramatikës së gjuhës shqipe, ku përfshihen elementë të gramatikës historike, fonetikës, gramatologjisë etimologjisë etj, duke i dhënë këtyre punimeve karakter akademik, përpos funksionit të mësimin të gjuhës. Diçka e tillë bën që kjo punë të evidentohet edhe si një studim krahasues midis dy gjuhëve, tepër interesant për çdo studiues. Pra edhe në këtë drejtim , si kudo, ku ka kontribuar, S. Papahristo la gjurmë të një pune origjinale, diakronike dhe multifunksionale.

Duke kaluar në një revistë të shpejtë përmbajtjen e teksteve në fjalë vërehen bie fjala, në emri si pjesë e ligjëratës, tek kategoritë gramatikore të tij, të përbashkëtat midis greqishtes së vjetër dhe shqipes, përta i përket sistemit rasor, kështu flitet për rasën dhanore në të dyja gjuhët, ndërkohë që tek greqishtja e re rasa dhanore (Δοτική) nuk ekziston më. Gjithashtu shpjegohet nga ana funksionale, thirrori në gjuhën shqipe dhe në gjuhën greke, ku atë e kemi të evidentuar si rasë më vete (Κλιτική). Por gjithashtu vërehen edhe veçantitë, kështu përta i përket trajtave, vërehet se në greqishten e vjetër trajta e shquar formohet me nyjat shquese që i paravihen emrit, për çdo rasë,

⁶⁸ Papahristo S, Autobiografia, (dorëshkrim).

ndërkohë që në gjuhën shqipe formohet nëpërmjet, prapashtesave dhe mbaresave.

Te mbiemri, me shembujt e lakimeve të tyre së bashku me emrin, vërehet gjithashtu se ashtu si në gjuhën shqipe edhe në greqishten e vjetër, mbiemri përshtatet në numër gjini dhe rasë me emrin. Po ashtu evidentohen edhe të përbashkëtat përsa u përket shkallëve të mbiemrit, ku në të dyja gjuhët, kemi tre shkallë pohoren, kraharren dhe sipëroren, psh: i urtë, më i urtë, shumë i urtë; Σοφός, Σοφότερος, Σοφότατος. Gjithashtu tepër interesant është edhe kapitulli i foljes, ku të gjitha kategoritë e saj, kohët dhe diatezat janë një kalk gramatikor midis dy gjuhëve. Por edhe në kapitujt që pasojnë ku flitet për pjesët e tjera të ligjëratës, si pjesorja, ndajfolja, parafjalët, lidhëzat dhe pasthirmat, evidentohen ngjasimet gramatikore midis dy gjuhëve.

Pjesa e dytë e librit të dytë, fillon me një kapitull të veçantë, që autori e quan “Etimologjia”⁶⁹, ku në përgjithësi trajton foljet, emrat dhe mbiemrat e prejardhura, për çdo rast, duke bërë edhe analogjitë me gjuhën shqipe. Në fund të këtij kapitulli autori, vendos disa apendiksë, ku në të parin, si nënçështje të parë kemi mënyrën e shkrimit të emrave të përveçëm dhe të përgjithshëm prej grekëve të vjetër. Në nënçështjen e dytë, njohuritë mbi peshat, masat dhe monedhat e përdorura në Greqinë e Vjetër, dhe në nënçështjen e tretë, jepen të dhëna mbi kalendarin Atik, që përdorej prej grekëve të vjetër, mënyrën e ndarjes së kohës dhe emrat e ditëve dhe muajve. Në shtesën e dytë, referohen foljet e parregullta me mënyrat e zgjedhimit, ndërsa në të tretën, shpjegohen dialektet me të cilat shkruhej greqishtja e vjetër, dhe konkretisht autori me pjesë tekstesh dhe analiza gjuhësore, flet për dialektet e përdorura nga Homeri, kryeisht për dialektin jonik dhe atë eolik. Gjithashtu flitet në mënyrë analizuese edhe për dialektin e shkrimit të veprave të Herodotit, dialekti i të cilit konsiderohet, dialekti i ri jonik. Tepër interesant ky fakt, po të kihet parasysh se në përgjithësi S. Papahristo ka përkthyer,

⁶⁹ S. Papahristo Gramatika e Greqishtes së Vjetër, Pjesa e Dytë. Shtyp. Luarasi 1940. Fq 12, 34, 56.

poetët tragjikë, Aristofanin, Tuqididin dhe poetë të tjerë, që kanë shkruar kryesisht në dialektin atik. Kështu, marrja në mënyrë të detajuar me këto dy dialekte të tjera e kompletton profilin e S. Papahristos edhe si helenist, i cili i ka studiuar dhe ka përkthyer në të gjitha dialektet e greqishtes së vjetër. Libri i dytë përmbillet me një fjalor dygjuhësh, shqip – greqisht e vjetër, me rreth 4000 fjalë, nga më të përdorshmet, kryesisht fjalë të dialektit atik, që vjen si një zhvillim i dialektit të ri jonik, në përzgjedhjen e të cilave autori kondicionohet edhe nga tekstet që ka përzgjedhur në të dy librat për përkthim dhe karakterizimin e çdo mësimi; dhe po të kihet parasysh edhe fjalori që përdoret në fund të çdo mësimi me shpjegimet e duhura, numri i fjalëve rritet dhe S. Papahristo, mund të konsiderohet edhe si hartuesi i parë i një fjalori optimal Greqishte e Vjetër – Shqip, me kontribut të konsiderueshëm, në fushën e leksikologjisë. Në kopertinën e librit të dytë, jepet dhe vendimi i Komisionit Teknik të Ministrisë së Arsimit, Nr. 1033/I datë, 16. 03. 1939. për aprovimin e këtij teksti, si tekst mësues, në shkollat e mesme.

Në këtë referim, jemi marrë kryesisht me dy librat e parë dhe për arsye objektive, nuk kemi bërë pjesë të studimit librin e sintaksës së greqishtes së vjetër, me të cilin mendohet të meremi në mënyrë të detajuar dhe të veçantë, njëherë tjetër.

Në faqen e parë të librit të parë të gramatikës S. Papahristo shkruan: “Botimi i kësaj gramatike të Greqishtes së Vjetër, ka për të plotësuar, një nga mungesat kryesore që kanë degët klasike të liceve tona. Libri i përpiluar në bazë të provës së gjatë të autorit dhe të veprave të tilla që janë botuar në gjuhë të huaj, u përgjigjet mjaft mirë kërkimeve të metodës së re dhe ja arrin qëllimit të caktuar prej programit zyrtar”.

Hartimi i kësaj gramatike, njëherësh dhe metodë e mësimit së greqishtes së vjetër, që krahasuar dhe me metodat e tjera simotra, botuar në Europë, në këtë periudhë, një pjesë të të cilave kemi mundur ti konsultojmë mund të konsiderohet, nga më të mirat, shpjegohet me nivelin e lartë të formimit të tij si filolog dhe metodist.

Nëse, do kërkonim në biografinë e tij, do të mund të arrinim të kuptonim arsyet e kësaj shkalle të lartë formimi.

Kështu, S Papahristo, mbasi kryhen me sukses gjimazin dhe në vijim liceun^{*} në qytetin e Korçës, ku greqishtja e vjetër ishte lëndë e detyrueshme, pasi autorët klasikë dhe filozofë, studioheshin në original, ai vazhdon studimet universitare, në fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Athinës (1907 – 1912), ku mbas pesë vjetësh studime diplomohet në degën e filologjisë klasike të këtij Universiteti³. Kur kthehet në atdhe në vitin 1912, emërohet profesor i Greqishtes së Vjetër, Latinishtes dhe Historisë në gjimnazin grek të qytetit të Korçës (Pangjion Gjimnasion). Aktivitetin e tij si mësimdhënës këtu, ai do ta vazhdojë për dhjetë vjet rresht, deri në vitin 1922, kur kjo shkollë e mesme mbyllet nga autoritetet shqiptare që tashmë qeverisnin qytetin e Korçës. Kështu që nga kjo kohë kur ai ishte profesor në këtë lice, mendohet se filloi të perceptohet hartimi i një metode për mësimin e kësaj gjuhe, nëpërmjet leksioneve dhe teksteve që ai përgatitte çdo ditë⁷⁰.

Emri i mirë që do të linte në themelet e arsimit modern shqiptar S. Papahristoja, më pas, si drejtor i drejtorisë së arsimit, si hartues i parë i kurikulave për shkollat dhe sidomos me mirëmenaxhimin e liceut Francez në Korçë, bën që atij ti besohen gjithmonë detyrat më të rëndësishme dhe njëkohësisht më të vështira që kishin të bënin me arsimin në vend. Kështu në shtator të vitit 1933, Ministria e Arsimit e transferon në Tiranë, si Drejtor të Institutit Femëror “Nana Mbretëreshë”. Kryeministri i asaj kohe Pandeli Evangjeli së bashku me Ministrin e atëhershëm të Arsimit Mirash Ivanaj, këmbëngulin për emërimin e tij në postin e drejtorit të këtij instituti, pavarësisht

* Qysh në vitin 1856, në qytetin e Korçës në vijim të klasave të gjimazit, falë bujarisë së filantropëve korçarë dhe sidomos shumëve të vëna në dispozicion nga milioneri korçar Jovan Banka, funksiononte dhe liceu, pra shkolla e mesme e plotë.

³ Beduli K. “Mësues i Mësuesve dhe helenist i shquar. Sotir Papahristo”, Tempulli 9, fq 93, Korçë 2004.

⁷⁰ Tushi D. “Sotir Papahristo, Një Figurë e Shquar e Arsimit, Pedagogjisë dhe Përkthimit”, Kërkimi 10. Fq 78, Tiranë 2015.

refuzimit të përsëritur nga ana e S. Papahristos. Ngritja e kësaj shkolle me programe bashkëkohore dhe më pas me një infrastrukturë ndërtimore moderne për kohën, ishte në përgjithësi një meritë tjetër e këtij drejtuesi të palodhur dhe të ndërgjegjshëm, që me përkushtim dhe dashuri punoi në kushte dhe rrethana të vështira për arsimimin dhe fisnikërimin e popullit. Këtu ai do të qëndronte deri në maj të vitit 1939. Gjatë kësaj periudhe ai pothuajse e ka hartuar pjesën e parë të gramatikës së greqishtes së vjetër, dhe e boton atë, si një teks ndihmës për nxënëset e institutit, pasi miratohet nga një komision i posaçëm i Ministrisë së Arsimit të atëhershëm.

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, në kuadrin e frenimit të përgjithshëm të arsimit dhe kulturës kombëtare në vend, goditet dhe Instituti Femëror nëpërmjet transferimit të drejtorit të saj S. Papahristos në gjimnazin e Shkodrës, me urdhër të Ministrit të atëhershëm të Arsimit Ernest Koliqit. Si argument i transferimit u paraqit fakti se nxënëset e Institutit ishin patriotë dhe shfaqën hapur indinjatën e tyre për humbjen e pavarësisë së vendit dhe për këtë, shkaktar u konsiderua pikërisht drejtori. Në Shkodër S. Papahristoja qëndron për një kohë të shkurtër dhe me hapjen e një vendi të lirë në gjimnazin e Tiranës, emërohet atje si mësues i Greqishtes së Vjetër⁷¹, kohë kur ai përfundon pjesën e dytë dhe të tretë të gramatikës së greqishtes së vjetër, dhe pasi këto tekste marin miratimin e Ministrisë së Arsimit, i boton ato, në shtëpinë botuese “Luarasi”, përkatësisht në vitet 1940 dhe 1942. Për tu përdorur në mësimdhënien e greqishtes së vjetër, në gjimnazin e Tiranës.

Do të mjaftonte thjesht dhe vetëm ky kontribut i tij, që S. Papahristo të kujtohej me mirënjohje nga filologjia dhe pedagogjia shqiptare. Ashtu siç është shprehur edhe Lazgush Poradeci për të. “Lazgushi më ka thënë”, ku shkruan: “... Sa madhështore dhe sa e shndritshme bëhej ajo dhomë kur rastiste të vinte aty plaku i urtë, patriarku i pedagogëve të Shqipërisë, profesor S. Papahristo, që sillte

⁷¹ Temo S, Buletin shkencor, fq. 24, Korçë 2008.

me vete të gjallë, të tërë botën e bukur dhe heroike të lashtësisë greke.”⁷²

Literaturë

S. Papahristo Gramatika e Greqishtes së Vjetër, Pjesa e Parë. Shtyp. Luarasi 1939.

S. Papahristo Gramatika e Greqishtes së Vjetër, Pjesa e Dytë. Shtyp. Luarasi 1940.

Papahristo S, Autobiografi, (dorëshkrim).

D. Tushi, Sotir Papahristo, Një figurë e shquar e arsimit, pedagogjisë dhe përkthimit, Kërkimi 10, Tiranë 2015.

Beduli K. “Mësues i mësuesve dhe helenist i shquar. Sotir Papahristo”, Tempulli 9, Korçë 2004.

Temo S, Buletin shkencor, Korçë 2008.

Kolevica P, Lasgushi më ka thënë, fq 6, Tiranë 1992.

Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985.

⁷² Kolevica P, Lasgushi më ka thënë, fq 6, Tiranë 1992.

ELVIS BRAMO
 Universiteti i Tiranës
 elvisbramo@yahoo.com

SINTAKSA E VARGJEVE NË PËRKTHIMET E TRAGJEDIVE GREKE NGA S. PAPAHRISTO

Dëshiroj ta nis kumtin tim, me pohimin që përkthimi i veprave të klasicitetit grek (krahas atij latin më vonë), është një ngjarje e shënuar jo vetëm letrare, por për gjithë kulturën kombëtare në tërësi, kur vepra të tilla, të përkthyer* drejtpërdrejt nga origjinali, greqishtja e vjetër, janë të rralla edhe në kultura të ndryshme evropiane, përfshirë këtu helenistët e lashtë aq të paktë edhe në letërsinë e sotme moderne greke. Për vetë ndryshimin semantik që bartin foljet “përkthej” dhe “shqipëroj”, shënojmë që të gjitha veprat e autorëve të mëdhenj: Eskilit,⁷³ Euripidit,⁷⁴ Sofokliut,⁷⁵ dhe Aristofanit,⁷⁶ të sjella në gjuhën tonë (përveç tragjedisë “Prometheu i lidhur” – si e para vepër dramatike që na ka ardhur prej prof. Papahristos, më 1950), kanë pranë emrit të tij foljen “shqipëroj”, si një traditë e bukur që nga librat e huaj të përkthyer para vitit 1944. Mendojmë se ky shqipërim i dramatikës së 4 shkrimtarëve të shquar grekë, për të cilët thuhet se u ushqyen “*në sofrën e begatë të Homerit*”, ka rëndësi jo vetëm për

* Në fjalorin e gjuhës shqipe, 2006, fjala “përkthej”, e cila ka një fushë semantike më të gjerë se “shqipëroj”, shpjegohet: “e kthej në një gjuhë tjetër: *përktheu një roman (nga anglishtja)...*” 2. tekst a vepër që është përkthyer: *përkthim i lirë, përkthimet e Nolit*. (Në mjaft vepra të përkthyer para Luftës II Botërore, në gjuhën shqipe, është përdorur folja “shqipëroj”, e cila shpreh semantikën si folja “përkthej”, por të përcaktuar në gjuhë shqipe.)

⁷³Eskili, *Prometheu i lidhur*, Përkthyer nga greqishtja e vjetër prej prof. S. Papahristos, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve dhe e Shpërndarjes, Tiranë, 1950. [Në parathënie të trilogjisë “Orestia”, është shkruar se Eskili *është ati i tragjedisë*”, kurse njëri prej kritikëve e ka quajtur trashëgimin e tij *si një nga momentet më madhështore që njerëzimi ka trashëguar nga gjithë thesari i krijimtarisë mendore të Greqisë së vjetër.*”]

⁷⁴Euripidi. *Medea*, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, Tiranë, 1956.

⁷⁵Sofokliu, *Antigona*, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, Tiranë, 1957.

⁷⁶Aristofani, *Bretkosat* (Komedi), Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, Tiranë, 1958.

njohjen e letërsisë së lashtë greke, që i dha modelet e shkëlqyera të krijimit skenik të gjitha gjuhëve evropiane, por për ne sot, përbën edhe një pasuri gjuhësore të vetë shqipëruetit të talentuar, nga ana tjetër, edhe për t'u njohur me stadin e zhvillimit të vetë shqipes në aktin e përkthimit, si një lidhje e traditës së shqipërimin deri në kohët tona, kur numri i autorëve dhe veprave të tyre në shqip, janë shtuar në masë të madhe. Nuk duhet lënë pa theksuar këtu, se puna me gjuhën e shqipëruetit të mëdhenj si prof. Papahristo, jep lëndë të mjaftueshme edhe për studime gjuhësore në rrafsh të ndryshme: nga drejtshkrimi, fonetika, leksiku, morfologjia, fjalëformimi dhe në mënyrë të veçantë, më gjerë, nga sintaksa, jo aq për 70 vjet nga koha e botimit të këtyre veprave, por sidomos, në aktin e vështirë të kalimit të gjuhës e bashkë me të, edhe kulturës së një populli tek një gjuhë e kulturë tjetër, në rastin tonë, të fqinjëve tanë për mijëra vjet bashkëjetesë. Papahristoja la gjurmë gjuhe në përkthimet e veta, jo vetëm si shqipëruet “i pashoqtë”, si shkruan ai për njërin tragjik të paarrtishëm grek, por, me artin e tij, si kompetencë të gjuhës dhënëse, ai krijoi atë që quhet *stili i autorit*, duke qenë vetëm shqipëruet. Do të na mjaftonin pak fraza të një prej parathëniesve më mjeshtërore që i bën tragjedisë “Prometheu i lidhur”, për të kuptuar dhe dalluar verbin e tij, fjalitë e frazat, me të cilat arrin të bëjë përngjashmimin e fatit të tij me atë të titanit mitik grek. Shkruan Papahristoja:

“Nga dramati e “Atit të Tragjedisë” më tërhoqi më tepër “Prometheu i lidhur”. Jo se se tragjedit’e tjera Esqiliane nukë qëndrojnë në atë lartësi, ku ka mundur t’i ngrerë dora mjeshtërore e poetit, po pse në protagonistin e kësaj drame veçan – në ka leje të bëhet krahasim midis një njeriu të thjeshtë dhe një Titani – shoh si në pasqyrë vuajtjet dhe përpëlitjet e shpirtit tim të përvëlur, vuajtjet dhe përpëlitjet e atij oh ! që më plagosi rëndë...”⁷⁷

Mësojmë nga shqipërueti ynë se ai ka mundur t’i qëndrojë besnik origjinalit në fjali e fraza, besnik i teksteve sa i takon masës poetike,

⁷⁷Eskili, *Prometheu i lidhur*, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve dhe e Shpërndarjes, Tiranë, 1950, f. 3.

me *iambin*,⁷⁸ *dodekasilabin**, tregon se për strukturën e dramës, është mbështetur në botimin e gjuhës frënge, të Shtëpisë Botonjëse “Ernest Flamarijon” të Parisit, me qëllim që kur të vijë dita – *e cila me zhvillimin e artit theatral në vendin tonë ka për të ardhur shpejt – të mundet të çfaqet kjo dramë mi skenën shqiptare pa ndonjë vështirësi të madhe*. Edhe më gjatë mund të flitet për artin e fjalës së shqipëruetit tonë, nëse zgjatemi në analizën e veprave të Eskilit që bën Papahristoja ynë në paratekstin e kësaj tragjedie.⁷⁹ Në mbyllje të paraqitjes së përkthyesit, duhet përmendur që në shumë kultura letrare të popujve të Evropës, njafte vepra të këtij niveli, përfshirë edhe klasikët e mëvonshëm, apo poema botërore, si Komedia Hyjnore apo Fausti e të tjera, janë përkthyer në prozë. Është krenari që, falë helenistëve dhe latinistëve tanë, italianistëve, gjermanistëve, këto kryevepra u shërbejnë brezave tanë në gjinitë e origjinalit, në vargje, traditë që krijuan Noli e Papahristoja, Pashko Gjeçi e Lasgush Poradeci, Gjon Shllaku e Shpëtim Çuçka, ky i fundit, me shqipërimin e Faustit, në vargje të rimuara, etj.

Përgjatë vështrimit gjuhësor, do të bazohemi në shqipërimet e tri tragjedive të tre autorëve të mëdhenj: Eskilit, Euripidit dhe Sofokliut, përkatësisht sipas dramave “Prometheu”, “Medea” dhe “Antigona”. Disa momente duhen pasur parasysh kur hulumtohet nga pikëvështrimi i sintaksës: i pari, në aktin e përkthimit jemi para asaj situatë a synimi, që U. Eco e quan *thujtje e njëjta gjë*, problem që, sipas semioticienit italian, bëhet çështje qendrore në përkthimin

⁷⁸Ferdinand Leka, *Fjalor i termave të letërsisë*, Infobotues, Tiranë, 2013.[Në metrikën e lashtë greke e latine quhej “këmbë” një grup rrokjesh të gjata e të shkurtra, të cilat përsëriten në mënyrë ritmike në varg.

Kryesore kanë qenë: *daktili* (–∪), *spondeu* (—), *trokeu* ose *koreu*(–∪), *jambi* (∪–), *anapesti* (∪∪–), *amfibraku* (∪–∪) ; p.sh. fjala *krojeve*, quhet daktilike, fjala *liri* është një jamb, *tufani* është një amfibrak e kështu me radhë.]

* dymbëdhjetërrrokëshin.

⁷⁹Eskili, *Prometheu i lidhur*, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve dhe e Shpërndarjes, Tiranë, 1950, f. 3.

poetik, pa kaluar në diçka kryekëput *tjetër*.⁸⁰ Edhe me një epigramë të poetit duket kjo dhe që shqipëruesi nuk mund ta tjetërsojë, sepse vetë Eskili mori pjesë në tri beteja: në Maratonë, Salaminë dhe në Plateja; janë vargje që e arrijnë figurën e hipotipozës,⁸¹ që do ta bënin të dukshëm poetin edhe atëherë kur të ndodhej nën tokë:

*“Esqilin nga Athina.....Për këtë trim do të flasë
të bir’ tEforionit.....Fusha e Marathonës
e ruan me kujdes.....dhe Medi flokëgjati
kjo tokë e begatshme.....q’ enjohti fare mirë.”
që ka qyteti Gjella.....(Prometheu..f.7-8)*

I dyti, përkthyesi ka në vëmendje postulatit e mbrojtësit të përkthyesve, Shën Jeronimit, i cili shkruante që në përkthim nuk duhet *verbum e verbo sedsensumepriore de sensu*. Pa u zgjatur në teori përkthimi, na duket me vend të sjellim mendimin e Eco-s, që lidhet me aktin e vështirë të shqipërimit, sidomos, nga gjuhë të vdekura, siç është greqishtja, sepse *të përkthesh do të thotë të kuptosh sistemin e brendshëm të një gjuhe dhe strukturën e një teksti të caktuar në atë gjuhë, dhe të ndërtohet një sistem të dyfishtë tekstor që, me një përshkrim të caktuar, mund të shkaktojë pasojat të ngjashme tek lexuesi, si në planin semantik e sintaksor ashtu edhe në atë stilistik, metrik, fonosimbolik, e po aq në efektet gjithë pasion që teksti burimor prirej të sillte.*⁸²

Shqipëruesit të klasikëve grekë i duhet të shkojë sipas disa regjistrave metrikë e ritmikë, siç është kalimi nga 12 rrokëshi, në 6 rrokësh (te Prometheu), në 8 rrokësh (te Antigona dhe Medea). Këtyre variacioneve tekstore u përgjigjen edhe strukturat e frazave, edhe në gojën e Titanit: herë me apostrofë, herë me retorikë, herë demaskuese dhe herë qëndrestare; gjuha në gojën e Pushtetit, edhe në gojën e

⁸⁰Umberto Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë* – Nevoja përkthimi, Shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 2006, f.296.

⁸¹Ferdinand Leka, *Fjalor i termave të letërsisë*, Infobotues, Tiranë, 2013.


⁸²Umberto Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë* – Nevoja përkthimi, Shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 2006, f.17.

Korit me strofat dhe antistrofat e kënduara; nga vendosmëria e Antigonës që e sundon dashuria për vëllanë, te idioma e monologut të Kreonit, nga burrëria tradhtare e Jasonit, te gjuha e urrejtjes dhe hakmarrjes së egër të Medeas etj. Që në skenën e dytë e merr fjalën Titani Promethe, i cili, me zërin ushtues, nis e thërret: *ether dhe yje, burime e detëra, diellin dhe Tokën-mëmë*, që ta shohin atë – hyjin – çfarë po pëson dhe ç’ të zeza po heq! Jo rrallë, në gojën e aktorëve të tragjedive, Papahristo ka mundur të sjellë, mbase për herë të parë në lagjen e përkthyesve tanë, atë që, me interpretimet e sotme, quhet *ironi hipertekstuale*.⁸³ Është fjala për ironinë e fatit, për atë Hyj, si Prometheu, që ashtu i mbërthyer në shkëmb, në aktin III, zë e rreshton të mirat që u ka sjellë njerëzve: dhe frazat rrjedhin enumerative, me bashkime paratakse, si:

*për të mjerët njerës vetëm do t’ju thom/
si më parë ishin mendje çiliminjsh/
dhe si unë i bëra njerës me gjykim.*


Nga dashuria që ka për njerëzit, Titani-Hyj, vazhdon të përmendë mirësitë e pafund që ka bërë: fraza e shqipëruarit vjen e bëhet më e ndërlikuar, dalin në pah segmentimet dhe ndërvendosjet e njësive predikative dhe gjithë periudhat shfaqin shkallët e ndërvarësisë, si në strukturën më poshtë, e cila thuret me simetri funksionale, si një renditje bëmash:

“Këta më përpara ndonëse kishin sy, asgjë nuk shëkonin: ndonëse kishin veshë, asgjë nuk dëgjonin, po si hije ëndrrash jetën e kalonin që prej shumë kohe, duke ngatërruar çdo gjë krejt më kot; as shtëpi me tulla s’ dinin të ndërtonin, as drurin s’ dinin si ta përdorin, po si milingonjtë që gjithmonë lëvizin nën dhë banonin thellë nëpër shpella ku rrezet e diellit nuk hynin kurë.” (f.42)




⁸³Po ai, po aty, f. 227.

Midis shpikjeve për njerëzit, Titani vë në rend të parë edhe numrat e shkronjat, me të cilat mbruhen dituritë e përjetshme; fraza në shqip, me dy QOS, na vjen me ndërtime disashkallëshe, me homogjeni funksionale sintaksore, dhe mjete lidhjeje të njëjta:



Mjafton një fjali e vetme, në 4 vargje me një folje, vënë pranë frazave më sipër dhe lidhur me konektivin kundërshtor “ndërsa”, për të shprehur ironinë hipertekstuale, përballë fatit të egër Hyjit Promethe:



Te Medea e Euripidit, për të cilin Aristofani pat shkruar se *imitonte gjuhën e tij të bukur, por jo mendimet e tij të dobëta*,⁸⁴ gjuha e përkthyesit tonë na vjen aq tragjike, si ngjarjet që përshkruan, aq hakmarrëse, vrasëse dhe e përgjakur, njëkohësisht shumë prekëse e patetike brenda dhembjes së fortë të një nëne që i duhet të vrasë deri dhe fëmijët e vet! Sapo del në skenë, Medea ulërin dhe shpërthen në mallkime, drejtuar Jasonit e shtëpisë së Kreonit mbret, mallkime edhe ndaj jetës së saj, që, gjuhësisht, mbështeten në trajtën foljore të

⁸⁴Euripidi, *Medea*, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, Tiranë, 1956, f. 4.


dëshirores, të cilat Papahristo-ja na i sjell me përshkallëzimin në rritje, si vijon:⁸⁵

*“Ju, or fëmijë të mallëkuar vdekshi, u shofshi bashkë me atin,
Bij të një nëne fort të urretjur pluhur u bëftë gjithë shtëpia!*

*Oh! Flaka e qjellit
Rëntë mbi mua, mbi kryet tim!
Jeta për mua ç'gëzim do ketë?
Medet! Medet! Mortja i dhëntë
Fund jetës sime, jetës së zezë! (f.17)*

Autori i madh dhe përkthyesi ynë ka treguar se këto përzgjedhje leksiku dhe struktura fraze, që janë njëherësh edhe struktura mendimi, vijnë e shpjegohen prej vetë heroinës kryesore, Medeas, e cila u pohon grave Korintjane se “...Nga tërë krijesat/ me shpirt e gjykim, shumë më të mjera/qenkemi ne gratë...!” Në planin psikik, asaj i duhet të shpjegohet për gjendjen e rëndë shpirtërore, braktisur e poshtëruar nga i shoqi, kërkon edhe të shfajësohet për hakmarrjen që do të bëjë; prandaj dhe shfaqen monologë me periudha të ndërlikuara, me njësi fjalish të prera, në ngjashmëri me maximat:

“Nga ju tani unë këtë nder kërkoj:
po t’ia gjej volinë hakun t’ia marr
burrit për të zezat që lëshon mbi mua,
të mos flaç, të heshtësh; se me të vërtetë
femra në çdo rasje është frikacake;
kjo përpara forcës është shum’e dobët,
bile nuk ka zemër të shohë dhe hekur;
po kur i a prekin shtratit e kurorës,
zemër më të egër nukë mund të gjesh.”




Në tragjedinë “Antigona”, shqipëruar gjashtëdhjetë e dy vjet më parë (1957), bëhet fjalë për një rit, një ceremoni varrimi, që motra do ta bëjë për vëllanë Polinikun, dënuar për së vdekuri nga mbreti, që të lihet përmbi dhe, në mëshirën e shpendëve e qenve ! Gjuha e

⁸⁵Po ai, po aty, f. 15.

personazheve është e shtruar, kërkon arsyetime, gjykime sociale, është gjuhë e botës së ndjenjave, për t'i mbrojtur ato deri në vdekje pas vendimit të tiranit kokëfortë; vepra përshkohet nga shprehja e kontrasteve, lufta e brendshme shpirtërore, me vlera të larta moralizuese, prandaj dhe *vazhdon të ngjallë admirimin e botës së qytetëruar*, si nënvizon përkthyesi ynë në parathënie të tragjedisë.⁸⁶ Kjo ka përcaktuar dhe strukturën e fjalive dhe ndërtimin e frazave, jo veç në gojën e heroinës, por edhe të Ismenës, vetë tiranit, deri te shortari Tiresia, pa lënë jashtë lëndën e gjerë gjuhësore që gjeneron kori i kësaj vepre skenike, ashtu si tek të gjithë klasikët e mëdhenj të antikitetit grek. Në skenën III Kreoni jep vendimin:

“Sa për Polinikum, për vëllan’ e tij,*
q’erdh nga internimi kundër këtij vendi,
kundr’atdheut tij dhe të atit të tij,
me qëllim të digjte tempuj e qytet,
racës tij t’ja thithte gjakun sa të ndonej
dhe ju të gjithë rob’e skllev t’ju bënte
për këtë pra çpalla që të mos varrosot
dhe asnjë qytetas ta vajtojë, ta qajë,
po mbi dhe të mbetet dhe i pa varrosur
që ta hanë qenjtë edhe shpendët bashkë
edhe kush ta shohë të i ngjethet mishtë.”

(Ant./f.18)



Si ndjekës i sintaksës racionale, Papahristo nuk mungon të ndërtojë vargje fjalish me anakolut, siç shihet në dy njësitë e fundit predikative, tek mjeti i lidhjes sintaksore, përemër i pacaktuar “kush”.

Një dukuri sintaksore që ndeshet dendur në përkthimet/shqipërimet e prof. Papahristos, në të gjitha dramat/tragjeditë e klasikëve të mëdhenj, është edhe fenomeni i quajtur “l’enjambement”, një ndërtim sintaksor, ku shfaqet tejkalimi nga vargu në varg, për arsye semantike, të cilat janë vënë në ritmin poetik dhe metrin e strofës, ashtu si duket edhe në modelet që po paraqesim:

⁸⁶Sofokliu, *Antigona*, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, Tiranë, 1957, f. 6.

<p>“Pa shikoni, vini re, se si unë <u>me zinxhira</u> i mbërthyer mu në buzë të greminës, do bëj roje dhe zili për këtë punë nuk do më ketë askush.”</p> <p>(Pro./f.28)</p>	<p>“Mos pushofsha <u>kurrë së nderuar hyjet</u> me fli plot hire-plota pranë rrym’s’ujit tund, të pashterur fare t’atit Oqean.”</p> <p>(Pro./f.96)</p>	<p>“Lum ata që e <u>kalojnë jetën</u> pa një hidhërim; se kur dor’e <u>perëndive trondit</u> ndonjë shtëpi, një pas një <u>fatkeqësirat</u> e mbulojnë brez pas brezi.”</p> <p>(Antig./f.40)</p>	<p>“Ti nga vatra e <u>tyt eti</u> me një zemër të tërbuar u largove edhe ike, pasi humbe, moj e mjerë, edhe shtratin, edhe burrin kështu sot po të dëbojnë..”</p> <p>(Medea/f.30)</p>
---	--	--	---

Do të ishte mirë që për vështrime të tilla të gjuhës së përkthyesve të kishim kompetencën për t’i parë në planin krahasues: nga gjuha dhënëse–greqishtja e vjetër–tek ajo marrëse–shqipja, megjithatë, duke menduar se akti i shqipërimit është njëherësh edhe krijim, stil dhe kulturë e atyre që marrin një detyrë kaq të vështirë, që ka përballuar prof. Papahristoja, këtu e më tej se gjysmë shekulli më parë, i rëndësishëm është edhe vetë vargu poetik klasik që ka mundur të sjellë ky veprimtar i arsimit, dijetar dhe misionar i letrave shqipe, për të cilin nuk do të ishte e tepërt të thonim se e meriton një *opera omnia*, një botim akademik, si përkthyes i *pashoqtë* i veprave të papërsëritshme të klasicizmit grek.

Përfundime

Në disa pika do t’i përfshijmë përfundimet e kumtit tonë:

Së pari, lënda gjuhësore e shqipëruar prej prof. Paphristos është jo vetëm një kompetencë e shquar në këtë lëmë, por ajo përbën edhe një material studimi më vete për nivele të ndryshme të kërkimit filologjik, në mënyrë të veçantë për variacionin gjuhësor të logosit të skenës.

E dyta, bashkë me shkrimet dhe ndihmesën që ka dhënë prof. Papahristoja në fushë të arsimit, me shqipërimin e dramave klasike nga autorët e mëdhenj grekë, ai ka përvijuar edhe stilin e tij, siç quhet rëndom *stili i autorit*.

E treta, kush merr e lexon me vëmendje gjuhën në përkthim të veprave klasike nga Papahristoja, e dallon ç’punë e pastër dhe me ç’themele vjen fjala shqipe në këtë proces.

Së katërti, kanë nisur në ditët e sotme të ripërkthehen vepra të

njohura, me rëndësi nga autorët evropianë e më tej, dhe mirë bëhet, pasi ato kështu mund të sillen në koherencë me zhvillimet e hapura e dinamike të shqipes, lëvrimit dhe pasurimit të saj; mund të thuhet se për trashëgimin kulturor të Papahristos, kjo nuk ndjehet e nevojshme, por nevojë është t'i ribotohet kontributi i tij, pasi kanë kaluar jo pak vite nga gjysma e parë e shek. XX.

E pesta, në sintaksën e vargjeve përgjatë shqipërimeve klasike të Papahristos, shfaqen mjaft dukuri strukturore dhe veçori të njësive të kësaj disipline.

Literaturë

Eskili, *Prometheu i lidhur*, Përkthyer nga greqishtja e vjetër prej prof. S. Papahristos, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve dhe e Shpërndarjes, Tiranë, 1950.

Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006.

Euripidi, *Medea*, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, Tiranë, 1956.

Sofokliu, *Antigona*, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, Tiranë, 1957.

Aristofani, *Bretkosat* (Komedi), Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, Tiranë, 1958.

Ferdinand Leka, *Fjalor i termave të letërsisë*, Infobotues, Tiranë, 2013.

Umberto Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë – Nevoja përkthimi*, Shtëpia bot.“Dituria”, Tiranë, 2006.

**JONELA SPAHO
DION TUSHI**

Universiteti i Korçës
jspaho@gmail.com
diontu@gmail.com

**SOTIR PAPAHRISTO- FIGURË E SHQUAR E ARSIMIT,
PEDAGOGJISË DHE PËRKTHIMIT**

Një figurë shumë e rëndësishme e arsimit dhe kulturës shqipe është pa dyshim edhe Sotir Papahristo, i njohur më tepër si shqipëruet i letërsisë klasike, kryesisht helene, dhe shumë pak i trajtuar dhe i përmendur si një ndër themeluesit kryesorë të arsimit kombëtar, qysh me krijimin e Drejtorisë Kombëtare të Arsimit dhe si ristrukturues dhe themelues i dy qendrave të rëndësishme të arsimit të mesëm në vendin tonë: Liceut Kombëtar të Korçës, i njohur si Liceu Francez dhe shkollës pedagogjike për vajza “Nana Mbretneshtë” në Tiranë. Sotir Papahristo është i njohur edhe për përkthimet dhe adaptimet e disa veprave që lidhen me kulturën dhe edukatën fizike në përgjithësi, si dhe për konceptimin e disa teorive reformuese, krejtësisht origjinale në arsim, të cilat i aplikoi me sukses për gjatë gjithë periudhës së karrierës së tij didaktike, në qendrat e përmendura më lart, duke i promovuar me sukses edhe në seminare të ndryshme kualifikuese, të cilat ai vetë i organizoi qysh në vitin 1922 e andej, kur ai ishte inspektor dhe më vonë kryeinspektor i arsimit në rrethin e Korçës, pa harruar dhe kontributin e tij në publicistikë, kryesisht në shtypin e qytetit të Korçës, gjatë viteve 20 – 30. Pra për Sotir Papahriston, ka shumë për të thënë, kontributi i tij i shumanshëm dhe tepër i çmuar, patjetër që duhet të ngacmojë studiues të sferave të ndryshme të historisë së arsimit, pedagogjisë, didaktikës, sociologjisë dhe përkthimit të letërsisë klasike.

Të dhëna mbi jetën e aktivitetin e Sotir Papahristos

Sotir Papahristo, ka lindur më 11 Dhjetor, të vitit 1887, në Vëmbel, fshat afër Bilishtit, që tashmë ndodhet në territorin e shtetit

grek dhe njihet me emrin Moshohori. Siç del dhe nga shënimet e tij biografike, mësimet e para i mori në fshatin e lindjes, për t'i vazhduar më pas në gjimnazin e Komunitetit Ortodoks të Korçës,⁸⁷ me bursë të mitropolitit të qytetit të asaj kohe Gjerasim Orollogas. Duke cituar përsëri shënimet biografike të tij mësojmë se kur vjen në gjimnazin e Korçës, fillimisht ai vështirësohet shumë sidomos në gjuhën frënge: *“Unë s’ dija asnjë fjalë frëngjisht, ndërsa shokët kishin bërë frëngjisht një vit të tërë në shkollat fillore të qytetit të Korçës...por shpejt i arrita shokët në sajë të ndihmës që më dhanë disa bashkënxënës”*. S. Papahristoja regjistrohet në vitin 1901, në gjimnazin e Komunitetit Ortodoks të Korçës. Asokohe, në shkollat fillore të qytetit të Korçës, apo siç quheshin ndryshe të Mitropolisë, frëngjishtja zhvillohej si lëndë mësimore që në shek. XIX.

Për shkak të dhunës së verbër dhe fanatizmit, fshati i tij shkatërrohet në korrik të vitit 1902. Papahristoja shpëton si rezultat i planit të të atit të tij, i cili ishte prift i fshatit. Kështu, kur ai shkon në Vëmbel për pushimet e verës, i ati një natë para tragjedisë e dërgon në pazarin e Bilishtit dhe më pas në Korçë, me bakallin e fshatit, për ta shpëtuar. Ja si e përshkruan S. Papahristoja këtë ndodhi në kujtimet e tij: *“Të nesërmen në 20 korrik të vitit 1902 u shpall kryengritja. Fshatarët të gjithë braktisën shtëpitë dhe u ngjitën në mal. Devollinjtë muhamedanë e grabitën dhe e dogjën fshatin. Në mal ndodhi një tragjedi e tmerrshme. Njëzet të rinj dhe disa të moshuar u fshehën në një shpellë të madhe. Por ushtria turke i diktoi dhe i ftoi të dorëzohen. U dorëzuan për provë dy vetë, por me të dalë nga shpella u copëtuan prej ushtarëve. Ata të shpellës, duke dëgjuar lebetinë e shokëve të tyre s’deshën të dorëzohen. Atëherë ushtria e mbushi grykën me shkarpa dhe kashtë dhe i vuri zjarrin. Tymi u shpërnda në shpellë me rrezik të vdesin të gjithë nga asfiksia. U zhvillua një skenë e tmerrshme, një nga ata që ishte guximtar, rrëmben pushkën dhe i vret të gjithë, përveç njërit.... Edhe këtu shoh gishtin e fatit tim. Po të mos kisha ikur nga fshati sigurisht që do të isha me të njëzetët, mbasi për armë nuk isha i*

⁸⁷ Papahristo S, Autobiografi, fq 2, (dorëshkrim).

zoti dhe do të gjeja vdekje të llahtaritur.(Zoti) E kurseu jetën time mbase parashikonte veprimtarinë që do të zhvilloja në të ardhmen si edukator dhe shkrimtar⁸⁸”

Sotir Papahristo një ndër kuadrot e parë të Arsimit Kombëtar

Mbasi kryhen me sukses gjimazin dhe në vijim liceun në qytetin e Korçës, ai vazhdon studimet universitare, në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Athinës (1907–1912), ku pas pesë vjetësh studime diplomohet në degën e filologjisë klasike të këtij universiteti⁸⁹. Kur kthehet në atdhe në vitin 1912, emërohet profesor i Greqishtes së Vjetër, Latinishtes dhe Historisë në gjimnazin e qytetit të Korçës (Pangjion Gjimnasion). Aktivitetin e tij si mësimehënës këtu, ai do ta vazhdojë për dhjetë vjet rresht, deri në vitin 1922, kur kjo shkollë e mesme mbyllet nga autoritetet shqiptare që tashmë qeverisnin qytetin e Korçës. Në korrik të vitit 1922 emërohet si inspektor i arsimit në shkollat e Korçës, detyrë që e vazhdon me përkushtim deri në vitin 1925. Vështirësitë dhe sfidat që mbartte arsimit shqiptar, i cili ishte në hapat e para të organizimit të tij, u kapërcyen me sukses falë punës së tij të palodhur. Ja si e përshkruan ai në kujtimet e tij fillimin e kësaj detyre të vështirë: *“Si inspektor vizitova shkollat e qytetit. Personeli për tokë, pa asnjë dije pedagogjike dhe didaktike, i përbërë nga burra dhe gra që kishin mbaruar vetëm një shkollë fillore. U dëshpërova, si t’ia bëja? Kërkova rregullore që të caktonte detyrat e inspektorit, por nuk kishte fare. Atëherë iu drejtova ndërgjegjes e kjo më udhëzoi ç’të bëja. Së pari duhej përmirësuar personeli, dhe mbajta një sërë konferencash mbi qeverimin e fëmijëve në shkollë. Këto konferenca i botonte edhe gazeta “Shqiptari i Amerikës”. Materialet e këtyre konferencave, një pjesë të cilave ai i nxirrte nga tekste didaktike dhe pedagogjike në gjuhën greke dhe italiane, S. Papahristoja do t’i ripunonte dhe do t’i plotësonte për t’i botuar më pas si libra të veçantë me titujt përkatës; “Qeverimi i fëmijëve në shkollë” dhe “Mësime*

⁸⁸ Papahristo S, Autobiografi, fq 4, (dorëshkrim).

⁸⁹ Beduli K. “Mësues i Mësuesve dhe helenist i shquar. Sotir Papahristo”, Tempulli 9, fq. 93, Korçë, 2004.

shembëllore për lëndët që mësohen në shkollat fillore dhe të mesme". Këto libra me të drejtë mund të quhen si veprat e para pedagogjike dhe didaktike të shtetit të ri shqiptar që ndihmuan shumë në emancipimin profesional të mësuesve të parë, duke mbuluar kështu një boshllëk shumë të madh dhe duke u bërë veprat e para referuese për mësimdhënësit e zellshëm. Në mars të vitit 1925, me propozim të kryeministrit Koço Kotta, Sotir Papahristoja emërohet titullar i Drejtorisë së Arsimit, e cila komunikonte me Këshillin e Ministrave nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë. Me emërimin e tij në krye të këtij institucioni, gjëja e parë që i kërkoi si kusht qeverisë dhe presidentit, për ta pranuar emërimin, ishte independenca e këtij institucioni nga Ministria e Drejtësisë dhe funksionimi i saj si organizëm i pavarur. A. Zogu e aprovon dhe S. Papahristoja fillon veprimtarinë në postin e drejtuesit të arsimit shqiptar, duke u përballur me sfida të reja, që ishin sfidat e arsimit shqiptar në fillimet e tij, tashmë në një plan më global. Në këtë aktivitet të bie në sy jo vetëm përkushtimi i tij, por edhe ndërgjegjja e lartë profesionale që e karakterizonte. Në kujtimet e tij për këtë moment të rëndësishëm dhe tepër me përgjegjësi në karrierën e tij ai do të shkruajë: *"Ngrita një komision me arsimtarët më të mirë, me A. Xhuvanin, M. Ivananë, N. Palucën dhe L. Naçin..., me anë të këtij komisioni që punoi gati tre muaj përpilova ligjet e arsimit, rregulloret dhe programet e tjera dhe i vura bazat arsimit. Përveç këtyre përpilova edhe një rregullore të veçantë për Liceun e Korçës, sipas rregullores së shkollës së Stambollit "Gallata Saraj", në bazë të së cilës krijoheshin dy drejtori, drejtorja administrative dhe ajo teknike. Drejtori administrator do të ishte shqiptar, ndërsa ai teknik do të ishte francez... Në muajin shtator me bërjen e listave të personelit mësimor për tërë shkollat e mesme dhe fillore të Shqipërisë, vendosa të jap dorëheqjen. Arsytet ishin këto; vuaja shumë larg familjes, gruas dhe vajzës Meri... Arsyeja tjetër ishte kjo; herë pas here Ministria e Brendshme kërkonte të transferohej dhe të pushohej arsimtarë "për arsye administrative", gjithashtu deputetët kërkonin bursa për miqtë e tyre, pa paraqitur dokumenta relative, më*

detyronin më në fund të veproja kundër ndërgjegjes sime. Ju drejtova Koço Kottës, se ky ishte shkaktari dhe ju luta që të ndërhynte pranë presidentit që të largohesha nga Tirana dhe të transferohesha në Korçë, ose si drejtor administrativ i Liceut, ose si inspektor i Arsimit. Gjeta kundërshtim edhe nga presidenti edhe nga Këshilli i Ministrave... Por mbasi këmbëngula dhe deklarova se do të jap dorëheqjen, më emëruan drejtor administrativ në Liceun e Korçës⁹⁰.

Sotir Papahristo si drejtor i Liceut të Korçës dhe Institutit Femëror

Me emërimin e tij si drejtor administrativ në Liceun e Korçës fillon një faqe e re për këtë institucion. Nga një shkollë e mesme me shumë probleme ku profesorët dhe nxënësit ishin ndarë në parti kundërshtare, të cilat i kundërviheshin njëra-tjetrës, në kurriz të disiplinës dhe nivelit mësimor, ajo kthehet në një vatër arsimit me shumë rëndësi për vendin. Me mbërritjen e tij atje, pas largimit të drejtorit francez aktual të atëhershëm, mbas shumë përpjekjesh, legata shqiptare në Paris gjen një person mjaft të përshtatshëm për ta emëruar drejtor teknik në Liceun e Korçës, Bally Comte, i cili kishte qenë për shumë vjet në Rusi si profesor i djemve të Dukës së Madh, në oborrin e Carit. Tek ky profesor, S. Papahristoja gjeti një bashkëpunëtor të zellshëm dhe korrekt. Si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë të këtyre dy drejtorive, disiplina në Lice u forcua dhe u rrit dukshëm niveli i mësimdhënies me profesorë francezë dhe shqiptarë të përzgjedhur mirë. Kështu gjatë vitit shkollor 1929–1930, diploma e Liceut Frëng të Korçës u bë e barazvlefshme me të gjitha licetë e Francës në Europë dhe në botë. Ky eveniment kaq i rëndësishëm ndodhi pikërisht kur një nga profesorët e arkeologjisë, Merlier, u ndodh me mision në Athinë dhe me urdhër të Ministrisë së Arsimit të Francës, ai asistoi në provimet e maturës të Liceut të Korçës. Gjatë qëndrimit, ai vuri re se programi francez për shkollat e mesme ishte zbatuar me përpikmëri dhe se nxënësit ishin shumë mirë të përgatitur. Kështu ai dërgoi një raport pozitiv në Ministrinë e Arsimit të Francës

⁹⁰ Papahristo S, Autobiografi, fq 17, (dorëshkrim).

dhe ajo shpalli vendimin se Liceu i Korçës deklarohet ekuivalent me ata të Perëndimit. Në lidhje me këtë eveniment të rëndësishëm që ishte fryt edhe i kontributit të drejtorit administrativ të palodhur, S. Papahristoja shkruan në kujtimet e tij: *“Endrra e personelit mësimor, si dhe e shoqërisë korçare dhe shqiptare, u realizua, dhe pas kësaj, dyert e universiteteve të huaja u çelën për studentët shqiptarë”*⁹¹.

Emri i mirë që po linte në themelet e arsimit modern shqiptar S. Papahristoja, bën që atij t’i besohen gjithmonë detyrat më të rëndësishme dhe njëkohësisht më të vështira që kishin të bënin me arsimin kombëtar. Kështu në shtator të vitit 1933, Ministria e Arsimit e transferon në Tiranë, si Drejtor të Institutit Femëror “Nana Mbretëreshë”. Kryeministri i asaj kohe Pandeli Evangjeli së bashku me ministrin e atëhershëm të arsimit Mirash Ivanaj, këmbëngulin për emërimin e tij në postin e drejtorit të këtij instituti, pavarësisht refuzimit të përsëritur nga ana e S. Papahristos. Ngritja e kësaj shkolle me programe bashkëkohore dhe më pas me një infrastrukturë ndërtimore moderne për kohën, ishte në përgjithësi një meritë tjetër e këtij drejtuesi të palodhur dhe të ndërgjegjshëm, që me përkushtim dhe dashuri punoi në kushte dhe rrethana të vështira për arsimimin dhe fisnikërimin e popullit. Këtu ai do të qëndronte deri në maj të vitit 1939.

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, në kuadrin e frenimit të përgjithshëm të arsimit dhe kulturës kombëtare në vend, goditet dhe Instituti Femëror nëpërmjet transferimit të drejtorit të saj S. Papahristos në gjimnazin e Shkodrës, me urdhër të Ministrit të atëhershëm të arsimit Ernest Koliqit. Si argument i transferimit u paraqit fakti se nxënëset e institutit ishin patriotë dhe shfaqën hapur indinjatën e tyre për humbjen e pavarësisë së vendit dhe për këtë, shkaktar u konsiderua pikërisht drejtori. Në Shkodër, S. Papahristoja qëndron për një kohë të shkurtër dhe me hapjen e një vendi të lirë në gjimnazin e Tiranës, emërohet atje si mësues i greqishtes së vjetër.

⁹¹ Papahristo S, Autobiografi, fq 23, (dorëshkrim).

Aktiviteti i S. Papahristos si mësues pas 1944 dhe vlerësimet nga shteti

Me çlirimin e vendit, S. Papahristoja emërohet si pedagog në shkollën Femërore të Tiranës, ish-Instituti Femëror deri në vitin 1947. Me heqjen e lëndës së greqishtes së vjetër, nga programet e kësaj shkolle, për ironi të fatit, ai emërohet mësues në një nga shkollat filllore të Tiranës. Në tetor të vitit 1947 me vdekjen e djalit të tij, S. Papahristoja pëson një goditje të thellë shpirtërore. Duke mos mundur të punojë më në arsim, në janar të vitit 1948, zë punë me vështirësi, si përkthyes i greqishtes së vjetër në Institutin e Studimeve Shqiptare. Fillimisht përkthen tekste të historisë së vjetër greke dhe latine, në të cilat përmendet vendi ynë, për të vazhduar më pas me përkthimin e veprave të letërsisë së vjetër klasike greke. Në vitin 1953, transferohet në Ndërmarrjen e Botimeve “Naim Frashëri”, ku do të vazhdojë përkthimin e dramave klasike greke.

Puna e tij në arsim dhe në kulturë (kryesisht në përkthime), fillon të vlerësohet dhe në vitin 1962, ai dekorohet me “Urdhrin e Klasit të Parë” për kontributin e dhënë në arsim, ndërsa në vitin 1963, një komision i posaçëm i Ministrisë së Arsimit, duke çmuar punën e tij si përkthyes dhe shkrimtar i jep titullin “Kandidat i Shkencave Filologjike”. Në vitin 1964, transferohet në Fakultetin e Histori-Filologjisë, si bashkëpuntor shkencor, ku vazhdon deri në vitin 1968, kur del në pension.

Publicistika dhe kontribute të tjera

Gjatë viteve 1923–1924, Sotir Papahristoja ushtron një aktivitet të gjallë botues në shtypin e atëhershëm të qytetit të Korçës, ku sigurisht një pjesë e rëndësishme e artikujve të tij pasqyronin problemet e përgjithshme të sistemit arsimor në qytet. Si një intelektual me pjesëmarrje aktive, jo vetëm në jetën arsimore, por edhe në jetën social-kulturore të qytetit të Korçës, ai u përpoq të kontribuonte maksimalisht në të mirë të komunitetit. Në një artikull të botuar në “Gazeta Korça”, në vitin 1923, S. Papahristoja, duke folur për ndikimin e muzikës në shpirtin dhe karakterin e njeriut, theksonte

nevojën e një qyteti si Korça për të patur një orkestër simfonike.

Si njohës i thellë jo vetëm i letërsisë së vjetër helene, por edhe i mendimit filozofik dhe praktikizmit klasik grek, S. Papahristoja, gjatë kohës së qëndrimit të tij në Korçë, si inspektor dhe kryeinspektor i Ministrisë së Arsimit, zhvilloi një fushatë të gjerë informuese edhe mbi dobinë e gjimnastikës, nën moton “Mendje e shëndoshë në trup të shëndoshë”. Kështu, gjatë vitit 1923, ai boton shumë artikuj në gazetën “Shqiptari i Amerikës” dhe “Gazeta e Korçës”⁹², mbi dobitë e gjimnastikës dhe atletizmit dhe ngrinte si një nevojë imediate për të rinjtë e qytetit të Korçës, ndërtimin e një fushe sportive. Në këtë kuadër, në dhjetor të vitit 1924, ai boton edhe librin “Boiskautizma”⁹³, të anglezit Bade Pauell, themeluesit të boiskautizmit, duke përdorur për përkthim variantin e përkthyer në greqisht të këtij libri “Proskopoi” (Boiskaut). Botimi dhe qarkullimi i këtij libri pati një ndikim të madh tek rinia e qytetit të Korçës. Menjëherë mbas daljes në qarkullim dhe leximit të tij, u krijua shoqëria e boiskautistëve, e cila e përqëndroi veprimtarinë e saj kryesisht në stërvitjet e përditshme dhe ekskursionet. Më pas, ky libër u fut edhe si lëndë mësimi në programet e atëhershme të të gjitha shkollave të Shqipërisë dhe njohu katër ribotime. Në vitin 1924, ai përkthen nga greqishtja edhe një libër tjetër, “Mbi rritjen e foshnjës”⁹⁴ me këshilla praktike tepër të rëndësishme për mirërritjen e fëmijëve të vegjël, në një kohë kur mortaliteti foshnjor kishte arritur kulmin. Ky libër u botua me iniciativën e kryetarit të atëhershëm të Kryqit të Kuq dhe njëherazi kryetarit të bashkisë të qytetit të Korçës, Vasil Avramit dhe njohu tetë ribotime duke qarkulluar më pas në gjithë Shqipërinë, si një libër tepër i vlefshëm për nënat dhe dhe shërbimet sanitare.

Aktiviteti i Sotir Papahristos si përkthyes

Padyshim që Sotir Papahristoja mund të konsiderohet si përkthyesi i parë i përkushtuar i një pjese të madhe të pasurisë letrare të antikitetit

⁹² Gazeta e Korçës, 1923.

⁹³ Papahristo S., Boiskautizma, Korçë, 1924.

⁹⁴ Papahristo S., Mbi rritjen e Foshnjës, Korçë, 1924.

helen. Para tij ka patur iniciativa nga intelektualë të spikatur për përkthime të veprave të ndryshme të letërsisë antike greke, por askush nuk u angazhua me përkthimin e këtyre vlerave në atë shkallë si S. Papahristoja. Me përjashtim të veprave të Homerit, “Iliada” dhe “Odiseja”, që janë vepra më të hershme të shkruara në dialektin jonik, ai ka përkthyer vepra nga të gjithë poetët tragjikë të antikitetit grek, si: Eskili, Sofokliu, Euripidi, si dhe disa komedi të Aristofanit. Kështu, ai ka përkthyer shtatë tragjeditë e arritura të plota të Eskilit, prej të cilave janë botuar vetëm tre, dy tragjedi dhe një triologji, përkatësisht “Prometeu i Lidhur”, “Persët” dhe trilologjia “Orestia”, që përmbledh “Agamemnonin”, “Koeforet” dhe “Eumendimet”, pra kanë parë dritën e botimit gjithsej pesë tragjedi. Nga Sofokliu, ai ka përkthyer, gjithashtu, të shtata tragjeditë e arritura deri në ditët tona, prej të cilave janë botuar vetëm dy; “Antigoni” dhe “Elektra”. Nga 17 veprat e arritura të plota të Euripidit ka përkthyer gjashtë tragjedi; “Medea”, “Ipoliti”, “Hekuba”, “Andromaka”, “Ifigjenia në Aulidë” dhe “Ifigjenia në Taulidë”, nga të cilat janë botuar vetëm dy; “Medea” dhe “Ifigjenia në Aulidë”. Ndërsa nga 11 komeditë e arritura të plota të Aristofanit ka përkthyer katër komedi; “Pluti”, “Bretkosat”, “Retë” dhe “Akarnesit”, prej të cilave janë botuar vetëm dy; “Pluti” dhe “Bretkosat”. Gjithashtu S. Papahristoja ka përkthyer edhe veprën e mirënjohur “Poetika” (Peri Piseos) të Aristotelit, vepra këto të shkruara kryesisht në dialektin atik të Greqishtes së Vjetër. Në shënimet e lëna prej tij, të cilave u jemi referuar për të paraqitur këtë ekspozitë të veprave të përkthyer prej tij, S. Papahristoja shënon gjithashtu se të gjitha dramat dhe komeditë e përkthyer prej tij, të cilat nuk janë botuar, ndodhen në zyrën përkatëse të Ndërrmarjes së Botimeve “Naim Frashëri” në Tiranë.

S. Papahristoja, përktheu edhe veprën më të mirë të Tuqididit “Historia e Luftës së Peloponezit”, që është vepra historike më me vlerë dhe më e plotë e Antikitetit, ku përshkruhet lufta midis Athinës dhe Spartës, e cila filloi në vitin ‘31 para Krishtit dhe mbaroi në vitin ‘404, e shkruar edhe kjo në dialektin atik, si dhe “Jetë Paralele” të

Plutarkut. Teksti i pabotuar i “Luftës së Peloponezit” i Tuqididit, i cili pa dritën e botimit vetëm në vitin 2009, së bashku me “Jetë Paralele” të Plutarkut, ishin lënë të pabotuara në Institutin e Historisë dhe Gjuhësisë. Ai përktheu, gjithashtu, dhe një pjesë nga krijimtaria e filozofit të antikitetit Isokratit të titulluar “Këshilla për Demonikun”, si dhe “Fjalët e Urta” të Pitagorës. Një kontribut i rëndësishëm i tij ka qenë edhe hartimi i “Antologjisë së Prozës Greke”.

Punime tepër me vlerë për mësimdhënien e greqishtes së vjetër kanë qenë edhe tekstet në formë dispence “Gramatika e Greqishtes së Vjetër” dhe “Sintaksa e Greqishtes së Vjetër”, të profesor S. Papahristos, të botuara përkatësisht në vitet 1940 dhe 1942, të cilat u kanë shërbyer fillimisht studentëve të Gjimnazit të Tiranës për mësimin e greqishtes së vjetër.

Përkthime dhe kontribute në fushën e religjionit

Sotir Papahristoja, një njeri me formim klasik, ka qenë jo vetëm një besimtar i devotshëm, por edhe mjaft aktiv në kontributin e tij në dobi të Kishës Ortodokse. Pothuajse të gjithë bashkëkohësit që kanë shkruar për të, kanë konstatuar se ai ka qenë një njeri i përkorë, tejet i ndërgjegjshëm dhe me një përkushtim të pazakontë dhe plot profesionalizëm në të gjitha fushat ku kontribuoi. Këto veti të karakterit të tij ishin kosequencë edhe e një besimi real të madh që e karakterizoi S. Papahriston gjatë gjithë jetës së tij. Pa dyshim që një njeri i tillë do linte gjurmën e tij edhe brenda religjionit ortodoks, kontribut që lidhet kryesisht me pjesëmarrjen e tij aktive që në numrin e parë të revistës presligjioze “Jeta Kristiane”, botim i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, ku ai botonte me pseudonimin “Shpresëtari”. Qysh nga marsi i vitit 1940, kur ai e inaguroi këtë periodik me artikullin e tij të parë, deri në nëntor të vitit 1944, kur kjo revistë u mbyll⁹⁵, ai ka qenë bashkëpunëtor i rregullt i saj me artikuj të ndryshëm kryesisht të natyrës apologjitike.

Përveç artikujve të shumtë, S.Papahristoja ka përkthyer dhe disa libra me karakter fetar si: “Ora e Shpirtit”, “Mjeku i Izraelit”, “I Biri i

⁹⁵ Jeta Kristiane, 1940 – 1944, Tiranë

Shtëpisë së Davidit”, si dhe shumë pjesë nga veprat e Shën Joan Gojëartit. Profesor Sotir Papahristoja ka qenë, gjithashtu, pedagog në Seminarin Kombëtar Orthodhoks “Apostull Pavli”, në Tiranë dhe për disa kohë zvendësjohës i tij⁹⁶.

Vlerësime ndër vite, për figurën e S. Papahristos

Siç është përmendur dhe nga disa studiues që janë marrë me aktivitetin e tij, personaliteti dhe vepra e Sotir Papahristos zë një vend të nderuar në historinë e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar.⁹⁷

Breza të tërë nxënësish, shumë prej të cilëve u bënë më vonë intelektualë të shquar dhe personalitete në fusha të ndryshme, ushqyhen një nderim dhe vlerësim të veçantë për punën e tij. Kështu, një ish-nxënës i tij shprehet: *“Profesor Sotir Papahristo, pedagog i klasit të parë, mësues i vërtetë, i cili i kishte caktuar vetes si mision që nëpërmjet shkollës të formonte njerëz të pjekur, siç kishte dëshiruar edhe Viktor Hygoi një shekull më parë. Njohës i mirë i kulturës klasike greko – romake, me një ndershmëri të rrallë, me përpikmëri në punë, ndoshta të panjohur në atë kohë në administratën e ngathët edhe në shkollën tonë, ai ishte sa i çiltër aq dhe i edukuar, duke merituar respektin e të gjithëve. Me dashamirësi ai u dha nxënësve të kuptonin se jeta është punë dhe se gëzimet vijnë më pas, se dituria fitohet vetëm me këmbëngulje dhe edukimi i vërtetë moral ishte për të kulmi i qytetërimit. Për Papahriston, si dhe disa të tjerë para tij, pa lashtësinë greko-romake, humanizmi, rilindja dhe iluminizmi do ishin pa themel. Ai u qëndronte besnik ligjeve në fuqi dhe mbi të gjitha ndërgjegjes morale. Nga kjo pikëpamje ai u ngjante të krishterëve të lashtë, që besonin çiltërsisht dhe predikonin duke u qëndruar besnikë, pa frikë e pa njollë mësuesve të tyre...”*⁹⁸.

Por, edhe personalitete të shkencës dhe kulturës e kanë vlerësuar aktivitetin e tij. Kështu, Eqrem Çabej e quan punën e tij në fushën

⁹⁶ Beduli K., Shkollat Teologjike – Hieratike, Neraida, 2002

⁹⁷ Temo S, Buletin Shkencor, fq. 14, Korçë, 2008

⁹⁸ Xoxi Koli, Liceu Kombëtar i Korçës, 1999

pedagogjike dhe letrare, punën e një humanisti të vërtetë⁹⁹, Llazar Siliqi e quan mësues të shquar dhe përkthyes të palodhur të letërsisë antike greke¹⁰⁰. Tepër domethënës është portretizimi që i bën S. Papahristos arkitekti dhe intelektual i mirënjohur Petraq Kolevica në librin e tij “Lasgushi më ka thënë”, ku shkruan: “... *Sa madhështore dhe sa e shndritshme bëhej ajo dhomë kur rastiste të vinte aty plaku i urtë, patriarku i pedagogëve të Shqipërisë, profesor S. Papahristo, që sillte me vete të gjallë, të tërë botën e bukur dhe heroike të lashtësisë greke.*”¹⁰¹

Si përfundim do të thoshim se Sotir Papahristoja ka qenë një intelektual i mirëfilltë me kontribut të madh dhe të vlefshëm në fushën e arsimit, si një ndër themeluesit më të spikatur të Drejtorisë së Arsimit Kombëtar, programeve mësimore dhe shkollave më të rëndësishme të vendit, në fushën e pedagogjisë, si një pedagog shembullor dhe i suksesshëm në të gjitha shkollat që drejtoi dhe dha mësim, si dhe nëpërmjet botimeve të materialeve didaktike dhe pedagogjike, në fushën e përkthimit, me përkthimet e para të poetëve të parë tragjikë helenë dhe historianëve të antikitetit, prej të cilave nuk u nda deri në ditën e fundit të jetës së tij, 21. 09. 1979¹⁰², kur ai kaloi në një dimension tjetër.

Gjithashtu, gjatë gjithë kohës ai mbeti një bashkëshort i përkushtuar dhe një baba i dhembshur, shembull i qytetarit, familjarit dhe edukatorit korrekt dhe të përkushtuar.

Literaturë:

- Papahristo S., Autobiografi, (dorëshkrim).
- Papahristo S., Boiskautizma, Korçë, 1924.
- Papahristo S., Mbi rritjen e Foshnjës, Korçë, 1924.
- Jeta Kristiane, 1940 – 1944, Tiranë.
- Gazeta e Korçës, 1923.

⁹⁹ Çabej E., Gazeta Mësuesi, 3 tetor, 1979

¹⁰⁰ Siliqi Ll, Gazeta Drita, 7 tetor, 1979

¹⁰¹ Kolevica P., Lasgushi më ka thënë, fq. 6, Tiranë, 1992

¹⁰² Fjalori Enciklopedik Shqiptar, fq. 794, Tiranë, 1985

- Beduli K. “Mësues i mësuesve dhe helenist i shquar. Sotir Papahristo”, Tempulli 9, Korçë, 2004.
- Temo S, Buletin shkencor, Korçë, 2008.
- Xoxi K. Liceu Kombëtar i Korçës, 1999.
- Çabej E., Gazeta Mësuesi, 1979.
- Siliqi Ll, Gazeta Drita, 1979.
- Kolevica P, Lasgushi më ka thënë, fq. 6, Tiranë, 1992.
- Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985.

MAJLINDA BUSHAJ
Universiteti i Shkodrës
bushajmajlinda@gmail.com

VEÇORI SINTAKSORE NË SHKRIMET ORIGJINALE TË SOTIR PAPAHRISTOS

Veprat e autorëve, bëhen objekt studimi për gjuhësinë, për vetë vlerat që ato sjellin në këtë fushë. Ato dokumentojnë gjuhën e një epoqe të caktuar, të një komuniteti gjuhësor të caktuar, prandaj janë të dobishme për të studiuar historinë e gjuhës, veçoritë fonetike, morfologjike dhe sintaksore në raport me gjuhën letrare apo me atë të kohës kur janë shkruar. Në këtë artikull do të paraqes disa nga tiparet më të spikatura në fushën e sintaksës në shkrimet origjinale të Sotir Papahristos.

Këtu jam ndalur në disa veçori tipike të strukturës sintaksore të shkrimeve origjinale të Sotir Papahristos si: *Qeverimi i fëmijvet në shkollë*, Tiranë, 1929; *Mësime shëmbëllore për disa nga lëndat kryesore që mësohen në shkollat fillore dhe të mesme*, Korçë, 1930; *Ushtrimet gjuhore dhe Hartimet në shkollat fillore dhe të mesme*, Tiranë, 1938. Në këto vepra ai trajton probleme të arsimit, të mësimdhënies, modele të sjelljes së mësuesit, ushtrime të ndryshme gjuhësore etj. Një ndër tiparet kryesore që bën që mendimi të rrjedhë lirshëm, që argumentet të ndjekin njëra-tjetrën janë strukturat e tekstit. Në gjuhën e tij ndeshim sinonime, përdorime përemrash për rimarrjen e fjalëve etj.

Përpara se të trajtoj veçoritë gjuhësore sintaksore, po ndalem shkurtimisht në disa dukuri gjuhësore të veprës së Papahristos, që nuk janë bërë objekt studimi.

Pjesa më e madhe e dukurive gjuhësore në këtë vepër janë në variantin dialektor të toskërishtes. Shembuj të tillë dalin: Mbaresa trajtëformuese për emrat/mbiemrat prejfoljor *-onjës*, në vend të *-ues*: *mësonjës*, *këndonjës* etj.

*Mësonjësi formon fraza të plota dhe fjali të vogla, dhe nxënësit thonë se në ç'rasë duhen vënë. (Ushtrimet gjuhore, f. 9). Se si duhet bërë shpjegimi i fjalëvet dhe si duhet gjetur kuptimi i brendisë, munt të shohë **këndonjësi** në mësimet shëmbullore të këndimevet; (Ushtrime gjuhore, f.1). Kështu pra në qoftë se në skemën e trajtesës **provonjëse** shtojmëedhe shpjegimin, do të kemi skemën që munt të ketë trajtesa **shpjegonjëse** dhe **vepronjëse**. (Ushtrimet, f.132).*

Shurdhimi i bashtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës: **funt, heth, zgjeth, lark** etj.

*Më në **funt** zbret mësonjësi prej vëndit ku qëndron dhe **heth** nga një vështrim të shpejtë nëpër radhonjt' e nxënësve, me qëllim që të shohë në se u ndreqnë gabimet nga të gjithë nxënësit. (Ushtrimet, f.13).*

Përsa i përket zgjedhjes midis **ë-së** dhe **e-së** në fjalët kur këto zanore ndiqen nga një sonante hundore ai parapëlqen në shumicën e rasteve **ë-në**: **vëndit, vëmëndja, gjëndje, shënjtë, dëndur, shëmbëll** etj.

Përdorimi i **ë-së** me tepri: *Nuk duhet të ngutemi në gjykimet e në vendimet t'ona; duhet të jemi të mbajtur; pse shpresa që bazohet në gjykime e vendime të ngutëshme, mund të na shpjerë në veprime të dëmëshme e të rrezikëshme. (Ushtrime, f.126).*

Një tipar që bie në sy është asimilimi i grupeve të bashkëtingëlloreve në disa raste: **mi, miemrat, përmi** etj.

*Këtu mbarojmë fjalën **mi** ushtrimet me shkrim dhe **mi** hartime në shkollat filllore e të mesme. (Ushtrimet, f.157).*

Përdor disa fjalë të huaja me **ll** në vend të **l** si: **diallogu, katallogun, epillogu, skandalloze, pllane** etj.

*Në këtë mënyrë bëhet një lloj **diallogu** e bisedimi të shkurtër, nga i cili del se si duhet shkrojtur fraza. (Ushtrime, f.16). Këtu do të përpiqemi të paraqesim disa shëmbëlla dhe **pllane** karakterizmash, që t'i ketë mësonjësi parasysh, sa herë që meret me këtë lloj hartimi. (Ushtrime, f.100).*

Th në vend të **t**: **ethike, teori**: *Këto udhëzime, nuk duhet të konsiderohen si pemë e një pune thjesht **theorike** dhe si përfundime*

studimesh të bëra në **theori** vetëm e jashtë shkollës. (Ushtrime, f.157).

Shumë fjalë që në shqipen letrare janë pranuar të shkruhen me **rr** te Papahristoja i ndeshim të shkruara më r si: *drasën e zezë* etj.

Përdorimi i **ç**-së në vend të **zh**-së, ose **sh**-së. *Këtu ve para syvet të tij sendin që ka për të çvilluar, e shëkon dhe e kqyrë nga tërë anët, përpiqet të gjejë e të kapë idenë kryesore, mundohet të hyjë mbrenda në shpirtin e tij dhe t'a çfaqë me shkrim ashtu siç është e.t.j.* (Ushtrime, f.20).

Përdoret **gj**-ja në vend të **g**-së: *Në krye të lutjes pa si lihet një vënd prej dy ose tre **gj**ishtrinjs, shkruhet drejtimi me titullin e personit, të cilit i drejtohet; pas kësaj lihet prapë një vijë pa shkrojtur dhe fillon lutja.* (Ushtrime, f.95).

Përdorimi i **j**-së: *historija, gjeografija etj. **Gjeografija** e cila gjer atëhere ishte një shkencë po thuaj se e pa njojtur, përparoi shumë.* (Ushtrime, f.129).

Pjesëza **duke** e përcjellores ndeshet në shumicën e rasteve me **y: dyke**.

*Siç dihet çdo maqinë përbëhet prej pjesash e veglash të ndryshme, të cilat e **dyke** u lidhur mirë njëra me tjetrën, e venë në lëvizje maqinën.* (Ushtrime, 87).

Përemrin vetvetor **vetja, vetes, vetes** e shkruan me **h:vehtja**.

*Në i kryen detyrat e tij kundrejt Zotit **vehthes** së tij, familjes atdheut dhe njerësisë përgjithësisht.* (Ushtrime, f.90). *Zakonisht nuk njohim **vehthen** t'onë; kemi një mendim më të lartër për **vehthe**, dhe kur është puna të gjykojmë të tjerët, jemi të rrepët, (ose: merremi me çështje të tjera dhe nuk duam të kqyrim **vehthen** t'onë...).* (Ushtrime, f.118).

Ndikimi i dialekteve dhe i të folmeve dialektore ndeshet në sistemin e strukturës gramatikore. Në mjaft raste përdor trajta dialektore:

Folja **them** përdoret në trajtën **thom**: *Thuajmë se me ç'njerës vete që të të **thom** se cili je.* (Ushtrime, f.71). *Gjurmat që la fenomeni dhe përfundimet e mira ose të liga edhe për vëndësit, ku **ngjavi**, edhe nga pikëpamja e përgjithëshme.* (Ushtrime, f.91). *Vazhdoi të **thresë** gjersa*

erdhi e ëma. (Ushtrime, f.45).

Përdorimi i emrave prejfoljorë: *të folurit, të shkrojturit* etj.

Siç dihet, qëllimi i mësimit të gjuhës amtare në shkollat është ky: të bëhet i zoti nxënësi, që t'a përdorë mirë gjuhën si nëtë folurit, ashtu edhe nëtë shkrojturit. (Ushtrime, f.5). *Këtë dobi mund t'a sjellë hartimi, vetëm në qoftëse bëhet ashtu si duhet; për kundrazi, hartimet që jepen pa nonjë kujdesje e një përgatitje të veçantë, si në të zgjedhurit të lëndës, ashtu edhe në të stërviturit e nxënësve e në të ndrequrit të gabimeve, hartime të tilla nuk është e mundur të sigurojnë përfundime të mira.* (Ushtrime, f. 21).

Ndeshim dukurinë e ndërrimit të gjinisë të disa emrave të gjinisë mashkullore. Emrat që mbarojnë me **-e** dhe **-ra**, ai do t'i shoqërojë me mbiemra femërorë: *mësimet shëmbullore* të këndimeve etj, por ka në përdorimin e këtyre formave ka edhe ndonjë lëkundje.

Raste të tjera të formimit të shumësit: *Kështu pra edhe në punën e rrëfenjës duhet t'u tregojë nxënësve se ç' virtuta lypset të ketë kjo, që të bëhet ashtu si duhet.* (Ushtrime, f.76).

Përsa i përket formave rasore ai Papahristoja përdor rregullisht trajtat me fundoren-**t** të gjinore-dhanores. *Edhe shumica e urdhërave është një gjë e dëmshme.* (Qeverimi, f.140).

Hartimi, si kundër dihet, është një nga degët e mësimit të gjuhës; prandaj nota e këtij mësimi duhet shënuar në katallogun e notave të përditëshme, bashkë me notat e degave tjera (gramatikë, sintaksë...) të mësimit të gjuhës. (Ushtrime, f.155).

Në sistemin e përemrave ka pak dallime me gjuhën e sotme. Ashtu si shkrimtarët jugorë pararendës Papahristoja përdor si përemër vetor-dëftor **ay** pa u lëkundur. Dëftorët kanë një përdorim sistematik dhe të rregullt. Përemrat lidhorë ndeshen në format **të cillat, qi**, por edhe në formën e gjuhës letrare.

Është vënë re se mësonjësi q'ë ka këtë talent dhe s'ka aqë dituni e mësim, punon më mirë, sesa ay q'është i mbaruar nga mësimi, po s'ka talent didaktik. (Qeverimi, f.49). *Përshkrimi i kafshëve është m'i rëndë se ay i bimëve; sepse ato kanë edhe organizmë më të*

komplikuar edhe disa cilësi shpirtnore. (Ushtrime, f.88). Siç dihet, çdo person, për veç cilësivet që ka të njejta me tërë njerzit e tjerë, ka edhe disa të tilla të veçanta, me të cillat dallohet nga të tjerët. (Ushtrime, f.24).

Shkrimet e Sotir Papahristos karakterizohet nga një larmi e madhe e llojeve të fjalive. Ato më të përdorurat janë: fjalitë e thjeshta, të përbëra, asindetike, me bashkërenditje, me nënrenditje si edhe të përziera. Mbizotërojnë fjalitë me bashkërenditje dhe ato me asindetizëm dhe bashkërenditje krahas periudhave me nënrenditje.

Në nivelin e periudhës vihen re fraza me ndërtime komplekse, duke u ndërthurur nën-renditja, me bashkërenditjen lidhëzore e me atë palidhëzore dhe me një zgjerim të brendshëm të fjalive nga gjymtyrë të llojeve të ndryshme. Ky strukturim ka ndihmuar në dhënien e e një kumtimi të pasur:

Për t'i dhënë frazës një karakter sa më të ngjeshur dhe një lëvizje të ngadalësuar, autori përdor edhe format e pashtjelluara të foljes në pozicione të ndryshme të foljes:

*Le të mundohet pra me shëmbëllin e tij t'u mësojë nxënësve këto virtyta; të jetë d.m.th. i rregullshëm më çdo punë shkollare: **Dyke ardhur** në shkollë n'orën e caktuar, **dyke hyrë dyke dalë** prej klasës n'oret e caktuara, **dyke u n-dark** nxënësve radhonjt' e shkrimit në ditën e caktuar, **dyke pregatitur** mirë detyrat që do t'u japë nxënësve e.t.j.; të jetë i drejtë më tërë punët e tij shkollare: **dyke zbatuar** me drejtësi masat qeverimtare, **dyke vënë** notat e mësimeve dhe të detyravet me drejtësi e me paanësi e.t.j. e.t.j. (Qeverimi, f.119). Që të mos e pësojë këtë mësonjësi, duhet të veprojë në këtë mënyrë: ato nga punët e shkrimit ose të vizatimit që janë të gjata dhe që kërkojnë një kohë të gjatë, t'i shkruajë në drasën e zezë mësonjësi vetë n'orët e prehjevet dhe **pa filluar** mësimi; **dyke vepruar** kështu, n'orën e mësimi punën që ka **për t'u shpjeguar** dhe **për t'u çvilluar** nxënësve, do ta ketë gati, dhe kështu nuk do të jetë i shtërnguar të zbrësë nga vendi prej të cilit i mbiqyr nxënësit. (Qeverimi, f.126). Fqinjët **me të dëgjuar** zërin e lartër të gruas u sulnë n'oborrin e shtëpisë dhe panë*

dy njerës të shtrirë n'oborr. (Ushtrime, f.46).

Në shkrimet e Papahristos përcjellorja pohore del edhe në trajtën mohore, që formohet duke i shtuar pohores pjesëzën e mohimit **mos** midis dy elementeve të saj. Përcjellorja me pjesëzën **mos** mund të quhej përcjellorja pohore mohore.¹⁰³ Përcjellorja me pjesëzën **moszëvëndëson** në shumicën dërrmuese të funksioneve përcjelloren mohore të trajtës *pa punuar*, por përdoret më pak se përcjellorja mohore.

Për kundrazi, kur mësonjësi e bën pyetjen përgjithësisht dhe dykemos caktuar nxënësit, ahëre tërë nxënësit duke mos ditur se kujt i drejtohet pyetja dhe dyke pandehur se sicili nga ata munt të thritet të japë përgjigjen, do t'a kenë mëndjën n'ato që pyet mësonjësi dhe kështu, dyke u-marrë me mësimin, nuk do të kenë kohë të merren me gjësend tjetër. (Qeverimi, f.32).

Ndeshim **gerundin e kohës** i cili shoqërohet shpesh me një emër a një përemër në rasën emërore në pozicion të kryefjalës e të vendosur rregullisht pas tij. Emrat mund të jenë të përgjithshëm a të përveçëm.

Me të zënë mësonjësi vëndin e tij, nxënësit duhet t'i këthejnë sytë tek ay dhe duart t'i venë për mi bankot. (Qeverimi, f.128).

Në veprën e tij vërehet edhe prania e fjalive të thjeshta, të qarta, të rrjedhshme, me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Ka një denduri të përdorimit fjalive pyetëse apo të fjalive të pyetjes retorike që karakterizohen nga një përbërje leksikore e veçantë, si pasthirrma, fjalë pyetëse, fjalë thirrmore etj. Fjalitë pyetëse të mirëfillta apo jo të mirëfillta, përdoren për të pyetur, për të tërhequr vëmendjen, për të pohuar a mohuar diçka me forcë të veçantë. Fjalitë pyetëse i gjejmë të përdorura edhe për të shprehur nxitje për veprim apo ndonjë reagim afektiv, si: pakënaqësi, habi, kundërshti, zemëratë.

Me gjithë këtë, sa prej nesh interesohen që të kërkojnë informata për cilësinë t'edukatorëve të fëmijvet të tyre? A pyesin nonjë herë ç'dituri ka mësonjësi i bijëve të tyre, ç'moral, ç'karakter e ç'zotësi?

¹⁰³ Mehmet Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2000, f. 163.

(Qeverimi, f.76).

Përdorimi i dendur i **gjymtyrëve homogjene** me bashkim asindetik dhe lidhëzor është karakteristikë e ligjërimit të tij. Në shkrimet e tij përdoren dendur kallëzues dhe kundrina homogjene, por edhe kryefjalë të tilla, të cilat i japin gjuhës një ritëm të ngadalësuar.

Ja disa raste të përdorimeve të gjymtyrëve homogjene:

- **Kundrinorë homogjenë:** *Qëllimi i miqyrjes është ky, të mos i japë nxënësit rast të lëvizë e të lozë në mënyrë që të prishqetësin' e rrëgullin e klasës për dëm të mësimit.* (Qeverimi, f.123).

- **Kryefjalë homogjene:** *Është e ditur se sa fuqi ka interesi e dëshira për një gjë; kur nxënësi ka interes për një mësim, tërë kujdesin' e tij do t'a kthejë në këtë mësim, tërë fuqitë e tij do t'i përmbledhë, që të mund ta njohë e ta mësojë më mirë mësimin.* (Mësime, f.121).

- **Kallëzues homogjenë:** *Është vënë re, se nxënësit kur kuptojnë se miqyren prej mësonjësit dhe se nuk shpëtojnë nga syri i tij, nuk kanë përgjithësisht kuxim që të lëvizin, të lozin e të ngasin njëri tjetrin.* (Qeverimi, f.124).

- **Rrethanorë homogjenë:** *Le të shohim tashi se ç'rroll historik ka lojtur Italia në kohët e vjetra, në kohën e mesme, në kohën e re dhe në kohën e sotme.* (Mësime, f.63).

- **Fjali të nënrenditura homogjene:** *Kur nxënësi vjen në shkollë n'orën e caktuar, // kur i kryen me rregull detyrat // q'i ngarkohen prej mësonjësit, // kur nuk prish qetësinë e shkollës dhe të dhomës së mësimit, // kur çfaqet në shkollë gjithmonë i pastër nga trupi dhe nga rrobat; // kur nuk i sjell mësonjësit pengime në të kryerit të detyrës; // kur nuk përdor fjalë të liga kundër shokëve të tij; me një fjalë kur sillet dhe vepëron ashtu siç deshiron dhe siç e porosit mësonjësi i tij, aherë thomi se në këtë shkollë mbretëron një qeverim i mirë.* (Qeverimi, f.7).

- *E stërvit nxënësin: t'u bindet porosiravet dhe urdhëravet të mësonjësit, // t'a kryejë detyrën me kujdes e me rregull, // të jetë i*

pastër nga trupi, // të mos prishë qetësinë e shkollës, // të mos i sjellë mësonjësit pengime si mbrenda, si jashtë klasësetj. (Qeverimi, f.8) etj.

Asindetizmi është një dukuri tjetër sintaksore, karakteristike për gjuhën e folur, del i përdorur edhe në këtë vepër. Fjalitë asindetike dalin në përbërje të periudhave me bashkërenditje, por ka edhe raste që dalin në tipa të përzier.

Përhapet shpejt në për të gjithë, // përndan kënaqësi, gëzim, dhe entuziazëm, tërheq, // ndihmon në të punuarit, // ndihmon në të jetuarit. (Qeverimi, f.140).

Fjalitë pa folje. Ka raste që ndonjë fjali në të cilën shprehen marrëdhënie të ndryshme, del eliptike, me mungesë të foljeve. Një formë e tillë e zhdërvjelltëson e bën mesazhin më të ngjeshur. Në këto fjali folja nuk shprehet ose për arsye të kontekstit, ose situata e bën të panevojshme. Këto fjali shfaqin një larmi strukturash: me sintagma emërore, mbiemërore, ndajfoljore, parafjalore në funksion të gjymtyrëve të ndryshme, të kryefjalës, të rrethanorëve, të kundrinorëve etj.

Mësim shëmbëllor për Arithmetikën në klasën e parë të shkollave fillore. (Mësime, f.20). *Një ditë nga pushimet e mbëdha.* (Ushtrime, f.81).

Në stilin e letërsisë artistike është e njohur dukuria e **daljes së fjalive të nënrenditura më vete**, të shkëputura nga fjalia kryesore. Këtë mënyrë shprehjeje e përdorin shumë autorë. Te Papahristoja kjo dukuri është e shpeshtë. Nga pikëpamja stilistikore, kjo është një mënyrë për të paraqitur një stil elegant, duke iu shmangur frazave të gjata të cilat mund të sjellin edhe errësim të kuptimit. Nga ana tjetër kjo bëhet për arsye të aktualizimit të frazës, në përputhje me synimin e komunikimit. Duke dalë më vete, fjalia e nënrenditur theksohet më shumë nga çdo të theksohej po të ishte në përbërje të fjalisë kryesore. Te ky autor më shumë dalin fjalitë e nënrenditura shkakore, por edhe tipat e tjerë si: kushtoret, lejoret etj. Edhe pjesa e dytë e fjalive me bashkërenditje delmë vete. Atomund të jenë të thjeshta ose të

zgjeruara me fjali të tjera.

***Siç** dihet, era e pastër është një nga më të mirët faktorë për sigurimin e shëndetit të trupit të njeriut. **Prandaj** një nga kërkimet kryesore të shëndetsisë, është, që ndërtesa e banimit të jetë ngrehurnë mënyrë që të mund të hyjë era e pastër sa më shumë. **Në qoftë** seký kërkim është i nevojshëm për çdo ndërtesë, për shkollën është një nga konditat e domosdoshme. **Sepse** këtu një numër i math fëmijsh qëndron i mbyllur mjaft kohë po n'atë vënt; kështu era e dhomës, në qoftë se s'merrët kujdes të ndërrohet shpesh herë, mbushet me asid karbonik, i cili është e dëmshëm për shëndetin e fëmijvet. (Qeverimi, f.20).*

Përdorim të gjerë marrin fjalët dhe **togjet e fjalëve të ndërmjetme** të cilat i japin kuptime plotësuese frazës, shprehin sigurinë, pasigurinë, dyshimin, rëndësi të faktit, lidhje mendimesh, burimin e informacionit etj. Më të përdorshme te Papatristoja janë: *përgjithësisht, kështu pra, përkundrazi, me fjalë të tjera, bile, siç dihet, d.m.th., përgjithësisht, përveç kësaj, përshembull, sigurisht, përndryshe d.m.th., sidomos, d.m.th. me një fjalë, pik së pari, sikundër, d.m.th. etj.*

***Me fjalë të tjera**, pas si përshkruhet mirë shëlgju, përshkruhen shkurtazi dhe tërë ose disa nga sendet që ndodhen rrotull tij. (Ushtrime, f. 54). **Siç dihet**, era e pastër është një nga më të mirët faktorë për sigurimin e shëndetit të trupit të njeriut. (Qeverimi, f.20). **Siç kuptohet**, mënyra e ndreqjes q'u përshkrua këtu sipër, ka këto të mira (Ushtrime, f.17). **Pik së pari** mësonjësi duhet të ketë talent didaktik; duhet **d.m.th.** të jetë, **siç thomi**, i lindur për këtë punë, të ndiejë një prirje prej natyrepër këtë punë dh eta zgjedhë detyrën e mësonjësisëvetëm e vetëm prej kësaj prirjes dhe jo prej arsyesh të tjera. (Qeverimi, f.48).*

Në gjuhën e tij ndeshim fjalë e togje të ndërmjetme që tregojnë vlerësimin emocional të kumtimit, shprehin gëzim, kënaqësi hidhërim, pikëllim, keqardhje, habi etj.

*Para se të bëjmë fjalë për mënyrat, të cilat duhet të përdorë qeverimi, do të jetë mirë të hedhim një sy mi masat që përdorëshin një kohë dhe përdoren **mjerisht** edhe sot për të siguruar qeverimin e shkollavet. (Qeverimi, f.11).*

Ka raste që në të njëjtën fjali përdoren pranë njëra-tjetrës dy fjalë të ndërmjetme. Këto mund të shprehin nuanca të ndryshme kuptimore ose mund të kenë të njëjtin kuptim.

***D.m. th. me një fjalë**, shumë herë këshillet dhe porosirat të një mësonjësi të tillë(të sëmure nga trupi), nuk do të pajtohen me veprat e tij, po do të janë në kundërshtim me ato. (Qeverimi, f.47). **Për ndryshe, d.m.th.** kur pyetja i drejtohet një nxënësi të caktuar, aherë nxënësit e tjerë nuk do të merren me pyetjen të vënë prej mësonjësit, por do të merren me lëvizje dhe me pëshpëritje në dëm të qeverimit.(Qeverimi, f.31).*

Në shkrimet e tij ndeshim fjalë e togje të ndërmjetme që janë karakteristike për gjuhën letrare, por nuk mungojnë edhe ato me karakter popullor.

*Në kohët e fundit **bile** lindi dhe shkencë e veçantë, e cila u qoft “Pedologjia”, dhe e cilaka për qëllim të studiojenga terë pikëpamjet fëmijit dhe të mund të japë një pasqyrë të gjendjes së tyre shpirtnore, trupore dhe morale. (Qeverimi, f.2).*

Përsëritja në përgjithësi është karakteristikë stilistikore e shkrimeve të Papahristos. Përsëriten kryesisht emra, mbiemra, folje, lidhëza, ndajfolje etj.

***Dielli**, siç dihet, ka një fuqi shëronjëse shumë të madhe, shumë sëmundje shërohen vetëm meanën e kësaj fuqje të **diellit**. **Dhomat** të cilat i shëkon **dielli**, janë krejt të shëndetëshme, sepse **dielli** çduk dhe çfaros mikrobet që munt të ndodhen mbrenda në **dhomë**; përveç kësaj edhe lagështinë që është një nga armiqtë më të mëdhënj të shëndetit të njeriut, e dbon prej **dhomës**. (Qeverimi, f.22).*

Veçimi i gjymtyrëve është një tipar i stilit të tij. Me anë të veçimit të gjymtyrëve të dyta në ballë, në mes dhe në fund të fjalisë autori ka mundur të shprehë ngjyresa të mendimit nga më të hollat,

duke e ngjeshur frazën me ide dhe duke i dhënë fjalisë formën e duhur.

*Qëllimi i përshkrimit është t'i japë këndonjësit një ide tepër të qartë të sendit që përshkruhet; përshkronjësi d.m.th. duhet t'a paraqitë sendin kështu, që këndonjësi, **duke kënduar**, të mundë të rëfejë parafytyrimet e sendit e t'i futë dhe t'i rreshtojë mirë në shpirtin e tij, në mënyrë që të formohet në shpirt fytyra e sendit e qartë dhe e gjallë. (Ushtrime, f.23). Fëmijët, **edhe ata më të vegjlit**, kanë një dëshirë të madhe të dëgjojnë rëfenja nga të tjerët; gjithashtu edhe ata vetë u tregojnë të tjerëve të tilla. (Ushtrime, f.22).*

Ndërfutja e njësive të ndryshme frazore është një element tjetër i dukshëm i Papahristos. Këto njësi vendosen mes kllapave për të dhënë sqarime që u mbishtohen përbërësve të fjalisë për të dhënë informacion plotësues, për të shpjeguar më mirë atë që kumton. Si të ndërfutura dalin të gjitha llojet e frazave. Kjo është një mënyrë që e bën lexuesin më të qartë në atë që kumton autori.

Nevojat e trupit të fëmijvet që zëmë në gojë më sipër (d.m.th. nevoja e tyre për lëvizje, për temperaturë të rregullshme, për erë, për dritë e për diell, si dhe për bango të posaçme) dhe çdo tjetër nevojë që munt të ketë trupi i tyre, tërë këto nevoja duhet t'i plotësojë mësonjësi medoemos. (Qeverimi, f.24). Një zotësi e këtillë ka lidhje së pari me talentin e djalit; (disa fëmijë kanë prej natyre dhuratën që të çfaqin një send me gjallësi e me një bukuri, disa prapë nuk e kanë këtë dhuratë); pastaj ka lidhje me dijenit' e nxënësit, i cili sa më tepër këndon aqë më shumë figura dhe mënyra fiton. (Ushtrime, f.46).

Për të shprehur raporte të caktuara sintaksore në mënyrë më të qartë Papahristoja ka përdorur një sërë lokucionesh parafjalore e lidhëzore të reja si: *në mënyrë që, për shkakun se, nga shkakun se, përveç që etj.*

Rëfenja fantastike nuk ka tjetër qëllim, për veç që të çvillojë no një parim e aksiomë morale, ose të tregojë zakone të një periudhe, e gjendje të ndryshme të jetës së njeriut. (Ushtrime, f. 22). Qëllimi i përshkrimit është t'i japë këndonjësit një ide tepër të qartë të sendit

që përshkruhet; përshkronjësi d.m.th. duhet t'a paraqitë sendin kështu, që këndonjësi, duke kënduar, të mundë të rëfejë parafytyrimet e sendit e t'i futë dhe t'i rreshtojë mirë në shpirtin e tij, **në mënyrë që** të formohet në shpirt fytyra e sendit e qartë dhe e gjallë. (Ushtrime, f.23). Nxënësi nuk duhet të besojë, se e sigurovi kalimin e klasës, **nga shkaku se një ose dy herë e tha mirë mësimin**. (Ushtrime, f.125).

Po ndalem në disa nga **tiparet e fjalive të bashkërenditura dhe të nënrenditura**.

Bashkërenditja, që numëron veprimet njëri pas-tjetrit, pa bërë përgjithësime dhe pa u ndalur në rrethana të ndryshme, ndërthuret me nënrenditjen si:

Po të vëmë re mirë një foshnjë të shëndoshë//, do të shohim// se kjo bën pareshtur lëvizje të ndryshme//; kështu për shembull e kthen kokën nga të gjitë anët, // sytë i lëviz më të djathtëe me të mëngjër, këmpkat i ze me njëren ose me të dy doçkat, ze çfarëdo që gjen përpara, një copë kartë që mund të ndodhet përpara saj e heq, e shtyn, e palos dhe e çpalos; çdo sent që ndodhet afër saj, e merr e vë në gojë, përpjek këmpkat, i lëviz doçkat në erë, e lëviz tërë trupin andej e këtej; çdo gjë q'i bijë në dorë, e sheh me një kurështi të madhe, e mban ca kohë dhe pastaj e thyen ose e hedh etj. (Qeverimi, f.16).

Fjali të gjata ku ndërthuret bashkërenditja me nënrenditjen.

Punimi methudhik, // që duhet bërë në këtë lloj hartimi, për klasët e ulta të gjymnazit //dotë jetë gjith' ay //që përdoret dhe në shkollat fillore; // i vetmi ndryshim do të jetë, // se këtu (në klasët e ulta të gjymnazit) rrëfenjat do të jenë pak më të rënda e më të gjata sesa në klasët e lartra të shkollës fillore; // për veç kësaj, pikat e themës duhet të jenë më të shkurtra, ashtu edhe pllani m'i ngushtë dhe me më pakë shpjegime, // në mënyrë që të lihet vënd për një vetveprim më të math nga ana e nxënësvet, //gjë që pajtohet edhe me moshën e tyre në këte klasë, edhe me sasinë më të madhe të dijenivet //që kanë edhe të stërvitjevet //që janë bërë gjer tashi. (Ushtrime, f.73).

Periudha me fjali të varur kohore dallohet për larmi të madhe të marrëdhënieve kohore si dhe për mjete shprehjeje. Gjenden tipe të ndryshme fjalish. Fjalitë me marrëdhënie parakohësie. Kjo lloj fjalie lidhet me kryesoren me me lidhëzat *para se, përpara se* etj. dhe folja kallëzues është në mënyrën lidhore. Në këto fjali bashkëlidhjet e kuptimeve të foljeve kallëzues janë në të tashmen e dëftores, në periudhë tregohet se kanë vlerë mbarëkohore dhe njëri veprim ndodh gjithmonë para tjetrit.

Kështu pra fëmija //para se të çfaqet në shkollë// ka me vehte a)paradispozitat që trashëgon nga prindërit, gjyshërit, ose stërgjyshërit e saj; //b)dispozitat q'i merr në vjetet e para nga familja; // dhe c) dispozitat q'i merr më von nga rrethi i shoqërisë //ku jeton. (Qeverimi, f.5).

Fjalitë kohore e paskohësisë përveç ndërtimeve me forma të shtjelluara foljore shprehet edhe me formën e pashtjelluar foljore **me të dalë**, pranë kësaj forme ndodhet një emër në rasën emërore pa parafjalë në pozicionin e kryefjalës.

*Fëmija me të dalë nga shtëpia, gjendet në mes të një rredhi të ri; aty ne lodrat me shokët e saj mëson shumë gjëra; fjalët, sjelljet dhe veprat e këtyreve i bëjnë fëmijës një përshtypje të madhe, dhe si pas zotësisë natyrale që ka t'imitojë të tjerët, shumë lehtë i rëmben këto dhe kështu bëhet e sjellshëme ose e pa-sjellëshëme, e drejtë ose e pa – drejtë, egoiste, ipokrite, gënjeshtare etj. ose e kundërta e këtyre, si pas shokëve që do të kenë. (Qeverimi, f.5). **Pas si bëhen tërë këto** që thamë më sipër, nxënësit do të stërviten dal nga dal që të zbukurojnë hartimin me disa mënyra e forma të të foluri, me qëllim që hartimi të bëhet i bukur dhe i këndëshëm. (Ushtrime, f.39).*

Fjalitë kohore e njëkohësisë. *Lotët e mij derdheshin bashkë me t'atyre, kur qeshnin ata// qeshnja edhe unë. (Qeverimi, f.115).*

Fjalitë kohore ndeshen të ndërlikuara me kuptime të tjera si: shkakore, kushtore, rrjedhimore, qëllimore dhe lejore.

Fjalitë kohore me nuanca kushtore. Kuptimi i kushtit u mbishtohet në fjalitë me lidhëzat **kur, si, sapo, derisa** e sinonimet e

tyre, sidomos kur foljet e të dyja fjalive janë në të tashmen ose në të pakryerën me kuptim të paaktualizuar.

Gjumi munt të dëbohet e sytë munt të çelen kur mësonjësi vetë është i gjallë e i zgjuar, dhe kur sytë e tij lëvizin e hidhen an' e mb' anë klasës së tij nga gjallësija e nga interesi që tregon për mësimin, si dhe nga entuziazma që ndjen në shpirtin e tij për ato që mëson. (Qeverimi, f.31).

Fjali kohore me nuanca rrjedhimi. Kuptimin e rrjedhimit e ndeshim në fjalitë që lidhen me lidhëzat **posa, sa**.

*Këto që numëruam gjer këtu, na duken të mjafta që të provojnë se njëerës kolerikë nuk duhen pranuar si mësonjës me as një mënyrë, dhe se këta zotërinj s' mundin të kërkojnë që t'edukojnë të tjerët, **posa që vehten e tyre s'janë të zotët t'a edukojnë.*** (Qeverimi, f.61).

Marrëdhëniet rrjedhimore shprehen në mënyra të ndryshme. Përveç periudhave me fjali të nënrenditura, ato mund të shprehen edhe me fjali të thjeshta, periudha me fjali të bashkërenditura, periudha me fjali asindetike, si edhe përtej periudhës, në nivel teksti. Ngjyrimet rrjedhimore ngërthejnë edhe një numër periudhash të tjera me fjali të nënrenditura.

*Mirë po prova e përditëshme na mëson se ndodhen disa nxënës me dispozita aq të keqe prej natyre, **sa për qeverimin e tyre s'mund të sjellin nonjë pemë as masat preventive, as masat tërheqëse.*** (Qeverimi, f.121).

Periudhat me fjali të bashkërenditur që shprehin marrëdhënie rrjedhimore janë zakonisht ato përmbyllëset. Te këto periudha me fjali të bashkërenditura me strukturë detyrimisht dykryegjymtyrëshe, fjalitë e dytë shpreh diçka që del si rrjedhim, përmbyllje e fjalisë së parë dhe lidhet me fjalinë e parë me anë të lidhëzave të specializuara: **andaj, ndaj, pra, pa**.

*Shëmbëlli pra më qënë se lint paraftyryrime shumë të gjalla e të qarta (sepse këto paraftyryrime që lindën prej shëmbëllit i sheh njeriu, i dëgjon dhe i prek), **prandaj ushtron influencë shumë të madhe mi vulnetin e njeriut.*** (Qeverimi, f.119). Ky kur është prej llamarine,

nxeht shpejt, po edhe shpejt ftohet, // kështu që s'mund të mbahet një temperaturë e rregullueshme. (Qeverimi, f.19).

Fjalja rrjedhimore korrelative: *Me këtë mënyrë u kisha hyrë në zemrën e nxënësve, aqë sa këta e adhuronin dhe e deshnin më tepër se prindrit e tyre.* (Qeverimi, f.115).

Fjalja kushtore. Periudhat me fjali të varur kushtore në veprat origjinale të Papahristos janë shumë të larmishme nga ana strukturore dhe kuptimore. Mjetet kryesore për shprehjen e marrëdhënieve kushtore janë lidhëzat e lokuacionet lidhëzore kushtore, të cilat u japin periudhave struktura të caktuara dhe ngjyrimet kuptimore.

Ndeshim periudhën **kushtore të mirëfilltë** që shpreh kushtëzim midis fakteve dhe dukurisë së realitetit.

Po këto përfundime munt t'i sjellë qeverimi, vetëm në qoftë se përdoret mirë prej mësonjësit; përndryshe d.m.th. përdorimi i keq i tij sjell përfundime fare të kundërta. (Qeverimi, f.6).

Fjali kushtore me lidhëzën **po** që tregojnë kusht, tipi më i përhapur në letërsinë artistike, krahas fjalive me *në* dhe *në qoftë se*.

Po të mos ndërrohet era e sallës së mësimit, nuk prishet vetëm shëndeti i fëmijvet, po vuan edhe qeverimi dhe mësimi. (Qeverimi, f.21).

Shprehja e marrëdhënieve kushtore nëpërmjet **formës së pashtjelluar mohore**, ku ndërtimi me këtë formë foljore është mohues. Ai tregon se mosrealizimi i një kushti të caktuar, sjell domosdo mosrealizimin e saj që shprehet në foljen drejtuese.

Pa u siguruar qeverimi, pa u përgatitur që më parë rruga dhe pa u-qeruar gjëmbat prej qeverimit, puna e edukatës-qëllimi kryesor i një shkolleka për të çaluar fort. (Qeverimi, f.10v.).

Shprehja e marrëdhënieve kushtore nëpërmjet **formës së pashtjelluar përcjellore**. Ndërtimet me përcjelloren që shprehin marrëdhënie kushtore janë dukuri e gjuhës së folur, por edhe e gjuhës së shkruar. Marrëdhëniet kushtore në këto ndërtime, për shkak të lidhëzës dhe të modalitetit të formës foljore të pashtjelluar, nuk dallohen qartë.

Mësonjësi pra, duke u-përkujdesur//që të hyjë erë e pastër shpesh herë në dhomën e mësimit, përveç që ruan shëndetin e fëmijvet-për të cilën gjë duhet të përpiqet me mish e me shpirt-po edhe qeverimit i a lehtëson punën shumë. (Qeverimi, f.22).

Fjalja qëllimore. Në shkrimet e Papahristos fjalia qëllimore ka përdorim të dendur. Lidhëzat kryesore janë: **që, në mënyrë që** etj.

Në kohën e verës dhe të nxehet, në dhomën e mësimit duhet të hyjë dendur erë e freshkët, // që të pakësojë të nxehtën. (Qeverimi, f.19). Me anën e këtyre masave mësonjësi tërheq mi personin e tij dashurinë dhe respektin e nxënësve, // në mënyrë që këta të mos prishin rregullën e klasës ose të shkollës, vetëm e vetëm nga respekti dhe nga dashuria //që ushqejnë mi personin e mësonjësit të tyre. (Qeverimi, f.13). Që t'i ndihmojmë më mirë mësonjësit, sjellim këtu disa shëmbëlla. (Ushtrime, f.39).

Fjalja mënyrore bashkohet me fjalinë drejtuese me anë të lidhëzave **si, ashtu si, sikur, sikundër** etj.

Me anën e këtyre masave, si kundër edhe fjala e tregon, mësonjësi i ndalon dhe i dënon nxënësit për një sjellje ose për një vepërim të keq nga an' e tyre, që të mos i përsëritin këto në kohën e arthme. (Qeverimi, f.14). Me gjith këtë, i dhashë funt// si duheshe. (Qeverimi, f.114).

Fjalja lejore. Në shkrimet e tij ndeshim frazën lejore të mirëfilltë ku marrëdhëniet lejore shprehen qartë dhe pa gërshetime me marrëdhëniet e tjera.

Është vënë re, se me gjith që janë marrë tërë masat preventive, me gjithë që mësonjësi është një person i mbaruar me autoritet, me dashuri etj., megjithë këtë ndodhen disa fëmijë të cilët nuk pushojnë së prishuri rregullin e shkollës dhe së sjelluri mësonjësit gjithënjë ndalime e pengime në të kryerit të detyrës së tij. (Qeverimi, f.121).

Ndeshim edhe fjalitë lejore me lidhëzën **edhe pse, edhe se** me nuancë shkaku, tregojnë lejim.

Fjalja shkakore gjithashtu ka përdorim në veprën e Papahristos. *Në qoftë se nga goja e prindërvet ose të një personi tjetër të familjes*

dalin fjalë të dobëta; // në qoftësesjelljet dhe veprat e tyre janë të liga; // në qoftëse fëmijët shofin se një nga personat e familjes është i pa-pastër, i pa-rregullshmë në punën e tij e.t.j., // s'ka as pikë dyshimi se edhe fëmijët do të bëhen të tillë. (Qeverimi, f.116).

Fjalja krahasore. Në periudhë në formën e fjalisë krahasore dalin fjali të tipave të ndryshëm si: fjalitë qëllimore, shkakore, kohore, kushtore, por edhe fjali tëmirëfillta.

Bile munt të thomi se dashurija e mësonjësit shumë herë sjell pemë e fitime më të mëdha e më të sigurta, sesa dashurija që kanë prindrit në fëmijët e tyre; sepse dashurija e prindërvet për arësye që kupëtohen lehtë, i zaptin këta shumë herë aqë fort, sa nuk mundin të vështrojnë e të gjenë as një të metë në fëmijët e tyre, e kështu nuk do të përkujdesen për çrrënjosjen e këtyre të metave. (Qeverimi, f.104).

Fjalja vendore. Fjalja vendore zë në vend të veçantë në shkrimet e tij. Për të rimarrë, përsëritur apo theksuar gjithë brendinë e fjalisë së varur vendore, autori fjalët korrelative, të cilat saktësojnë vendin e shprehur nga ndajfolja e vendit. Kjo ndodh si në fjalitë e paravendosura, si në fjalitë e varura të ndërvendosura.

Atje ku çalon qeverimi // pengohet edukata. (Qeverimi, f.7).

Fjalitë fthiluese (kryefjalore, kundrinore, kallëzuesore) janë të përdorura gjerësisht në shkrimet e tij.

Nga këto që thamë këtu më sipër, kuptohet lehtë se qëllimi dhe puna e qevërimut është që të pajtojë nxënësit me disa zakone dhe virtuta, të cilat janë të dobishme, që të mundë më pas të vepërojë edukata me dobi. (Qeverimi, f.8). Sikundër q'u tha, s'është e mundur të shpjegohet e të kthjellohet bukur e mirëkuptimi i talentit të mësonjësit. (Qeverimi, f.49). Është e vërtetëse shumë pedhagogë përparuan mirë dhe u-çquan, duke u udhëhequr prej talentit të tyre dhe pa nonjë përgatitje të veçantë. (Qeverimi, f.78). Gjith ashtu nuk mund të mohohet, se as një kulturë pedhagogjike nuk mund të zerë vendin e talentit dhe të taktit pedhagogjik. (Qeverimi, f.78). Më sipër thamë se në këto klasa rrëfenjat do të bëhen në një mënyrë të ndryshme nga ato që jepen në klasën e tretë. (Ushtrime, f.37).

Fjalja përcaktore. Nga këto që thamë këtu më sipër, kuptohet lehtë se qëllimi dhe puna e qevërimit është që të pajtojë nxënësit me disa zakone dhe virtuta, // **të cilat janë të dobishme**, që të mundë më pas të vepërojë edukata me dobi. (Qeverimi, f.8). Sa m'e lartër është klasa, **në të cilën ndodhet një nxënës**, aq më tepër nxënësi ka të drejtë të kërkojë prej këtij nxënësi hartim me një gjuhë e një stil të bukur. (Ushtrime, f.46).

Tipare të gjuhës së popullit. Një tipar me interes në sintaksën e Papahristos është frazeologjia popullore. Në shkrimet e tij ndeshim shprehje të ndryshme frazeologjike si:

*Këtë nevojë për mësonjësin, **dyke e marrë para sysh** pedagogjia, përpiqet me **mish e me shpirt** të studiojë fëmijët nga çdo pikëpamje dhe kështu të mundë të zgjidhë problemet e saj gjithmonë n'armoni me natyrën e fëmijvet.* (Qeverimi, f.2).

Përfundime

Sotir Papahristo dha një kontribut të rëndësishëm në fushën e arsimit si mësues, inspektor arsimit, si shkrimtar, përkthyes etj. Këtu kam trajtuar veçoritë gjuhësore të veprave origjinale të tij.

Struktura e fjalisë del me skema të larmishme, të afta për të shprehur mendimin, mënyrën e organizimit dhe të shtjellimit të tij. Në të mund të gjesh sipas rastit fjalinë e thjeshtë të shkurtër, pak të zgjeruar ose të pazgjeruar, ose fjalinë e gjerë më shumë gjymtyrë, fjalinë e plotë ose të paplotë, ose eliptiken. Ka një denduri të përdorimit fjalive pyetëse apo të fjalive të pyetjes retorike që karakterizohen nga një përbërje leksikore e veçantë, si pasthirrma, fjalë pyetëse, fjalë thirrmore etj.

Përdorimi i dendur i gjymtyrëve homogjene me bashkim asindetik dhe lidhëzor është karakteristikë e ligjërit të tij. Përdoren dendur kallëzues dhe kundrina homogjene, por edhe kryefjalë të tilla të cilat i japin gjuhës një ritëm të ngadalësuar.

Te Papahristoja ndeshet dukuria e *daljes së fjalive të nënrenditura më vete*, të shkëputura nga fjalia kryesore. Këtë mënyrë shprehjeje e përdorin shumë autorë. Nga pikëpamja stilistikore, kjo është një

mënyrë për të paraqitur një stil elegant, duke iu shmangur frazave të gjata të cilat mund të sjellin edhe errësim të kuptimit. Nga ana tjetër kjo bëhet për arsye të aktualizimit të frazës, në përputhje me synimin e komunikimit.

Për të shprehur raporte të caktuara sintaksore në mënyrë më të qartë Papahristoja ka përdorur një sërë lokucionesh parafjalore e lidhëzore të reja nga ndajfolje+parafjalë, ose nga parafjalë + emër + lidhëz, ose ndajfolje +lidhëz etj.

Përdorim të gjerë kanë në shkrimet e tij ndërtime të tilla si: ndërtimet përcjellore, disa fjali lidhëzore të caktuara, gjymtyrët e veçuara. Përsëritja në përgjithësi është karakteristikë stilistikore e shkrimeve të Papahristos. Ndeshen edhe fjalët dhe *togjet e fjalëve të ndërmjetme* të cilat i japin kuptime plotësuese frazës.

Autori me shkrimet e tij pasqyron shqipen e shkruar të kohës, ku struktura e fjalisë është e larmishme. Ai ka mundur të shprehë edhe format abstrakte të mendimit dhe ndjenjat njerëzore. Këtë e ka arritur nëpërmjet përdorimit të një numri të madh mjetesh sintaksore si: lidhëza, parafjalë të ndryshme, folje modale, sistemit funksional të trajtave, kohore e mënyrore, sinonimisë sintaksore nëpërmjet të cilave ka pasqyruar stilin e tij të shprehjes. Gjuha e tij është varianti letrar i toskërishtes me ngjyrimet e toskërishtes verilindore.

Literaturë

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatikë e gjuhës shqipe*, II Tiranë 1997.
Kolec Topalli, *Sintaksa e fjalisë*, Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 2011, f. 1179-1281.

Mehmet Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë, 2009, rib. 2014.

Mehmet Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2000.

Mehmet Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe, (përbërësit sintaksorë)*, *Vështrim i ri teorik*, Tiranë 2012.

Menella Totoni, *Çështje të studimit të sintaksës dialektore*, në, SF, 4, 78, f.89-95.

Menella Totoni, *Fraza me nënrenditje*, Tiranë, 2000.

Mimoza Priku, *Rreth disa ndërtimeve e kuptimeve foljore në veprën e Martin Camajt*, botuar, në Studime shqiptare, 17, Shkodër, 2011, f.255-264.

Sotir Papahristo, *Mësime shëmbëllore për disa nga lëndat kryesore që mësohen në shkollat fillore dhe të mesme*, Korçë, 1930.

Sotir Papahristo, *Qeverimi i fëmijvet në shkollë*, Tiranë, 1929.

Sotir Papahristo, *Ushtrimet gjuhore dhe Hartimet në shkollat fillore dhe të mesme*, Tiranë, 1938.

ERIS RUSI

Universiteti i Korçës

erusic1@yahoo.com

PËRKTHIMI DHE ONTOLOGJIA NË KOMPETENCAT KULTURORE TË SOTIR PAPAHRISTOS

Ky punim do të prekë kontributin përkthimor të Sotir Papahristos, i cili me punën e tij jo vetëm që ka shërbyer duke dhënë një kontribut në njohjen dhe përvetësimin e elementeve letrarë, filozofikë dhe kulturorë të botës antike greke, por ka afruar edhe vendin tonë me kulturat fqinje dhe të vendeve të tjera evropiane që janë formësuar nga modeli helen dhe ai latin. Bilanci i punës përkthimore të tij deri në vitin 1969 është mbresëlënës dhe përfshin vepra origjinale, të përshtatura, dhe të përkthyer; pedagogjike, didaktike, metodike, letrare etj., ku spikat qasja për të sjellë tekste me vlerë edukuese, morale, kulturore për lexuesin shqiptar të kohës. Nën këtë dritë, kontributi i Papahristos me përkthimet e sjella nga kultura helene është i jashtëzakonshëm, sepse pranë të djeshmen me të sotmen duke e bërë të mirëqenë faktin që komunikimi nuk është ndërprerë asnjëherë, duke vendosur në kontekste ontologjike, metafizike dhe etike, veprat e sjella në shqip që përkojnë me ballafaqimin e gjuhëve dhe kulturave që më tepër sesa dallime, mund të gjejnë ngjashmëri universale tek njëra tjetra.

Koha dhe hapësira në kontekstin e letrares

Gerard Genette, në një ese të shkurtër me titull “Hapësira dhe koha” i njeh veprës letrare një “natyrë teleskopike”, falë të cilës vazhdimësia kohore e leximit linear, destabilizohet nga rrjeta e rikthimeve dhe marrëdhënieve transversale që krijohen mes episodeve të ndryshme; ai pohon gjithashtu ekzistencën e një “hapësire primare” të letërsisë, të lidhur me natyrën gjuhësore të tekstit .

Një libër, është në fakt, para së gjithash një “objekt”, një tërësi shenjash që renditen në faqe në bazë të një radhitjeve atemporale dhe

materiale. Sipas Genette, gjuha shpreh jo vetëm marrëdhënie hapësinore, falë një numri të ngjeshur metaforash, por pranon në brendësi të saj edhe një hapësire semantike të mirëorganizuar.

Nën këtë dritë, produkti letrar i Sotir Papahristos ofron një letërsi të mirëkoordinuar në përkthimin e emrave të rëndësishëm të letërsisë antike greke, që jo vetëm e shtyjnë lexuesin t'i shmanget leximit linear, por e nxitin të pranojë si të mirëqenë mbivendosjen e të shkuarës me të tashmen. Kështu mundësohet leximi i pandërprerë i vijimësisë kulturore mes shekujve.

Edhe Julien Greimas e drejton vëmendjen e tij drejt hapësirës të kuptuar si gjuhë. Në veprën programore “Për një semiotikë topologjike”, ai vë përballë: komunikimin verbal me atë hapësinor, duke përmbyllur se ky i fundit përbëhet nga domethënie hapësinore dhe domethënie kulturore; hapësira, në realitet, është një krijim i njeriut për të gjetur domethënien e gjërave dhe si e tillë duhet dalluar nga shtrirja e zakonshme e perceptueshme nëpërmjet kanaleve sensoriale .

Nga momenti që gjuha hapësinore lejon që të flitet për “gjëra të tjera”, ajo futet me të drejtë në mjetet e shprehjes së një morfologjie sociale duke “nënkuptuar” organizimin e një shoqërie. Pra nëse hapësira letrare konsiderohet si zhvendosje artistike nga ajo reale, reflektimi i Greimasit merr një peshë të rëndësishme, pasi nxit marrjen parasysh të krijimit të hapësirës si një komunikim semiotik që në nivelin ekstra-tekstual.

Në këtë prizëm, tekstet e përkthyer nga S. Papahristoja mund të lexohen nën tjetër interpretim, sepse hedhin baza të qenësishme për përafrimin e veprave madhore të cilat nisin të bëhen pjesë e botëkuptimit letrar të Shqipërisë në faza të ndryshme kohore.

Procesi i përkthimit në vetvete, mundëson ngritjen e hipotezave të ndryshme mbi rolin dhe rëndësinë e përkthyesit në përcaktimin e kuptimit dhe vlerave ideomatike të teksteve të sjella nga një gjuhë tjetër. -Të qëndrosh nga të dyja anët e pasqyrës,-kështu e përshkruante Tomas Elioti eksperiencën e leximit të teksteve të hershëm në kohë

dhe në hapësirë, si ata në gjuhën sanskrite të vjetër. Kjo metaforë e bukur, është mbështetje për të pozicionuar Sotir Papahriston si intelektual, përkthyes, krijues, publicist dhe intelektual në fushën e kulturës dhe letërsisë sonë.

Në fakt në imagjinatën tonë kolektive pasqyra është një metaforë e fuqishme që tregon tjetrin, të ndryshmin, atë që është përballë nesh dhe nuk është tamam si ne. Përmes përkthimit realizohet mundësia që të rindërtohet identiteti përkatës, përmes përballjes, sjellës pranë dhe krijimit të lidhjeve që ecin mbi mekanizmat gjuhësorë dhe letrarë, evokojnë dimensione të largëta, që pastaj bëhen të njohura dhe për kulturën pritëse. Në këtë dritë, figura e Sotir Papahristos merr një rëndësi të ndjeshme, nëse i referohemi lidhjes që ai mundëson midis antikitetit dhe bashkëkohësisë, duke iu referuar kulturës helene në emrat e rëndësishëm të saj.

Në kontekstin e “letërsisë së krahasuar”, diskutohet shpesh për ngjashmëritë mes kulturave të vendeve të ndryshme evropiane, duke sjellë si argument në favor edhe faktin që kultura evropiane është ushqyer në mënyrë të padiskutueshme nga dy burime kryesore kulture: ajo helene dhe ajo romake. Ndaj rëndësia e jehonës së ardhur nga kjo lashtësi përmes veprës së Sotir Papahristos, jo vetëm që ka shërbyer si kontribut në njohjen dhe përvetësimin e elementeve letrarë, filozofikë dhe kulturorë të botës antike greke, por ka afruar edhe vendin tonë me kulturat fqinje dhe të vendeve të tjera evropiane që janë formësuar nga modeli helen dhe ai latin.

Përkthimi dhe aktiviteti kulturor i S. Papahristos

Përgjatë gjithë historisë së njerëzimit, gjuha ka qenë dhe vazhdon të jetë mjeti më i rëndësishëm i komunikimit njerëzor, me ndërmjetësinë e së cilës njerëzit shkëmbejnë mendime, ide, shprehin ndjenja, si dhe arrijnë të kuptohen me njëri-tjetrin. Sikurse dihet, komunikimi i njerëzve me anë të gjuhës realizohet në dy mënyra: me gojë dhe me shkrim. Në rastin kur komunikuesit zotërojnë të njëjtën gjuhë, atëherë komunikimi ndodh në mënyrë të drejtpërdrejtë, por kur njerëzit zotërojnë gjuhë të ndryshme, komunikimi i drejtpërdrejtë

është i pamundur. Në këtë rast na vjen në ndihmë përkthimi si një mjet i rëndësishëm që bën të mundur realizimin e komunikimit midis njerëzve të cilët shprehin mendimet e tyre në gjuhë të ndryshme.

Fakti që njerëzimi, që në krijimin e tij ka njohur një shumëllojshmëri gjuhësh kulturash, ku njerëzit nuk ndajnë të njëjtën gjuhë dhe kulturë, e ka vështirësuar komunikimin mes anëtarëve të komuniteteve të ndryshme dhe për këtë arsye është parë e nevojshme ndërhyrja e përkthimit, si çelësi kryesor për zgjidhjen e situatave të tilla. Në këtë aspekt përkthimi ka luajtur dhe luan një rol thelbësor në shkëmbimin e ideve, kulturave, përvojave e dijeve midis popujve të ndryshëm dhe mbi të gjitha funksioni kryesor i përkthimit mbetet, komunikimi, dialogu dhe këmbimi ndërmjet sistemeve të ndryshme kulturore dhe letrare.

Përkthimi është i lashtë sa vetë njerëzimi. Ai ka një traditë të gjatë dhe është praktikuar përgjatë gjithë historisë së njerëzimit. Edmond Tupja, studiues i njohur dhe teoricien përkthimi, në librin e tij “Këshilla një përkthyesi të ri”, shprehet se përkthimi ka një zanafillë të hershme dhe se në fillimet e tij ai është përdorur në trajtë gojore, për nevoja komunikimi dhe më pas, me lindjen e arteve në përgjithësi e të letërsisë në veçanti, ka filluar me të shkruar, edhe me përcjelljen e vlerave letraro-estetike.

Prirjen për t’u marrë me përkthim tek S. Papahristo mund ta gjejmë edhe në aktivitetin jetësor të tij. Është me rëndësi fakti që ai studioi në Universtetin e Athinës dhe fillet e tij të para në aspektin profesional i ka si mësues i greqishtes së vjetër, latinishtes dhe historisë në Korçë. Bilanci i punës përkthimore të tij deri në vitin 1969 është mbresëlënës dhe përfshin vepra origjinale, të përshtatura, dhe të përkthyer; pedagogjike, didaktike, metodike, letrare etj) si për shembull: Bioskautizmi(adaptim), 1923; Mbi rritjen e foshnjës (përkthim), 1924; Qeverimi i fëmijëve në shkollë (origjinale), 1929; Mësime shembullore për shkollat fillore e të mesme (origjinale),1930; Jeta e Pirros (sipas Plutarkut, përkthim), 1934; Karakteret e Theofrastit (përkthim), 1944 e shumë e shumë të tjera.

Pas vitit 1945 përkthen nga greqishtja në shqip arkivin e Institutit të Shkencave; nga historianët grekë dhe romanë ka përkthyer pjesët që flasin për Shqipërinë (përfshirë këtu me qindra faqe të daktilografuar); ka përkthyer të gjitha dramat e Sofokliut, 7 vepra; ka përkthyer të gjitha dramat e Eskilit, 7 vepra; ka përkthyer gjashtë drama nga Euripidi; ka përkthyer katër komedi nga Aristofani; “Poetika” e Aristotelit; ka hartuar Antologjinë e prozës greke (pjesët më të zgjedhura nga prozatorë më të mëdhenj të Greqisë së Vjetër); ka përkthyer veprën monumentale Historia e Luftës së Peloponezitetit të Tuqididit, shoqëruar me një hyrje të gjatë; ka përkthyer “Jetët Paralele” të Plutarkut.

Me botimin e dy veprave që kishte amanet përkthyesi, “Jetët paralele” të Plutarkut që u botua në 2006, si dhe me daljen tani në treg të “Luftës së Peloponezitetit”, të plotë, - kemi rikthimin e helenistit, atij që Çabej me të drejtë e quan “të fundit” të greqishtes së vjetër.

Kompetencat kulturore dhe krahasimtare të S. Papahristos

“Sot produktet e kombeve të ndryshme përzjehen me një shpejtësi aq të madhe, sa kemi nevojë për mënyra të reja që të mësojmë dhe të kemi mundësi të reagojmë”. Kjo frazë ngjan si të jetë e shkruar në ditët e sotme dhe t’i referohet fenomenit të globalizimit. Por në fakt është e vitit 1827 dhe vjen nga një shkrimtar që është njëherësh një klasik i madh i letërsisë evropiane dhe asaj botërore: Gëte. Ai formulon një koncept të ri që e quan “Veltliterature”, letërsi botërore dhe formula përkatëse shoqërohen me idenë që ky term duhet t’i referohet tërësisë së kryeveprave që i imponohen publikut ndërkombëtar, ose veprat që kanë pasur më shkumë ndikim e më tepër përhapje në shkallë botërore. Çka është e rëndësishme në studimin tonë, ka të bëjë me faktin që kjo lloj letërsie madhore që vjen nga jashtë, përmes përkthimit, mundësohen zgjerimin mundësive letrare, artistike të një kulture të caktuar, e në rastin e letërsisë shqipe gjatë regjimit socialist, mund të konsiderojmë që sidomos përkthimi i teksteve dramatike, historike, të antikitetit, ka sjellë një dalje nga korniza imponuese shpeshherë e përkthimit në funksion të parimeve

politike të shtetit komunist.

Sot mund të shtojmë një tjetër interpretim në qasjen ontologjike ndaj sjelljes së botëkuptimit helen përmes përkthimit në letrat shqipe nga S. Papahristo.

Kornizat e autorëve të përkthyer prej tij, tejkalojnë normalitetin dhe kufizimet e sistemit, nuk mund të futen brenda asaj cka ishte letërsia e orientuar dhe në funksion të parimeve të realizmit socialist, e përmes tyre mundësohet dhënia e një vizioni universal të qenies dhe natyrës njerëzore, të shpirtit në pavdekësinë e tij, mes tragjizmit dhe realizmit historik në vepra që dëshmojnë sa më sipër. Venia ne qarkullim e kryeveprave të lashtësisë nga dora e një mjeshtri helenist, do të ishte një ushqim i pazevendesushem kulturor për ata që kishin interesa në atë fushë. Në vitin 1962, u botua antologjia "Proza antike greke", që përben ngjarje të vecante për kulturen tonë, sepse deri atëherë kjo fushë kishte mbetur e panjohur për lexuesin shqiptar, i cili me atë veper, mundi të formojë një ide sado të vogël për këtë gjini letrare të lashtësisë greke.

Përkthimi dhe ontologjia

Në librin e tij "Të thuash gati të njëjtën gjë", Umberto Eko ka një kapitull me titullin "Përkthimi dhe ontologjia".

Ontologjia në fakt, është një term që rrjedh nga fusha e filozofisë, ka të bëjë me studimin dhe njohjen e qenies, e si i tillë, gjen vështirësi për të hasur sinonime që përafrojnë kuptimin e këtij termi. Fjalë për fjalë do të thotë "diskurs mbi qenien" dhe Eko në kapitullin e tij shpreh se : "Ekzistojnë modalitete universale të segmentimit të përvojës njerëzore. Ekzistojnë disa prirje, tendenca bazike të realitetit (ose qenies) që lejojnë pikërisht krahasimin midis gjuhëve dhe lejojnë të shkohet përtej formave të përmbajtjes së secilës gjuhë.

Ky interpretim, na ofron mundësi të shohim tek modelet e përkthimit të Sotir Papahristos, nevojën për të dhënë qenien njerëzore në universalitetin e saj, nën dritën e një komunikimi të pandërprerë midis së lashtës dhe të sotmes, të largëtës në hapësirë dhe pozicionit ku ndodhemi aktualisht ne. Jehona e këtij komunikimi realizohet

përmes kontekstualizimit të përkthimit, por edhe nëpërmjet prezantimit të teksteve që pëlqehen dhe bëhen pjesë e sistemit kulturor të vendit tonë.

Nën këtë dritë, kontributi i Papahristos me përkthimet e sjella nga kultura helene është i jashtëzakonshëm, sepse pranë të djeshmen me të sotmen duke e bërë të mirëqenë faktin që komunikimi nuk është ndërprerë asnjëherë, duke vendosur në kontekste ontologjike, metafizike dhe etike, veprat e sjella në shqip që përkrijnë me ballafaqimin e gjuhëve dhe kulturave që më tepër sesa dallime, mund të gjejnë ngjashmëri universale tek njëra tjetra.

Literaturë

Tupja, Edmond, *“Këshilla një përkthyesi të ri”*, Onufri, Tiranë, 2000

Chevrel, Yves, *“Letërsia e krahasuar”*, Tiranë, 2004

Eko, Umbërto, *Të thuash gati të njëjtën gjë*, Dituria, Tiranë, 2006

Barthes, Roland, *Aventura Semiologjike*, Rilindja, Prishtinë, 1988

OLGER BRAME
Universiteti i Korçës
obrame@unkorce.edu.al

SOTIR PAPAHRISTO MBI DISA ÇËSHTJE TË PEDAGOGJISË DHE DIDAKTIKËS

Një komb lartësohet mbi të gjitha, edhe për figurat që me ndihmesën e tyre të çmuar ndikojnë sadopak në krijimin e fizionomisë së kombit. Padyshim që në këtë varg emrash që plotësojnë mozaikun, një vend të veçantë zë emri dhe ndihmesa e tij e paçmuar e një prej pedagogëve të talentuar me veprimtari të frytshme praktike e teorike, drejtues e organizator i shquar të arsimit, përkthyes e studiues prodhimtar në fushën e pedagogjisë, intelektualit erudit, helenistit dhe humanistit Sotir Papahristo. Është një emër që i dha vendit dhe popullit një pasuri intelektuale si pak të tjerë.

Do të konsiderohet si didakti më i njohur i arsimit të mesëm të kohës, me ndihmesa në mësimdhënie, drejtimin e institucioneve arsimore, autor tekstesh e deri në drejtimin e arsimit në nivele të larta shtetërore.

Me vetëdije të lartë profesionale, do të ishte ndër të paktët që do të sillte një vizion të ri bashkëkohor e të rrallë për kohën, për reformimin e shkollës, duke dhënë ndihmesën e tij konkrete edhe si mësues e inspektor, por edhe si profesionist me shkrime e artikuj në funksion të përngritjes së shkollës shqiptare. Nëse do të përmblidhej me pak fjalë personaliteti i profesor Papahristos, mjafton të lexosh opinionet e shtypit të kohës dhe vlerësimet për të: Me gjithë vështirësitë dhe pengesat e shumta, puna e Papahristos po ecte përpara me ritme të shpejta dhe po jepte përfundime të lakmueshme. Mirëpo një ditë papritur ai dha dorëheqjen nga posti më i lartë i arsimit shqiptar. Po pse vallë kjo dorëheqje, nga një njëri i punës së kualifikuar dhe të ndërgjegjshme, prej të cilit shkolla shqiptarë, kishte të drejtë të priste shumë? "Gazeta e Korçës", shkruan : "Aty-këtu, flitet se që i shtrënguar nga pengimet që e ndalojshin për të vënë në

zbatim mendime përparimtare, të cilat kishin për të vënë në udhë të mbarë arsimin e kaq vuajtur shqiptar¹⁰⁴. Më konkretisht, atëherë u fol se, Papahristoja i drejtë, nuk mund të duronte ndërhyrjet e shumta që i bëheshin nga pushtetarë, ose autoritete të tjera, për bursa studimi dhe për emëtime mësuesish. Aq më tepër, Papahristoja i ndershëm, nuk mund të pranonte ryshfetin. Sado të paplota që të jenë këto argumente, janë të besueshme, po të kemi parasysh koherencën e personalitetit të tij, që kishte dhënë dhe do të jepte gjithnjë prova të një karakteri të qëndrueshëm dhe të papërlyer. Ishte personifikimi i intelektualit më cohë të zgjedhur për burrë shteti. Shtypi i kohës shfaqti keqardhje të madhe për largimin e Papahristos nga kreu i punëve të shkollës shqiptarë. Elementët përparimtare, ditën ta vlerësojnë me nota lartësish kualifikuese punën e tij. Gazeta "Koha" e Mihal Gramenos e quajti as më shumë as më pak, por kolosale veprën e tij në krye të dikasterit të arsimit. "Për punën që bëri zoti Papahristo si drejtues i përgjithshëm i arsimit, çdo lëvdim na duket i vogël", - shkroi gazeta e mirënjohur demokratike. Dhe më tutje vijonte: "*Më të vërtete, në një kohë tepër të shkurtër bëri aq shumë punë, sa që mund të themi se u vunë themelet e arsimit*"¹⁰⁵

Është e pamundur që në një punim të përmbledhësh gjithë veprimtarinë e një personaliteti të tillë, prandaj jemi përqendruar vetëm në disa çështje që lidhen me aspekte të pedagogjisë dhe didaktikës, në fushën e gjerë të veprimtarisë së profesor Papahristos.

Papahristo punoi si inspektor arsimit i prefekturës së Korçës. "Gazeta e Korçës" shkruante: "Si inspektor i arsimit të Korçës ka vepruar me zell e zotësi të rrallë. Me konferencat e mësimet pedagogjike, këshillat dhe udhëzimet e vlefshme, që u jepte arsimtarëve të qarkut, shënoi një stacion të paharrueshëm në zhvillimin e arsimit fillor të Korçës". Sotir Papahristo u emërua drejtor administrativ i Liceut. Posti i drejtorit administrativ të asaj

¹⁰⁴ "Gazeta e Korçës", Korçë, 5.9.1925, nr.215 në "Sotir Papahristo, njeriu i arsimit" I.Gogaj, botuar në Korrieri Nr. 241, 2 tetor, 2005, f. 14

¹⁰⁵ Gazeta "Koha", Korçë, dt.5.9.1925, nr.236 në "Sotir Papahristo, njeriu i arsimit" I.Gogaj, botuar në Korrieri Nr. 241, 2 tetor, 2005

shkolle të rëndësishme nuk nënkuptonte thjesht punë administrative dhe dokumentare, por edhe mjaft punë të tjera të rëndësishme mësimore pedagogjike. Në këtë kohë qeveria franceze njohu zyrtarisht ekuivalencën e dëftesës së maturës të Liceut të Korçës. Në vitin shkollor 1933-1934 Sotir Papahristo ishte drejtor i institucionit të porsakrijuar prej tij, Institutit Femëror “Nana Mbretreshë” në Tiranë. Ai la disa dhjetëra artikuj në gazeta e revista dhe 13 tituj librash origjinalë. Në aspektin didaktiko-pedagogjik, vlen të theksohen:

- Qeverimi i fëmijëvet në shkollë (Tiranë ,1929)
 - Mësime shembullore për shkolla fillore e të mesme, Tiranë, 1930
 - Hartimet në shkollat fillore e të mesme, Tiranë, 1936
 - Gramtika e greqishtes së vjetër, Vëll.I-II, 1938; 1940
 - Sintaksë e greqishtes së vjetër, 1942
- si dhe mjaft artikuj në shtypin profesional të kohës si:
- Autokriteti i Mësuesit , Revista Pedagogjike, Vjet.II, Nr.11, 1924
 - Çështje didakte. Prej kujt duhet thënë qëllimi. Revista Pedagogjike, Vjet. IV, 1926, Nr. 1-2
 - Pedagogu është nevojë të dijë natyrën e fëmijëvet, në Qeverimi i fëmijëvet...
 - Disa udhëzime didakte.
 - Dijenitë dhe kultura e mësonjësit etj.¹⁰⁶

Nisur nga këto vepra me mjaft vlerë të Papahristos, është me mjaft interes këndvështrimi se si trajtohen me profesionalizëm dhe vizion prej tij disa çështje, të cilat mbeten aktuale edhe sot.

Çështja e disiplinës në shkollë është trajtuar prej tij me mjaft interes. Këtë ai e lidh me bindjen dhe vëmendjen që shfaqin fëmijët ndaj mësuesit, arsyen pse e çmojnë dhe e respektojnë atë si mësues. Nga ana tjetër ai vë në dukje se mësuesi e ka më të lehtë të mbajë

¹⁰⁶ Sh. Osmani, Shpallime etnopedagogjike II, Kristalina-KH, Tiranë, 2008, fq.357-358

disiplinën nëse ka fituar respektin e nxënësve. Vetëm në këtë mënyrë ai nuk ka nevojë të përdorë frikën, dënimet apo sharjet ndaj tyre për të vendosur disiplinën. Pikërisht këtë ai e lidh me “autokritetitin” e mësuesit.¹⁰⁷

Lidhur me këtë çështje ai jep disa udhëzime didaktike me mjaft vlerë, ku shkurtimisht po përmbledhim:

-Nëse mësuesi nuk e bën të kuptueshëm dhe tërheqës mësimin për të gjithë fëmijët, atëherë nuk do të tërheqë dot vëmendjen e tyre, kështu që do të krijojë hapësirë për prishje të qetësisë dhe rregullit në klasë. Nëse mësimi do të jetë tërheqës dhe i kuptueshëm për klasën, do të sigurohet dhe rregulli, qetësia dhe vëmendja për të.

-Një mësues nuk duhet të hyjë në mësim i papërgatitur. Ky duhet të jetë parim themelor i punës së tij. Nëse kjo ndodh, ai udhëzon që do të jetë më mirë të merret me diçka që e ka përgatitur më parë sepse rrezikon të humbë autoritetin e tij para nxënësve.

-Mësuesi duhet ta orientojë mësimin në atë mënyrë që të gjithë nxënësit ta gjejnë veten në të dhe të merren me diçka. Për t'i angazhuar në mënyrë të përgjithshme nxënësit duhet të mbahet parasysh mënyra se kujt i drejtohen pyetjet, si drejtohen këto pyetje, a përfshihen të gjithë nivelet e nxënësve, a tregohet kujdes për të angazhuar edhe nxënësit që kanë një nivel më të ulët për t'u angazhuar në mësim, koha që duhet për çdo pyetje e përgjigje, etj.

-Mjaft me interes janë udhëzimet e tij për mësuesin që punon me klasa kolektive, me grupmosha të ndryshme nxënësish dhe si të praktikojnë atë që ai e quan “mësim indirekt”.¹⁰⁸

Një çështje tjetër që lidhet me aspektet e pedagogjisë së mësuesit, është baza e njohurive që duhet të zotërojë një mësues. Së pari ai ngre si një detyrë të rëndësishme përshtatjen e figurës së mësuesit me shoqërinë e kohës. Për të realizuar këtë ai thekson se mësuesi nuk duhet të mjaftohet me njohuritë që ka, por duhet t'i shtojë dhe t'i plotësojë këto njohuri, duke sjellë në vëmendje një thënie të Gëtes se

¹⁰⁷S.Papahristo, Autokritetiti i Mësuesit, Revista Pedagogjike, V.II, nr.11, Tiranë, 1924

¹⁰⁸ S. Papahristo, Qeverimi i fëmijëvevet në shkollë, Tiranë, 1929

nuk ka gjë më të tmerrshme sesa të ndodhesh para një mësuesi që nuk di më tepër sa dinë nxënësit. Njohuritë e një mësuesi sipas tij, nuk duhet të përfundojnë me mbarimin e shkollës. Sipas tij një mësues nuk mund të besojë se me mbarimin e arsimimit të tij nuk ka më nevojë për studim e libra. Shkolla i jep atij bazat për të mësuar dhe mbi këto baza ai duhet të plotësojë e të zgjerojë njohuritë e tij në mënyrë të pandërprerë. Edhe nëse mësuesi del nga shkollimi i tij me njohuri të plota didaktike e metodike, këto do të jenë të pamajaftueshme për gjithë kohën, sepse vazhdimisht shoqëria zhvillohet dhe dalin në dritë parime, sisteme e metoda të reja të mësimdhënies dhe të të mësuarit. Për këtë, mësuesit i del si detyrë studimi i literaturës shkencore e pedagogjike, i del detyrë ndjekja e konferencave mbi çështje të shkencës e pedagogjisë, si dhe konsultimi me njerëz të ditur prej të cilëve “mund të blejë gjëkafshë”.¹⁰⁹

-Përpos njohurive metodiko-didaktike, ai ngre si një çështje të rëndësishme kulturën e përgjithshme që duhet të zotërojë një mësues, por krahas saj edhe atë që ai e konsideron si kulturë të veçantë, me të cilën ka parasysh kulturën profesionale në përgjithësi dhe të mësuesit në veçanti. Vetëm kultura e përgjithshme nuk të bën mësues të mirë, sepse ajo nuk u përgjigjet gjithë nevojave profesionale që duhet të shfaqë një mësues në shoqërinë që vazhdimisht ndryshon.

-Njohjen e psikologjisë dhe karakteristikave të fëmijëve sipas moshës ai e thekson si një aspekt të rëndësishëm të punës së mësuesit. Sipas tij, një mësues që nuk njeh natyrën e fëmijëve, nevojat e tyre, nuk mundet kurrësi të gjejë mënyrën e duhur dhe mjetet për t’u dhënë atyre drejtimin dhe formën që dëshiron. Mësuesi duhet të dijë edhe sasinë dhe cilësinë e dijeve që duhet t’u mësojë fëmijëve. Edhe mënyrën dhe metodën për to ai ia atribuon po mësuesit. Nëse mësuesi nuk zbret në nivelin e nxënësit, për të kuptuar se si duhet t’ua paraqesë njohuritë atyre, ai nuk do të kuptohet asnjëherë prej tyre.

Këto ishin në vija të përgjithshme disa prej këndvështrimeve më të rëndësishme të aspektit pedagogjiko-didaktik të hedhura nga

¹⁰⁹ Po aty

Papahristoja, këndvështrime të cilat janë edhe sot, pas pothuaj një shekulli, mjaft aktuale dhe me mjaft vlera për shkollën dhe profesionin e mësuesit, Kjo gjë nxjerr në pah edhe një herë përmasën e tij erudite të një intelektualit, didaktit dhe pedagogu të rrallë.

Dëshira e Papahristos ishte që të kthehej në Korçën e tij të bukur dhe të dashur. Në shtator 1925, profesor Sotir Papahristoja u emërua drejtor administrativ i Liceut. Posti i drejtorit administrativ të asaj shkolle të rëndësishme, nuk nënkuptonte thjesht punë administrative dhe shkresurie, por edhe mjaft punë të tjera të rëndësishme mësimore pedagogjike. Ishte një vleresim dhe një nder që i bëhej të parit shqiptar në atë vend pune. Në këtë mes, Papahristoja u vu në provë të vështirë në një trupë pedagogjike, ku pjesa më e madhe, deri atëhere ishte franceze, mësues me një barrë kulturë e me përvojë. Këtë provë, Papahristoja e kaloi me sukses me një veprimtari, e cila nuk ra kurrë më poshtë se ajo e francezëve¹¹⁰.

Papahristo është njeriu, që ka përjetuar kohën dhe botën e tij të brendshme shpirtërore me të gjitha ndjesitë që i ka sjellë jeta - dashurinë për gruan, të cilësuar të rrallë nga vetë ai, dhembshurinë dhe ngazëllimin për fëmijët; përgjegjshmërinë dhe dëshminë e qytetarit për atmosferën e kohës ku jetoi.¹¹¹

Ndoshta sot me këtë konferencë ne vetëm gjejmë një mundësi për t'i thënë faleminderit punës së tij kolosale për arsimin. Ndoshta sot emri i tij minimalisht duhet të ishte i gdhendur edhe në ballinën e ndonjë institucioni arsimor ku ai shërbeu dhe dha ndihmesë të paçmuar. Ndoshta kjo mund të ishte e pallogaritshme krahasuar me atë që ai i dha arsimit shqiptar.

¹¹⁰ I.Gogaj, Sotir Papahristo, njeriu i arsimit”, botuar në Korrieri Nr. 241, 2 tetor, 2005, fq.14

¹¹¹ Sotir Papahristo-Helenisti me “Autobiografi” të panjohur, botuar në gazeta “Standard”, 25.04.2009

Literaturë

I.Gogaj, Sotir Papahristo, njeriu i arsimit”, botuar në Korrieri Nr. 241, 2 tetor, 2005

Sotir Papahristo-Helenisti me “Autobiogafi” të panjohur, botuar në gazeta “Standard”, 25.04.2009

Iljaz Gogaj, Sotir Papahristo (1887-1979) : [Portret] në: Historia e arsimit. - Nr. 1, 2002, f. 31 - 48 2002

S. Papahristo, Qeverimi i fëmijëvet në shkollë, Tiranë,1929

S.Papahristo, Autokriteti i Mësuesit, Revista Pedagogjike,V.II, nr.11,Tiranë, 1924

Sh. Osmani, Shpallime etnopedagogjike II, Kristalina-KH, Tiranë, 2008

ARIANA KTONA
Mësuese, DAR-Korçë
arianaktona@yahoo.com

PUNËTORI I MERITUAR I ARSIMIT- SOTIR PAPHRISTO

Tema e përzgjedhur për t'u trajtuar është "Punëtori i merituar i arsimit-Sotir Papahristo". Ky punim nxjerr në pah kontributin e madh që Sotir Papahristo ka dhënë në zhvillimin e arsimit në Korçë dhe më gjerë. Sotir Papahristo i dha popullit të tij 56 vite pune me shumë produktivitet. Sotir Papahristo përjetoj me dhimbje prej shqiptari të vendosur ngjarjet dhe vitet e turbullta pas pavarësisë për Korçën dhe Shqipërinë. Ishte një njeri paqësor, i cili bëri përpjekje për të vendosur gjuhën e pasur dhe të bukur të nënës. Vazhdimisht bëri përpjekje për të gjetur zgjidhje optimale për problemet që i dilnin para si mësues dhe si inspektor. Papahristo, pavarësisht rrethanave eci para në rrugën e tij prej misionari atdhetar për shkollimin e popullit të tij. Ai tregoi gjatë gjithë veprimtarisë së tij cilësi të rralla për të vënë në udhë të themeltë shkollën shqipe.

Në vitet 1882-1908 situata në Shqipëri ishte shumë e vështirë. Përpjekjet për futjen në rrugë zyrtare të gjuhës shqipe në shkollat turke dhe greke që funksiononin atëherë në Shqipëri, dështuan. Shkrimi dhe leximi i gjuhës shqipe mësohej fshehurazi. Në këto rrethana patriotët shqiptarë vendosën të çelnin shkolla shqipe të pavarura, ku të mësonin nxënës të të gjitha besimeve fetare. Shoqëria e Bukureshtit, në këtë kohë, kishte botuar disa tekste shkollore të hartuara nga Sami Frashëri, Naim Frashëri etj. dhe filloi ti dërgonte në Shqipëri fshehurazi. Ndërkohë, drejtuesit e shoqërisë së Stambollit po përpiqeshin të nxirrnin lejën nga autoritetet osmane për çeljen e shkollës shqipe. Pas gjithë këtyre përpjekjeve të përbashkëta më 7 mars 1887 u çel në Korçë "Mësonjëtorja Kombëtare Shqipe", nën drejtimin e Pandeli Sotirit. Ajo ishte një shkollë fillore me karakter

kombëtar e laik. Të gjitha mësimet merreshin në gjuhën shqipe. Çelja e shkollës kombëtare të Korçës shënoi një fitore të rëndësishme për legalizimin e arsimit kombëtar dhe ngjalli entuziazëm në mbarë vendin.

Më tej atdhetarët çelën edhe shkolla të tjera shqipe. Për të organizuar dhe drejtuar këtë lëvizje arsimore që po zgjerohej u formua një shoqëri kulturore në Korçë me emrin “Shoqëria e Mësimi Shqip”. Më tetor 1891 u çel në Korçë një shkollë shqipe për vajza, nën kujdesin e Gjerasim Qiriazit dhe të motrës së tij Sevastisë. Nxënësit që shkolloheshin në këto shkolla ishin të besimeve fetare të ndryshme. Arritjet e arsimit shqiptar i shqetësuan shumë sunduesit osmanë. Mësuesit dhe nxënësit e shkollave të para shqipe u bënë shpejt objekt ndjekjesh, kërcënimesh nga ana e autoriteteve osmane.

*Pengesat e vështirësitë e mëdha që dilnin në rrugën e zhvillimit të arsimit kombëtar u përballuan dhe u kapërcyen në sajë të mbështetjes së fuqishme që shkolla shqipe gjeti në forcat e shëndosha të shoqërisë shqiptare-në masat popullore arsimdashëse, në rilindësit shqiptarë që ishin elementët më përparimtarë të borgjezisë dhe mikroborgjezisë shqiptare dhe në rininë trime e patriote.*¹¹²

Kontribut shumë të madh në zhvillimin e arsimit dhe kulturës në Shqipëri kanë dhënë figura të tilla si: motrat Qiriazit, vëllezërit Frashëri, Pashko Vasa, Naum Velqilharxhi etj. Në kushtet e vështira nga gjiri i popullit shqiptar dolën një varg atdhetarësh të flaktë që ju përveshën punës për përhapjen e arsimit shqip në popull dhe për krijimin e shkollave në gjuhën amtare. *Mendohej që “Korça të bëhej një qendër intelektuale e të gjithë Shqipërisë “dhe në kushtet kur ishte rritur nevoja jo vetëm për libra në gjuhën shqipe por edhe për mësues të shqipes, përgatitjen e tyre mund ta merrnin përsipër përkohësisht shkollat shqipe të Korçës”.*¹¹³ Në vitet pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në qytetin ku u çel shkolla e parë shqipe, në Korçë, u

¹¹² Hysni Myzyri. *Shkollat e para kombëtare shqipe*, (Albania: 8 nëntori, 1978), fq.248.

¹¹³ Po aty, fq. 201.

shqua për kontributin e tij të madh në fushën e arsimit, Sotir Papahristoja.

Kush ishte Sotir Papahristo?

Sotir Papahristo lindi më 11 dhjetor 1887, në fshatin Vëmbel të Bilishtit. Ishte bir i një prifti fshati. Mësimet e para i mori në shkollën e fshatit dhe më pas në gjimnazin grek të Korçës. Përfundoi gjimnazin me shumë sukses në vitin 1907, si një nga nxënësit më të mirë. Iu siguroi një bursë për të studiuar në universitetin e Athinës. Studioi në këtë universitet, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë për 5 vjet (1907-1912). Ndoqi studimet në Universitetin e Athinës dhe më pas u kthye në Korçë, duke dhënë një kontribut të madh në fushën e arsimit. U martua më 30 janar 1922 me Evdhoksi Manon, vajzën e një familjeje të dëgjuar korçare. Vdiq më 21 shtator 1979, në moshën 92 vjeçare.

Kontributi i Sotir Papahristos në zhvillimin e arsimit në Korçë dhe më gjerë

Pas kthimit të tij në Korçë, pas studimeve universitare, Sotir Papahristoja, filloi punë si mësues në Gjimnazin e Korçës. *“U ktheva në Korçë si profesor në gjimnazin e atyshëm (Pangjion gjimnasion) ku shërbeva për 10 vjet me radhë (1912-1922) duke pasur për lëndë mësimore: greqishten e vjetër ,latinishten dhe historinë”*.¹¹⁴ Ngjarjet e viteve 1912-1920 kanë sjellë ndryshime të mëdha në jetën e vendit. Shpallja e Pavarësisë së vendit, krijimi i shtetit të parë kombëtar, organizimi i parë i tij si shtet i pavarur dhe ngjarjet e tjera përbëjnë periudhën më të rëndësishme në historinë e vendit tonë. Ngjarjet e këtyre viteve sollën jo vetëm ndryshime në aspektin politik, por edhe në aspektin arsimor e kulturor. Pas mbylljes së shkollave greke, Sotir Papahristoja iu përkushtua me mish e me shpirt arsimit shqip. Ai arriti shumë shpejt të bëhej një figurë e rëndësishme në fushën e arsimit shqiptar. Rrethet përparimtare të kohës punuan që shkollat të ishin qendra të edukimit atdhetar për brezin e ri, të përshkroheshin nga fryma laike dhe të zbatonin metoda moderne përëndimore të

¹¹⁴“Gazeta Standard”, Tiranë, dt.26.04.2009, nr. 1226

mësimdhënies. Për përmbushjen e këtyre kërkesave arsimtarët atdhetarë thirrën në vitet 1920-24 tri kongrese arsimore. Në vitin 1922, Sotir Papahristoja mori pjesë në Kongresin Arsimor të Tiranës. Mbajtja e Kongresit Arsimor në Tiranë më 22 korrik 1922 ishte një ngjarje e rëndësishme në historinë e arsimit. Ministri i Arsimit në atë kohë ishte Rexhep Mitrovica. Në këtë kongres u rrahën çështjet që kishin rëndësi të madhe për zhvillimin e arsimit. Morën pjesë 40 delegatë, ku 4 ishin nga qyteti i Korçës, pjesë e tyre edhe Papahristoja. Ai ra në sy në këtë kongres me përgatitjen e tij të lartë profesionale dhe jo vetëm. Jehona e kongresit u pasqyrua në të gjithë shtypin shqiptar. U emërua kryeinspektor i shkollave të prefekturës së Korçës. Si mësues dhe si kryeinspektor u përpoq shumë për t'i vënë shkollat në udhë të mbarë. Iu shërbeu shumë mësuesve të kësaj kohe për formimin e tyre si mësues të mirëfiltë. Shkrimet e tij rreth çështjeve të arsimit u botuan në shumë gazeta. Në kohën kur Rexhep Mitrovica, një prej nënshkruesve të Deklaratës së Pavarësisë, veprimtar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, ishte ministër i arsimit, Sotir Papahristoja gëzoi mbështetjen e tij. Në mars 1925 falë punës së tij të palodhur dhe suksesit të tij, Papahristos iu propozua të vendosej në postin e drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Shqiptar. Ky post iu rekomandua nga Koço Kotta, kryeministër në atë kohë. Fillimisht, Sotir Papahristoja e refuzoi atë post, pasi nuk dëshironte të largohej nga familja e tij. Më pas e pranoi, duke u siguruar që do të qëndronte për një kohë të shkurtër. Shkoi në Tiranë në mars 1925 dhe qëndroi deri në shtator 1925. Në fillim të punës së tij hasi shumë pengesa, por me ndërhyrjen e Ahmet Zogut si president, arriti t'i kishte krahët e lira për të vepruar. Në bashkëpunim me arsimtarët më të mirë të kohës, përpiloi ligje, programet e para dhe i vuri baza arsimit. Pavarësisht se në këtë post qëndroi për një kohë të shkurtër ai i shërbeu shumë shkollës shqiptare. Ai solli ndryshime në fushën e arsimit. *Për kualifikimin e mësuesve, ai ka meritën që gjatë pushimeve verore shkollë të vitit 1925 u organizuan kurse kualifikimi për mësuesit e shkollave fillore.* Gazeta “Zëri i Korçës”, lajmëronte:

*“Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit, nën drejtoratin e të palodhurit prof.Sotir Papahristo, për përmirësimin e arsimtarëve të qyteteve dhe atë më tepër të katundeve, vendosi me kohë që të hapen kurse pedagogjike në të gjithë qytetet qendra të Shqipërisë”.*¹¹⁵

Puna e tij u vlerësua shumë. *“Sotir Papahristo bën pjesë në titullarët më përparimtarë dhe më të përkushtuar të zyrës së lartë të shkollës së shtetit shqiptar në vitet ‘20-‘30 të shekullit të XX”.*¹¹⁶ U largua nga posti më i lartë i arsimit duke dhënë dorëheqjen. *“Ishin privilegjet personale të njerëzve të rëndësishëm që nuk e lanë të punonte i qetë. Ai dha dorëheqjen pasi nuk mund të vepronte kundër ndërgjegjes së tij.”*¹¹⁷ Pas dorëheqjes së tij nga posti në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit, u kthye në Korçë. Në shtator 1925 u emërua drejtor i Liceut. Liceu i Korçës i kishte hapur dyert për herë të parë në nëntor 1917 me 36 nxënës. Ai u ngrit në Korçë në zonën e pushtimit francez. Papahristoja forcoi disiplinën, përmirësoi edukatën dhe sjelljen e jashme të nxënësve. Ai u vlerësua shumë nga mësuesit francezë. Qeveria franceze si shpërblim moral ndaj punës së tij të palodhur dhe produktive i dha dekoratën “Oficer d’Academie”. Në fillim të vitit shkollor 1933-1934, Papahristoja largohet për në Tiranë. U emërua drejtor i Institutit “Nana Mbretneshë”. Instituti “Nana Mbretneshë” ishte shkollë e mesme, e cila u çel në vitin 1934. Kishte synim shkollimin e vajzave dhe kishte në qendër të programit mësimin, emancipimin dhe zhvillimin e vajzës dhe gruas shqiptare. Ky institut u krijua me iniciativën e dy personaliteteve të kulturës dhe politikës shqiptare, Hil Mosi dhe Mirash Ivanaj. Me vajtjen e Sotir Papahristos në Tiranë, shkolla hyri në rrugë të mbarë dhe do të vazhdonte të përmirësohej nëse nuk do të ndodhte pushtimi italian i Shqipërisë më 7 prill 1939. Më 5 maj 1939, Ministria e Arsimit e transferoi Sotir Papahriston në Shkodër. Tashmë, Sotir Papahristoja do të ishte drejtor në gjimnazin e Shkodrës. Ky largim e hidhëroi dhe

¹¹⁵ “Gazeta Korrieri”, Tiranë, dt.01.10.2005, nr. 241

¹¹⁶ “Gazeta Korrieri”, Tiranë, dt.01.10.2005, nr. 242

¹¹⁷ “Gazeta Standard”, Tiranë, dt.29.04.2009, nr. 1229

me tepër atë dhe familjen e tij. Më tej, me ndërhyrjen e Xhafer Ypit, u vendos profesor greqishteje në Gjimnazin e Tiranës. Në vitet 1944-1947 jepte mësim fillloreje në shkollën femërore (ish-instituti femëror). Në vitin 1947, pas vdekjes së djalit të tij, e pati të vështirë të jepte mësim në një shkollë 7-vjeçare. Në janar 1948 filoi punë si përkthyes në Institutin e Studimeve Shqiptare. Në vitet 1953-1964 punoi si punonjës shkencor pranë Fakultetit të Histori-Filologjisë. Si pensionist vazhdoi përkthimet.

Përfundime

Sotir Papahristo është një ndër figurat që dhanë ndihmesë të çmuar për përparimin e arsimit shqiptar. Ai ia kushtoi të gjithë jetën arsimit kombëtar, punoi si arsimtar, përkthyes, autor i veprave pedagogjike etj. Ai dha një kontribut shumë të madh jo vetëm në shkollat ku punoi, por në mbarë arsimin kombëtar. Punoi shumë, shkroi vepra pedagogjike me vlerë që do të ndihmonin në përgatitjen e kuadrove arsimtarë, madje duke i mësuar vetë mësuesit. Ndhimoi si mësues i shquar, i talentuar dhe me kulturë. Si ministër arsimit, edhe pse për një kohë të shkurtër, ishte arkitekti i shumë ndryshimeve që u bënë në arsimin shqiptar. Solli ndryshime të cilat u vlerësuan shumë për kohën. Zhvilloi një punë të frytshme për zhvillimin e arsimit, miredukimin e brezave dhe përgatitjen e mësuesve të mirëfilltë në sajë të kurseve të kualifikimit dhe veprave të tij pedagogjike. Si drejtues i Institutit “Nana Mbretneshë” u shqua për përpjekjet e tij për mirarsimimin e femrës shqiptare. Prej vitit 1947 si nënpunës në Institutin e Studimeve Shqiptare dhe me vonë i Shkencave e më tej, nga viti 1947-1967, deri kur doli në pension, u mor me përkthime. Për 56 vjet i shërbeu kulturës shqiptare si arsimtar dhe si shkrimtar. Vdiq në vitin 1979 në moshën 92-vjeçare.

Literaturë

Akademia e Shkencave të Shqipërisë. *Historia e popullit shqiptar III*, Tiranë: Toena, 2007

Akademia e Shkencave të Shqipërisë. *Historia e popullit shqiptar II*, Tiranë: Toena, 2007

Myzyri, Hysni. *Shkollat e Para Kombëtare shqipe*, Shqipëri: 8 nëntori, 1978

Gazeta "Korrieri", *Sotir Papahristo, njeriu i arsimit*. Iliaz Gogaj, nr.241, fq.14


Gazeta "Korrieri", *Sotir Papahristo, njeriu i arsimit*. Iliaz Gogaj, nr.242, fq.16

Gazeta "Korrieri", *Sotir Papahristo, njeriu i arsimit*. Iliaz Gogaj, nr.243, fq.18

Gazeta "Shekulli", *Fjala e fundit e helenistit*. Elsa Demo, nr.2453, fq.10-11

Gazeta "Standard", *Autobiografia*. Sotir Papahristo, nr.1229, fq.17

ASPEKTE NGA ZHVILLIMI I KONFERENCËS


REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM
Nr. 36 Datë 20-03-2019


Per dhënie titulli "Qytetar Nderi" Sotir Papahristo (pas vdekjes)

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Qendra e Artit dhe Kulturës « Per dhënie titulli « Qytetar Nderi » i qytetit të Korçës
Z.Sotir Papahristo (pas vdekjes) me motivacionin :
“ PERSONALITET I SHQUAR QE ME KONTRIBUTIN E TIJ TE RENDESISHEM I KA DHENE ARSIMIT KORCAR DHE ATIJ MBARE SHQIPTAR NJE VLERE TE PAZEVENDESUESHME NDER BREZA”

Në kuadër të vlerësimit të figurave të njohura korçare si dhe në zbatim të Ligjit 139/2015,
“ Për veteqeverisjen vendore ” në Republikën e Shqipërisë,Neni 32,pika “m” si dhe Ligji nr.112/2013
“Për dekoratat,titujt e nderit,medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë,V.K.M nr.
861,datë 10/12/2014” për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve
këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë si dhe
urdhëri nr.29 V.K.B datë 03/04/2014 “Për miratimin e bordit artistik” si dhe V.K.B nr.83,datë
25/09/2015 “ Për përcaktimin e kriterëve dhe miratimin e rregullores së dhënies të stimujve të nderit”
mbeshtetur në kompetencat që i ka dhe mbas diskutimit të anëtarëve :

VENDOSI

1. Te miratoje dhënie të titullit « Qytetar Nderi » i qytetit të Korçës zotit Sotir Papahristo(pas vdekjes) me motivacionin :
2. **“ PERSONALITET I SHQUAR QE ME KONTRIBUTIN E TIJ TE RENDESISHEM I KA DHENE ARSIMIT KORCAR DHE ATIJ MBARE SHQIPTAR NJE VLERE TE PAZEVENDESUESHME NDER BREZA .**
3. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Qendrës së Artit dhe Kulturës dhe Drejtoria Juridike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI
ILIR BAJLOS


Vendimi Nr.36, datë 20.03.2019 i Këshillit të Bashkisë Korçë, për dhënie titulli “Qytetar Nderi” Sotir Papahristo (pas vdekjes)



Dorëzimi i i titullit “Qytetar Nderi” Sotir Papahristo (pas vdekjes), mbesës së tij Vasilika Petrela, nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë Korçë, Z. Ilir Bajlos



Hapja e Konferencës Shkencore Kombëtare kushtuar jetës dhe veprës së Sotir Papahristos (1887-1979) në mjediset e Bibliotekës Shkencore në Universitetin “Fan S. Noli” në Korçë



Fjala përshëndetëse në konferencë nga Rektori i Universitetit të Korçës, prof.dr. Ali Jashari



Referati kryesor i mbajtur në konferencë nga profesor Emil Lafa



Aspekte nga zhvillimi i konferencës

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Konferencë shkencore kombëtare kushtuar jetës dhe veprës së Sotir Papahristos: (1887-1979) : Korçë, 29 mars 2019: (përmbledhje materialesh) / përgat. për bot. Olger Brame-Korçë: Fan S. Noli, 2019

167 f;cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-4568-0-9

I. Papahristos, Sotir

1.Arsimi 2.Mësues 3.Gjuha shqipe
4.Biografia 5. Konferenca 6.Shqipëri

37(496.5) (091) (062)

929(496.5)[Papahristos, Sotir] (062)